

PËRQËNDRIMET E NDËRMARRJEVE NË TË DREJTËN E KONKURRENCËS: ÇËSHTJE TEORIKE DHE PRAKTIKE.

ARDVIN KRAJA

Dorëzuar
Universitetit European të Tiranës
Shkollës Doktorale

Në përmbushje të detyrimeve të programit të Doktoratës në shkenca juridike,
me profilin e të drejtës së biznesit, për marrjen e gradës shkencore “Doktor”

Udhëheqës shkencor: Prof. Asoc. Dr. Endirë Bushati

Numri i fjalëve: 50.668

Tiranë, Korrik, 2017

DEKLARATA E AUTORËSISË

Ky punim është rezultat i një kërkimi që respekton në mënyrë të plotë të gjitha kriteret shkencore dhe akademike. Ai nuk përmban materiale të shkruara apo të publikuara nga persona të tjerë, përveçse në rastet e citimeve dhe referencave të vendosura, sipas një bibliografie të përcaktuar.

© Ardvin Kraja

ABSTRAKTI

Shqipëria ishte një nga vendet e fundit në Europë që implementoi një ekonomi të tregut të lirë pasi kaloi nga një prej regjimeve diktatoriale komuniste më të egra në botë. Në mënyrë që të ketë sukses në përpjekjet e saj për të krijuar një ekonomi të tregut të lirë, Shqipëria ka të nevojshme të ndërmarrë një sërë reformash për të modernizuar ekonominë e saj në mënyrë që të përballlet me realitetin e ri të tregjeve globale dhe integriteteve euro-atlantike. Një aspekt i rëndësishëm janë reformat në sistemin e drejtësisë dhe zbatimi i ligjit të konkurrencës në përputhje me “Acquis Communautaire” në kuadër të zbatimit të tij efektiv. Në dhjetë vitet e fundit është arritur mjaftueshëm, por ka ende shumë për t'u bërë në mënyrë që të lehtësohet ekonomia konkurruese në gjendje për t'u integruar në BE. Puna e Autoritetit të Konkurrencës është vetëm një aspekt i këtij procesi, por është me rëndësi të madhe për zhvillimin kombëtar, juridik, ekonomik, dhe për anëtarësimin e suksesshëm në Bashkimin European.

Përqëndrimet janë një pjesë e rëndësishme e ligjit të konkurrencës ku me anë të kësaj praktike bëhet e mundur shkrirja dhe bashkimi i shoqërive tregtare. Në këtë lloj praktikash hasen shumë abuzime, prandaj roli i gjykatave dhe autoriteteve kompetente është një domosdoshmëri për rregullimin e kësaj marrëdhënieje. Problematikat në këtë fushë janë prekur që në gjenezë të krijimit të ndërmarrjeve të përbashkëta dhe veprimtaria e tyre me modernizimin e tregut bëhet më e ndërlikuar si për t'u aplikuar ashtu edhe për t'u gjurmuar nga autoritetet e ngarkuara me kontrollin e tyre. Shqipëria vitet e fundit ka zhvilluar në mënyrë progresive tregun me metodat demokratike dhe liberalizimin e tij. Liberalizimi ka ndikuar në ushtrimin e lirë të veprimtarive nga ndërmarrjet e ndryshme në nivele të ndryshme të tregut, kështu korpusi ligjor dhe rregullat e aplikuara në këtë aspekt kanë bërë të mundur

që të arrihet një sofistikim i veprimtarisë së ushtruar. Në kushtet që është tregu i brendshëm dhe në mungesë të praktikave në fushën e përqendrimeve në kuadër të konkurrencës së lirë dhe efektive do të jetë dhe fokusi i punimit, që do të vendosë theksin tek problematikat e shfaqura në këtë aspekt të së drejtës së konkurrencës dhe përmirësimin më të mundshëm që mund t'i bëhet kësaj praktike me anë të implementimit të rregulloreve europiane, duke krijuar një qëndrueshmëri në treg dhe për rrjedhojë një ekonomi të qëndrueshme në terma afatgjatë.

ABSTRACT

Albania was one of the last countries in Europe that implemented a market economy after having experienced one of the most severe communist regimes in the world. In order to succeed in its attempts to create a free market economy, Albania has to undergo a series of reforms for the modernization of its market in order to face the new reality of global markets and Euro-Atlantic integration. An important aspect are the reforms in the justice system and the enforcement of the competition law in accordance with the “Acquis Communautaire” concerning its effective implementation. There has been achieved a lot in the last ten years, yet there is still much to be done in order to facilitate a competing economy that is able to be integrated in the European Union. The action of the Competition Authority is only one aspect of this process, but it has a crucial importance for the national legal and economic development as well as for the successful acceptance in the EU.

Mergers and acquisitions are an important component of the competition law as this practice enables the concentration of trade companies. In this practice are encountered many abuses, thus, the role of courts and competent authorities is a necessity for the regulation of this relationship. Issues in this area have been treated from the genesis of the creation of joint corporates and their activity becomes much more complex – in its applicability as well as traceability – from the authorities responsible for their control.

Over the recent years, Albania has developed its market in a progressive manner by democratic measures and its liberalization. Liberalization has affected the free pursuing of activities by various companies at its diverse levels, thus the legal corpus and applied rules

in this aspect have enabled the sophistication of the applied activity. The current internal market conditions and the absence of the practices in the area of company concentrations in a free and effective competition framework will be focus this work, which will put emphasis on the displayed issues of the competition right as well as on the most probable improvement that can be effectuated to this practice through the implementation of the European regulation in order to create a stable market and as a consequence a sustainable economy in the long term.

DEDIKIMI

Dedikimi i këtij punimi është në mënyrë të veçantë për familjen time, të cilët kanë besuar dhe kanë kontribuar në të gjitha mënyrat e mundshme për realizimin dhe arritjet personale me një durim dhe investim që do t'i jem mirënjohës për gjithë jetën...

FALENDERIME

Falenderoj pedagogen udhëheqëse Prof. Asoc. Dr. Endirë Bushati për ndihmën dhe kontributin e saj të rëndësishëm në finalizimin e punës kërkimore, e cila më është gjendur pranë në të gjitha rastet e vështira të projektit kërkimor, me suportin dhe këshillat profesionale.

Një mirënjohje e veçantë për Prof. Asoc. Dr. Edi Spaho që më ka ndihmuar gjatë gjithë procesit të hulumtimit me këshillat akademike dhe disponueshmërinë e tij si specialist në fushën e të drejtës së konkurrencës.

Falenderoj të gjithë kolegët për disponueshmërinë dhe suportin që kanë shfaqur gjatë të gjithë periudhës së punimit shkencor.

Mirënjohje!

LISTA E SHKURTIMEVE

AK	Autoriteti i Konkurrencës
AP	Asambleja e Përgjithshme
APA	Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve
BE	Bashkimi European
CEO	Chief Executive Officer
EEA	European Economic Area – Hapësira ekonomike europiane
EFTA	Shoqata e Tregtisë së Lirë Europiane
FTC	Federal Trade Commission – Komsioni Federal i Tregtisë
GJP	Gjykata e Përgjithshme
GJED	Gjykata Europiane e Drejtësisë
GJSHPT	Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë
KC	Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë
LSHT	Ligji për Shoqëritë Tregtare
M&A	Mergers & Acquisitions (Përqëndrimet e Ndërmarrjeve, Bashkim / Shkrirje & Përfitim Kontrolli)
QKB	Qendra Kombëtare e Biznesit
OECD	Organization for Economic Cooperation and Development, (Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik)
ORT/AKS	Ortakët/ Aksionerët
OBT	Organizata Botërore e Tregtisë

SHA	Shoqëria Aksionare
SHBA	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
SHT	Shoqëria Tregtare
SHPK	Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar
TFBE	Traktati i Funkcionimit i Bashkimit European
UNCITRAL	United Nations Commission on International Trade Law

TABELA E PËRMBAJTJES

DEKLARATA E AUTORËSISË

ABSTRAKTI

FALENDERIME

LISTA E SHKURTIMEVE

KAPITULLI I – HYRJE

1.1	Qëllimi i Punimit.....	1
1.2	Hipoteza dhe Pyetja Kërkimore.....	2
1.3	Metodat e Kërkimit.....	3
1.3.1	Metoda e kërkimit doktrinar.....	3
1.3.2	Metoda e analizës dhe krahasimit të legjislacionit.....	4
1.3.3	Metoda e kërkimit ndërdisiplinor.....	4
1.4	Aspektet strukturore.....	5
1.5	Pritshmëritë dhe vështirësitë e punimit.....	8

KAPITULLI II – E DREJTA E KONKURRENCËS NË LEGJISLACIONIN SHQIPTAR, NË TË DREJTËN EUROPIANE DHE NË LEGJISLACIONIN E SHTETEVE TË BASHKUARA TË AMERIKËS

2.1	Kuptimi i konkurrencës së lirë.....	9
2.2	Përqëndrimet dhe kuptimi i tyre në kuadër të qëndrimeve të shkollave të së drejtës.....	12
2.3	Evoluimi i konkurrencës në sistemin e drejtësisë së SHBA-së.....	15
2.4	Historiku i të drejtës europiane së konkurrencës.....	17
2.5	Vështrim historik i të drejtës së konkurrencës në Shqipëri.....	21
2.6	Konkluzion.....	26

KAPITULLI III – OPERACIONET E PËRQËNDRIMIT TË NDËRMARRJEVE ME ANË TË BASHKIMIT/SHKRIRJES (MERGER)

3.1	Përqëndrimet e ndërmarrjeve dhe mënyra e krijimit të tyre në kuadër të konkurrencës efektive.....	29
3.2	Përftimi i kontrollit në kuadër të bashkimit/shkrirjeve.....	35
3.3	Forma e përqëndrimit të përbashkët, joint venture.....	43
3.4	Përqëndrimet e ndërmarrjeve në nivel horizontal, vertikal dhe konglomerat.....	48
3.5	Praktikat antikonkurruese të përqëndrimeve gjatë krizave ekonomike.....	51
3.6	Konkluzion.....	53

KAPITULLI IV – OPERACIONET E PËRQËNDRIMEVE NË KUADËR TË PËRFTIMIT TË KONTROLLIT (ACQUISITIONS)

4.1	Kuptimi i kontrollit të përqëndrimeve.....	56
-----	--	----

4.2	Kontrolli i përbashkët dhe kontrolli nga një person i vetëm.....	59
4.3	Mënyra e kontrollit nëpërmjet ekskluzivitetit dhe hapësirat ligjore për ushtrimin e kësaj veprimtarie.....	71
4.4	Kontrolli mbi asetet e ndërmarrjeve.....	72
4.5	Kontrolli nëpërmjet ushtrimit të së drejtës së votës.....	77
4.6	Konkluzion.....	82

KAPITULLI V – RREGULLAT DHE PROCEDURAT QË ZBATOHEN PËR OPERACIONET E PËRQËNDRIMEVE TË NDËRMARRJEVE

5.1	Procedurat e përqëndrimit të aplikuara nga shoqëritë tregtare në kuadër të rregulloreve të brendshme.....	85
5.2	Hapat dhe negociatat e operacionit të përqëndrimit në ligjin amerikan “Antitrust”....	87
5.3	Procedurat e brendshme për përqëndrimet e ndërmarrjeve në legjislacionin shqiptar.....	92
5.3.1	Zbatimi i procedurave të përqëndrimit të ndërmarrjeve nga Autoriteti i Konkurrencës.....	98
5.4	Rregullat e aplikueshme në të drejtën e BE-së për kontrollin e procedurave të përqëndrimeve.....	105
5.4.1.	Aksionarët e pakicës si subjekte të shqyrtimit në Rregullorën e Përqëndrimeve të Bashkimit European.....	117
5.5	Konkluzion.....	118

KAPITULLI VI – PROBLEMATIKAT E PRAKTIKËS GJYQËSORE NË CIVIL LAW DHE COMMON LAW

6.1. Sistemet ligjore Civil Law dhe Common Law në kuadër të ndryshimeve thelbësore.....	121
6.2. Çështje gjyqësore për operacionet e përqëndrimeve në të drejtën amerikane të konkurrencës.....	123
6.3. Praktika gjyqësore në të drejtën e BE-së në kuadër të përqëndrimeve të ndërmarrjeve.....	131
6.4 Praktika shqiptare në drejtim të kontrollit të përqëndrimeve.....	138
6.5 Konkluzion.....	145

KONKLUSIONE DHE REKOMANDIME.....	148
---	------------

BIBLIOGRAFIA.....	162
--------------------------	------------

KAPITULLI I – HYRJE

1.1 Qëllimi i Punimit

Ky punim ka për qëllim studimin dhe hulumtimin në fushën e të drejtës së konkurrencës të legjislacionit shqiptar në kuadër të aspiratës për integrim në familjen europiane. Punimi synon nxjerrjen në pah të njohurive bazë mbi të drejtën e konkurrencës dhe përqëndrimeve të ndërmarrjeve duke vendosur lidhjen e saj me të drejtën e konsumatorit, historikun e lindjes dhe evoluimit të këtyre disiplinave, legjislacionin në fuqi për rregullimin e marrëdhënieve konkurrenciale dhe sjelljeve abuzuese me operacionet e përqëndrimeve në Shqipëri dhe BE, rastet dhe format e shfaqjes së konkurrencës së pandershme në kuadër të shkrirjeve/bashkimeve apo përfuturit të kontrollit të shoqërive të ndryshme në tregje të caktuara, rastet e shkeljeve të të drejtave të konsumatorëve, rrugët ligjore që duhen ndjekur për mbrojtjen e konkurrencës së ndershme si dhe institucionet përgjegjëse, të cilat garantojnë zbatimin efektiv të ligjit në secilën disiplinë përkatëse. Një trajtim të veçantë do të kenë në punim rastet e praktikës gjyqësore dhe ndihma që kanë dhënë gjykatat me vendimet e tyre në garantimin e konkurrencës së lirë, dhe problematikat që ka kjo e drejtë në zbatimin e saj në vendin tonë në krahasim me të drejtën e BE-së dhe ligjit të “Antitrust”-it amerikan. Pra, zbatimi në Shqipëri i të drejtës së konkurrencës, në kuadër të respektimit të së drejtës së BE-së duke e vënë theksin tek përqendrimet e ndërmarrjeve.

Në këtë punim synohet të shqyrtohen dhe interpretohen problematikat kryesore që shfaqen kryesisht gjatë procedurave dhe hartimit të rekomandimeve për të ngritur një kuadër institucional më efikas.

Gjykoj se, studimi, thellimi dhe përmirësimi i njohurive në këtë fushë, nga pikëpamja teorike dhe praktike, do të ndihmonte organet kompetente dhe gjykatat në vendimet e tyre në lidhje me përqëndrimet e ndërmarrjeve vendase dhe të huaja që ushtrojnë veprimtari në Shqipëri. Punimi mbi përqëndrimet e shoqërive tregtare në respektim të konkurrencës efektive dhe të lirë, në vështrim analizues me legjislacionet përkatëse të Shqipërisë dhe Bashkimit Europian, është një domosdoshmëri në aspektin e qasjes së problematikave në legjislacionin shqiptar, parë kjo nga një e drejtë e konsoliduar dhe shumë funksionale, siç është e drejta e BE-së dhe disa trajtime nga e drejta amerikane e konkurrencës. Mendoj se është e nevojshme që të nxirret një konkluzion mbi qasjen dhe sanksionimin e konkurrencës efektive të aplikuar rishtazi vitet e fundit në legjislacionin tonë, tanimë që kemi kushte për të plotësuar si shtet që ka statusin e vendit kandidat në BE.

1.2 Hipoteza dhe Pyetja Kërkimore

Hipoteza:

Kuadri ligjor në fuqi përballat me vështirësi në implementimin e tij në lidhje me përqëndrimet e ndërmarrjeve përfshirë procedurat që ndiqen për operacionet e këtyre përqëndrimeve të cilat kanë mangësi për t'u dhënë zgjidhje disa problematikave aktuale, si edhe për të krijuar praktika thjeshtëzuese për ekonomizimin e procesit, efikasitetin e procedurës së shkrirjes dhe eficientë e zbatueshmërisë së këtij procesi duke konsideruar kohën dhe koston.

Pyetjet kërkimore:

1. Qëllimi i përqëndrimeve të ndërmarrjeve në legjislacionin shqiptar është të garantojë ekskluzivisht interesin më të lartë të konsumatorit apo ka për qëllim vetëm maksimizimin e

fitimit të ndermarrjeve pjesëmarrëse duke përfituar nga një pozitë më avantazhuese në treg për shkak të zgjerimit të pjesës së dominimit që ka në një treg të caktuar?

2. Sa efikasitet mund të ketë përdorimi i instrumentave ligjor të BE-së në legjislacionin shqiptar në trajtimin e konkurrencës së lirë në kuadër të operacioneve të përqëndrimit të shoqërive tregtare?

3. Legjislacioni shqiptar i përafruar me *acquis communautaire*, ndikon në forcimin apo dobësimin e konkurrueshmërisë së ndermarrjeve në tregun rajonal dhe më gjërë?

1.3 Metodat e Kërkimit

Në shkencat juridike metodat e përdorura kryesisht janë cilësore, për shkak të vetë natyrës së shkencës. Metodologjia e aplikuar në disertacion është analitike dhe krahasuese. Duhet theksuar fakti se punimi nuk ka natyrë krahasuese të mirëfilltë, por kjo metodë përdoret gjërësisht në mënyrë që të sqarohen konceptet dhe dispozitat. Metoda e rishikimit të literaturës është gjërësisht e përdorur pothuajse në të gjitha hulumtimet e shkencave humane. Në këtë punim janë përdorur metoda e kërkimit doktrinar, metoda e analizës dhe krahasimit të legjislacionit dhe metoda e kërkimit ndërdisiplinor.

1.3.1 Metoda e kërkimit doktrinar

Metoda e rishikimit të literaturës ka në bazë të saj trajtimin që i ka bërë doktrina kombëtare dhe ndërkombëtare të drejtës së konkurrencës në përgjithësi dhe praktikave abuzuese në kuadër të marrëveshjeve të fshehta në veçanti, ku fokusi kryesor është tek përqëndrimet. Me anë të kësaj metode realizohet rishikimi i literaturës në lidhje me objektin e studimit, e cila përfshin identifikimin, mbledhjen, sistemimin e librave, artikujve shkencorë, konferencave

kombëtare dhe ndërkombëtare si në fushën ligjore ashtu edhe në atë ekonomike duke e shtrirë kërkimin në literaturën e autorëve vendas dhe të huaj.

1.3.2 Metoda e analizës dhe krahasimit të legjislacionit

Kjo metodë konsiston në identifikimin dhe formulimin e problematikave ligjore nëpërmjet analizës së legjislacionit. Si pjesë e sistemit Civil Law e drejta e aplikuar është me norma të cilat janë të kodifikuara dhe të parashikuara në mënyrë të veçantë. Meqënëse normat rregullojnë situata të përgjithshme, kjo metodë shërben për identifikimin dhe zgjidhjen e problemeve. Analiza jurisprudenciale është e impostuar në kuadër të krahasimit me sistemet më efikase të së drejtës së konkurrencës. Në këtë aspekt është bërë dhe krahasimi i legjislacionit shqiptar në kuadër të përqasjes me *acquis communautaire*.

1.3.3 Metoda e kërimit ndërdisiplinor

Procesi i interpretimit dhe analizës së legjilacionit në punim në disa momente të caktuara është bërë në kontekstin e disa faktorëve që nuk janë pjesë e sistemeve ligjore, por që vijnë nga studimi i kontekstit ekonomik duke i dhënë zgjidhje disa problemeve që shtrohen në këtë fushë të së drejtës. Në disa pjesë të caktuara të punimit i është dhënë përgjigje disa problematikave ku vetëm sistemet e të drejtës nuk janë të mjaftueshme për të analizuar dhe interpretuar juridikisht disa fenomene të së drejtës së konkurrencës në kuadër të veprimtarisë së shoqërive tregtare në tregje të caktuara.

1.4 Aspektet Strukturore

Kapitulli i parë, ka në përbërje qëllimin e punimit, hipotezën dhe pyetjet kërkimore, metodat e kërkimit, vështirësitë e hasura gjatë hulumtimit dhe pritshmëritë mbi kërkimin. Pra, është një përmbledhje e aspekteve bazë të punimit në tërësi. Në këtë kapitull trajtohet baza metodologjike e punimit që përbën dhe aspektin strukturor të disertacionit në të gjithë elementët e kërkuar për hulumtimin shkencor.

Kapitulli i dytë, trajton historikun e zhvillimit të së drejtës së konkurrencës në tre legjislacione. Ligji “Antitrust”, që përbën dhe gurin e themelit në zhvillimin e kësaj të drejte jo vetëm për Shtetet e Bashkuara të Amerikës por edhe për të drejtën e brendshme të vendeve të tjera. Këtu është vënë theksi tek aktet kryesore në të drejtën e konkurrencës në SHBA siç është Akti Sherman (Sherman Act), Akti Klejton (Clayton Act), etj.

Pjesa tjetër e kapitullit trajton hapat e parë në fushën e konkurrencës në kontekstin modern të së drejtës europiane, që nga miratimi i Traktatit të Themelimit të Komunitetit European të Çelikut dhe Qymyrit, duke pasuar pastaj me Traktatin e Romës, Traktatin e Funksionimit të Bashkimit European, Traktatin e Lisbonës, dhe rregulloret në zbatim të së drejtës së konkurrencës.

Një analizë në kontekstin historik i është bërë edhe të drejtës shqiptare së konkurrencës, duke filluar që me ligjin e parë që është hartuar dhe miratuar në funksion të mbrojtjes së konkurrencës së lirë, deri në rregullimet ligjore të fundit nga Autoriteti Shqiptar i Konkurrencës si organi kryesor në procedurat e konkurrencës në përgjithësi dhe operacioneve të përqëndrimeve në veçanti.

Kapitulli i tretë, prek në mënyrë konkrete operacionet e përqëndrimit në kuadër të bashkimeve të ndërmarrjeve. Bashkimet paraqiten në dy mënyra kryesore, me anë të

bashkimit me krijimin e një shoqërie tregtare të re, dhe me anë të përthithjes. Fokusi i këtij kapitulli vendoset tek përqëndrimet e ndërmarrjeve nga një person ose një grup personash apo nga një ndërmarrje ose një grup ndërmarrjesh. Një aspekt i rëndësishëm i trajtuar është dhe riorganizmi i ndërmarrjeve të përbashkëta dhe rregullat e aplikueshme për këto lloj përqëndrimesh. Problematikat që hasen dhe mënyrat e shmangies së rregullave janë një pjesë e rëndësishme e kapitullit duke theksuar pozitën e kompanive në treg. Pozita në treg përcakton përveç mënyrës së abuzimit, edhe shkallën e abuzimit. Zbulueshmëria e abuzimeve nga AK-ja është një pjesë e rëndësishme e garantimit të një konkurrencë efektive. Në këtë kontekst, kapitulli i tretë trajton mënyrat e veprimit të AK-së dhe praktikën abuzive të ndërmarrjeve që janë pjesë e bashkimit.

Kapitulli i katërt, ka në bazë të trajtimit aspektet strukture të abuzimit me përqëndrimet e ndërmarrjeve. Kontrollat e shoqërive janë një pjesë e rëndësishme e këtij kapitulli, por jo më pak e rëndësishme është edhe praktika gjyqësore e trajtuar në kuadër të krahasimit mes sistemeve të së drejtës. Rregullat dhe vendimet e Autoritetit të Konkurrencës janë një pjesë shumë e rëndësishme e rregullimit të praktikës së ndjekur nga ndërmarrjet të cilat kërkojnë të aplikojnë përfitimet e kontrollit. Në mënyrë analizuese është bërë e mundur që të nxirret në pah praktika e paligjshme e ndërmarrjeve që kanë pozitë dominuese dhe nga këtu, marrëveshjet e fshehta nëpërmjet bashkimit ose shkrirjes së shoqërive tregtare të ndryshme për të imponuar kushtet e tyre në tregun e lirë. Me anë të diktatit të tyre, këto kompani mundësojnë prishjen e ekonomisë së lirë të tregut dhe dëmin e konsumatorëve duke ndikuar në mënyrë të tërthortë edhe tek cilësia e produkteve apo mallrave të ofruara në treg. Sidoqoftë, në këtë seksion janë trajtuar në mënyrë të hollësishme mënyrat dhe llojet e

përfthimit të kontrollit me anë të analizës ligjore, që nga kontrolli ekskluziv në kuadër të kontratave franchising deri tek kontrolli nëpërmjet ushtrimit të së drejtës së votës.

Kapitulli i pestë, përcakton procedurat e operacioneve të përqëndrimeve në tre legjislacione. Në fillim është trajtuar procedura e përqëndrimit të ndërmarrjeve në ligjin antitrust të SHBA-së. Në këtë pjesë të kapitullit është shpjeguar në mënyrë të hollësishme procedura e përqëndrimit nga momenti fillestar mes shoqërive që marrin pjesë në operacion deri tek njoftimi i organeve kompetente për hapat e ndjekur në kuadër të rezultatit të kërkuar. Nga këtu, në paralelizëm me të drejtën amerikane të konkurrencës është vënë e drejta shqiptare e konkurrencës. Në nivel krahasimor është bërë e mundur që të vihet theksi në diferencat midis dy legjislacioneve në kuadër të procedurave të ndjekura. Gjithashtu, është bërë një analizë e procedurave të BE-së për përqëndrimin. Një rëndësi e veçantë i është kushtuar procedurës së përqëndrimit për arsye se ana procedurale nxjerr në pah shumë abuzime me këtë praktikë të ndjekur. Shqipëria, si një vend që aspirojnë për t'u integruar në familjen europiane me anë të marrëveshjeve dhe përafrimit të legjislacionit duhet që të implementojë rregulloret e vendeve perendimore në mënyrë që të ofrojë një treg stabil dhe një garanci për mbrojtjen e konkurrencës efektive.

Kapitulli i gjashtë, ka në përbërje të tij jurisprudencën e dy sistemeve të mëdha të së drejtës, përkatësisht Civil Law dhe Common Law. Në këtë pjesë të disertacionit është bërë një analizë e praktikës gjyqësore të gjykatave amerikane, europiane dhe shqiptare. Janë marrë në shqyrtim çështje të ndryshme që në optikën time kanë një rëndësi për perspektiven e kësaj fushe të së drejtës në përgjithësi por edhe ndalimit të praktikave abuzuese me operacionet e përqëndrimeve në veçanti. Me anë të analizës krahasimore të praktikës gjyqësore janë trajtuar

disa problematika që sistemi shqiptar në fushën e konkurrencës duhet t'i rishikojë në disa raste ose t'i implementojë në disa të tjera.

1.5 Pritshmëritë dhe Vështirësitë e Punimit

Punimi shkencor ka në fokus të tij problematikat e operacioneve të përqëndrimit të ndërmarrjeve. Karakteri ndërdisiplinor përshkon të gjithë punimin në fushën juridike dhe në atë ekonomike meqënëse fusha e të drejtës së konkurrencës ka lidhje të drejtpërdrejtë me shoqëritë tregtare që ushtrojnë aktivitetet e tyre në tregje dhe sfera të caktuara të këtyre tregjeve.

Vështirësia kryesore e hasur gjatë punës kërkimore është në kuadër të literaturës së munguar shqiptare në këtë fushë të së drejtës. Një tjetër vështirësi kryesore gjatë punimit të tezës është hasur në llojet e praktikave të ndjekura nga ndërmarrjet e ndryshme të cilat janë shumë të vështira për t'u identifikuar dhe pastaj për t'u hetuar nga autoritetet kompetente. Nga vështirimi analizues dhe krahasues janë hasur vështirësi në nxjerrjen në pah të diferencave mes legjislacioneve dhe aplikimit të operacionit të përqëndrimit në legjislacionet respektive, duke vënë theksin tek përmirësimet e mundshme të legjislacionit shqiptar dhe jo vetëm.

Pritshmëritë e punës kërkimore konsistojnë në rezultatin e efektshmërisë së zbatimit të normave ligjore dhe përmirësimin e kuadrit ligjor aktual në fushën e të drejtës së konkurrencës. Një aspekt tjetër i rëndësishëm është edhe roli i Autoritetit të Konkurrencës dhe organeve që mbikqyrin veprimtaritë e shoqërive tregtare.

KAPITULLI II – E DREJTA E KONKURRENCËS NË LEGJISLACIONIN SHQIPTAR, NË TË DREJTËN EUROPIANE DHE NË LEGJISLACIONIN E SHTETEVE TË BASHKUARA TË AMERIKËS

2.1 Kuptimi i konkurrencës së lirë

Përgjegjësitë themelore të biznesit përcaktohen në kuadrin ligjor të shteteve brenda të cilave ushtrohet aktiviteti dhe përfshijnë pajtueshmërinë me ligjet që kanë të bëjnë me të drejtën e biznesit, konkurrencës, etj. Në kuadër të mbrojtjes minimale të së drejtës komerciale, në varësi të mënyrës së hartimit të saj, mund të nxiten kapacitetet prodhuese vendore ose të krijohet një treg lokal më pak konkurrues; (Ghezzi: 2010, 997) Ajo mund të krijojë mekanizma për të siguruar llogaridhënie, ose mundet vetëm të krijojë përshtypjen se e bën këtë, duke i lënë tregut mundësinë të krijojë stimuj për përgjegjësinë e korporatave dhe mirëqeverisjen e tyre, ose mund të nxisë aktivitete mashtruese nëpërmjet mënyrave të përfutimit të kontrollit nga shoqëritë tregtare që ushtrojnë aktivitet në tregje të caktuara. Krijimi i ligjit komercial dhe zhvillimi i qëndrueshëm i tij mund të jetë një parandalim efektiv i konflikteve të shkaktuara nga faktorët ekonomikë duke adresuar shkaqet e tyre rrënjësore ose mund të shkaktojë konflikte duke krijuar një mjedis të favorshëm ku të lulëzojnë pabarazitë në lidhje me konkurrencën efektive mes ndërmarrjeve. (47th session of United Nations Commission on International Trade Law (UNCITRAL), Enabling environments for rules-based business, investment, and trade, 2014)

Kuadri i vjetër i të drejtës tregtare është një pengesë e madhe për zhvillimin. Ai krijon barriera në formalizimin e sektorit informal të ekonomisë, financimin përfshirës, inovacionin, ekonominë e re në tërësi, mundësitë, efikasitetin e shpenzimeve publike dhe kursimet, rikuperimin nga kriza financiare, dhe të tjera përfitime. Dhe në fund, nuk u lejon shteteve të arrijnë mobilizimin efektiv të burimeve për një zhvillim të qëndrueshëm. Një sistem ligjor funksional nuk është vetëm kyç në ndërtimin e bazave ekonomike, por është gjithashtu vendimtar në ruajtjen e vlerave demokratike. Pa një sistem të integruar të institucioneve që krijojnë rendin dhe lehtësojnë transaksionet ditore të të gjitha llojeve, nga kontratat e biznesit deri tek marrëdhëniet juridike më të sofistikuar, sundimi i vërtetë i ligjit është një nevojshmëri për një qeverisje të vërtetë demokratike.

Kur të drejtat e pronësisë nuk janë të dokumentuara siç duhet dhe institucionet e tregut të pronës mbeten të dobëta – siç është rasti në shumë vende, dhe në veçanti në Shqipëri – sektori joformal dominon ekonominë dhe pengon përfshirjen në tregjet e mëdha ndërkombëtare. Informaliteti i përhapur çon në sundimin e dobët të ligjit dhe rrit korrupsionin.

Themelimi i shoqërive aksionare është moment i cili nuk kërkon ndërhyrjen e organeve apo strukturave jashtë aksionarëve themelues, pasi procesi bazohet ekskluzivisht në shprehjen e vullnetit të themeluesve për të krijuar shoqërinë në ndjekje të objektivave të tyre ekonomike të përbashkët. Si përjashtim, ky proces lejon ndërhyrjen e një organi tjetër, jashtë aksionarëve themelues, që në të shumtën e rasteve është gjykata. (Ghidini, Marchetti, Clarich, Di Porto: 2012, 123) Kjo ndërhyrje është e kufizuar vetëm kur aksionarët kontribuojnë për themelimin e shoqërisë me kontribute në natyrë. Këto kontribute, sipas ligjit për shoqëritë tregtare duhet të vlerësohen nga një ekspert i caktuar nga gjykata, për të shmangur kështu çdo shkak për subjektivitet nga aksionarët themelues. (Malltezi, 2015: 261-262)

Ekzistojnë shumë përkufizime që janë dhënë për konkurrencën e lirë. Konkurrenca nuk është qëllim në vetvete, por është një instrument i ekonomisë së tregut që ndikon pozitivisht në përmirësimin e performancës ekonomike të vendit, hapjen e mundësive për ndërmarrjet që të operojnë lirisht në treg dhe në uljen e çmimit për mallrat ose shërbimet e ofruara. Me konkurrencë të lirë dhe efektive, sipas literaturës, kuptohet një gjendje e tregut në të cilën ndërmarrjet ose shitësit përpiqen në mënyrë të pavarur të fitojnë blerës në mënyrë që të arrijnë një objektiv të caktuar ekonomik, i cili është i lidhur ngushtë me maksimizimin e fitimeve, shitjeve dhe/ose fitimin në një pjesë më të madhe të tregut. E drejta e konkurrencës synon aplikimin e rregullave dhe standarteve ligjore për të rregulluar imperfeksionet e tregut dhe të ruajë, të promovojë dhe të rikthejë kushtet e konkurrencës normale. (Malltezi, 2013: 378)

Konkurrenca është përkufizuar si një proces rivaliteti ndërmjet aktorëve të tregut, me anë të së cilit ndërmarrjet përpiqen të rrisin të ardhurat duke fituar më shumë konsumatorë. (Maher, 2004: 2) Pjesa kryesore e përkufizimit është procesi, sepse nënkupton një vazhdimësi të pacaktuar, pasi konkurrenca nuk është një proces afatshkurtër, por është në lëvizje në ekonominë e tregut ku operon. Në mënyrë që të ekzistojë rivaliteti, duhet që në një treg të caktuar të operojnë disa ndërmarrje. Rivaliteti mes firmave që operojnë në të njëjtin treg mund të shfaqet në mënyra të ndryshme, nëpërmjet cilësisë, shërbimit, çmimit ose kombinimit të tyre por duke mos lënë jashtë fokusit edhe vlerësimin e konsumatorëve. (Kellezi, Max Planck Institute for Intellectual Property, Competition and Tax Law, Volume 5, Springer 2, 2008)

Kuadri ligjor aktual përcakton se cilat janë ato sjellje të ndaluara nga operatorët e tregut, përdorimi i së cilave sjell pasoja mbi konkurrencën duke e shtrëmbëruar atë.

2.2 Përqëndrimet dhe kuptimi i tyre në kuadër të qëndrimeve të shkollave të së drejtës

Konsensusi i përgjithshëm në një ekonomi të tregut të lirë është se aksionarët e një kompanie kanë të drejtë për të vepruar sipas interesave të tyre në ndjekje të një kursi fitimprurës. Kjo e drejtë mund të shihet si një nxitje por edhe kërcënim për menaxhimin e kompanisë në kuadër të ruajtjes së një shkalle të lartë të efikasiteti dhe profitabiliteti. Interesat e aksionarëve, për pasojë, mund të shihen si një stimulues për një ekonomi të gjallë, kështu që çdo sipërmarrje ose përqëndrim brenda një kufiri logjik të pranueshmëmi për aksionarët duhet të mirëpritet. Megjithatë, në përgjithësi është pranuar se operacionet e përqëndrimeve mund të kenë implikime të cilat shtrihen përtej interesave të aksionarëve që kërkojnë një formë kontrolli mbi efektet e ekonomisë së një tregu ku ata ushtrojnë veprimtari. Teori të ndryshme janë hasur në këtë këndvështrim, ku kryesoret janë dy shkolla të mendimit në lidhje me shkallën e duhur të kontrollit të veprimtarisë së bashkimit/shkrirjeve ose përfitimit të kontrollit.

Qasja e parë do të evokojë ndërhyrjen vetëm nëse përqëndrimi i propozuar ka gjasa të ketë një efekt negativ mbi konkurrencën në një treg, përndryshe vendimet për bashkim/shkrirje ose përfitim kontrolli duhet të lihen në duart e sipërmarrësit të aftë, ku në të shumtën e rasteve sipërmarrësat paraqiten më statusin e aksionerit.

Qasja e dytë mban një qëndrim më të ashpër duke u pozicionuar në rritjen e ndërhyrjeve, duke argumentuar se është i nevojshëm një kontroll i tillë për shkak se M&A në përgjithësi nuk kanë dhënë përfitimet e pritura dhe kanë pasoja të mundshme negative rast pas rasti.

Përqëndrimet e ndërmarrjeve janë të aplikueshme për shumë arsye të ndryshme. Si një metodë efektive për të maksimizuar fitimet e shoqërive tregtare që marrin përsipër të bëjnë këto operacione, por në disa raste edhe për të kufizuar konkurrencën efektive për qëllime abuzive. Sidoqoftë, po t'i referohemi në terma ekonomikë, do të na paraqitet një tablo e cila

ndahet në ekonominë e shkallës, në rritjen e efijencave të ndërmarrjeve, si dhe zhvillimin e njëanshëm të teknologjisë. (Hamner, 2002: 385) Qëndrime të ndryshme janë mbajtur në kontekstin e sipërcituar sepse skeptikët parashtrojnë tezën se përqëndrimet nuk mund të shpjegohen me një *ratio* në terma ekonomike. Këto qëndrime janë mbajtur nga individë të caktuar, nga kompani të vogla që janë të rrezikuara potencialisht nga pesha që kanë në treg si edhe spekulimet e personave që kanë interesa të caktuara. Sidoqoftë, arsyeja reale në të shumtën e rasteve, se për ç'arsye shoqëritë tregtare kërkojnë të kryejnë operacione përqëndrimi, ka të bëjë me eliminimin e konkurrencës mes tyre, duke rritur fuqinë e tyre në treg dhe duke caktuar çmimet sipas interesave vetjake. Përfitimi kryesor që një shkrirje mund të sjellë është për të përmirësuar efikasitetin e kompanive të përfshira, sidomos kur ka *ekonomi të shkallës*¹ të cilat mund të arrihen vetëm nga një M&A. (De Lucia, Minervine: 2011, 89) Efikasiteti mund të rritet nga menaxhimi i mirë apo aksesit më i lehtë në kapital, të cilat mund të rezultojnë nga një shkrirje. Përfitime të tjera përfshijnë mundësinë e ndërmarrjes të përballet me likuidimin sa më vonë të jetë e mundur. Ekzistojnë dëshmi empirike që sugjerojnë se përqëndrimi në kuadër të disa objektivave të ndryshme nuk arrihet gjithmonë nga ndërmarrjet që kërkojnë të marrin pjesë në këto operacione. (Schenk, 2000: 43)

Kompanitë kanë tendencë të kryejnë operacione përqëndrimi për arsye të ndryshme. Kështu, një arsye e parë mund të jetë efijenca produktive (efektet e sinergjisë, ekonomitë e shkallës, ekonomitë e qëllimit), - e nënkuptuar si aftësia e kompanive që të arrijnë nivelin më të lartë

¹ Ekonomia e Shkallës i referohet gjendjes kur kostot totale në afat të gjatë bien ndërsa sasia e outputit rritet, pra janë faktorët që bëjnë që kostoja mesatare e prodhimit të një produkti të ulet me rritjen e volumit të prodhimit të tij. Aplikueshmëria e saj bën që të jetë një ndër formulat më të përdorura për maksimizimin e fitimeve dhe mbajtjen në mënyrë optimale të bilanceve në funksion të politikave monetare të shoqërive tregtare.

të prodhimit duke përdorur sasinë më të vogël të mundshme të inputit. Arsye tjetër mund të jetë efienca e transaksioneve, e nënkuptuar si situata në të cilën ndërmarrjet konsolidojnë veprimtarinë nën një drejtim të vetëm për të mos u varur nga kontrata tregu (duke shmangur kështu pasigurinë, frekuencën e transaksioneve dhe veçantësinë e aseteve). Tendenca tjetër mund të identifikohet me efiençën shpërndarëse e nënkuptuar si ajo situatë kur proceset e tregut bëjnë të mundur që burimet e prodhimit të shpërndahen në mënyrën më të mirë të mundshme. Një faktor është efienca dinamike, e cila arrihet kur proceset e tregut bëjnë të mundur që burimet që ka në dispozicion një shoqëri, të shpërndahen në ato lloj mënyrash përdorimi që kanë vlerën më të madhe aktuale në mes të gjitha mënyrave ekzistuese që kanë vlerë më të vogël aktuale (efienca dinamike në koncept është e ngjashme me efiençën alokuese, me ndryshimin që ajo përfshin edhe përmasën kohë duke qenë dinamike, jo statike). (Meijaard, Joris dhe Hans Schenk, Yvonne Prince. Dynamic efficiencies in mergers and acquisitions, 2005)

Gjatë viteve janë shfaqur shqetësime më të gjëra të ngritura nga përqëndrimet që mund të justifikojnë ndërhyrjen nga autoritetet kombëtare dhe mbikombëtare të konkurrencës. Këto shqetësime përfshijnë kundërshtime në lidhje me madhësinë dhe fuqinë e ndërmarrjeve të shkrira, për efekt të dëmit që mund sjellin nga bilanci i pagesave dhe transferimeve të kontrollit të një kompanie në pronësi të "huaj" ose të vendit respektiv ku ushtron veprimtarinë. Përparësitë e pretenduara ekonomike janë ngritur shpesh herë në arsyetimin e një bashkimi të veçantë. Në këtë pikë hyn edhe roli i Autoritetit të Konkurrencës (në vende të ndryshme, përcaktohet me emra të ndryshëm dhe karakterizohet nga kompetenca të diferencuara). Krijimi i kësaj instance ka ardhur si rrjedhojë e grupeve të interesit që mund të jenë, qeveritë, shoqëritë me kapital të vogël, shoqëritë aksionere të ndryshme, dhe individët

e grupeve të interesit. Përveç krijimit të Autoritetit, në disa vende europiane janë të aplikueshme sisteme përqëndrimesh mes ndërmarrjeve të cilat duhen të kenë si kriter në ushtrimin e veprimtarisë së tyre interesin publik.

2.3 Evoluimi i konkurrencës në sistemin e drejtësisë së SHBA-së

Levizjet e viteve 1870 janë origjina e politikave antitrust në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ku një grup shtetesh miratuan statute për rregullimin e veprimtarisë ekonomike. Këto politika kishin në bazë të tyre, shkollat teorike të mendimit liberal, ligjet, qasjen ekonomike dhe praktikatat administrative. Antitrust-i është i përbërë nga elementë teorik dhe empirik.

Liberalizimi i tregut dhe krijimi i mundësive për hyrje në treg, rritja e produktivitetit, mbrojtja e konkurrencës dhe rritja e saj, janë disa nga objektivat më me rendësi për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, dhe në bazë të këtij qëllimi u krijua dhe hyri në fuqi “Antitrust”-i i SHBA-së.

Ligjet moderne për konkurrencën i kanë fillesat e tyre me krijimin e këtij ligji. Kuadri ligjor bazë është i përbërë nga:

Akti Sherman i miratuar në vitin 1890, ku qëllim ishte mbrojtja e konsumatorëve nga bizneset që përdornin praktikatat abuzive për rritjen artificiale të çmimeve. Ky ishte hapi i parë drejt vendosjes së kufizimeve në monopole dhe kartelet ekzistuese, si dhe në parandalimin e kufizimeve të tregut. (Meehan & Lerner: 1989, 184) Sanksioni që ishte parashikuar në shkeljen e dispozitave ishte vetëm kundravajtje, pra, shumica e denimeve që jepeshin në bazë të shkeljes së tij ishin me karakter civil. (Marrë nga: economics.fundamentalfinance.com)

Akti Clayton i miratuar në vitin 1914, me anë të së cilit u bë i mundur modifikimi i aktit Sherman nëpërmjet plotësimit në fushën procedurale dhe materiale. Qëllimi i këtij akti ishte

që të sanksiononte bashkimet, meqënëse në Aktin Sherman nuk ishin të parashikuara këto lloj praktikash. Me anë të këtij akti ndalohej ulja e çmimeve në dëm të konkurrencës, bashkimet dhe kontratat ekskluzive. (Marrë nga: www.investopedia.com)

Akti i Komisionit Federal të Tregtisë i miratuar në vitin 1914, kishte për qëllim të zvogëlonte praktikën mashtruese dhe sjelljet kundër konkurrencës së operatorëve në treg. Ky akt ndalonte aktet, metodat dhe praktikën e pandershme të konkurrencës në tregtinë midis shteteve. Theksi vihej në konkurrencën e pandershme, në praktikën mashtruese, në fiksimin e çmimeve dhe ndalimin e bashkimeve abuzive. (Akti i Komisionit Federal të Tregtisë (1914), 15 U.S.C, Seksioni 5, parag. 45)

Akti Robinson-Patman i miratuar në vitin 1936, që u krijua në funksion të Seksionit 2 të Aktit Clayton, vendosi theksin në fushën e ofrimit të shërbimeve për klientët, çmimeve diskriminuese, në fushën e marketingut dhe programeve të tjera promovionale. Ky akt është projektuar për të mbrojtur dyqanet e vogla të shitjes me pakicë ndaj konkurrencës së dyqaneve zinxhir që fiksonin një çmim minimal të produkteve me pakicë. (Marrë nga: <https://www.ftc.gov>)

SHBA-të kanë sistemin Common Law dhe për rrjedhojë pushteti që kanë gjykatat është shumë i lartë. Më sipër u trajtua baza ligjore e ligjit për antitrust-in, por një rol themelor në plotësimin e problematikave që dalin nga implementimi i ligjeve i është atribuar gjykatave. Me anë të vendimeve të tyre, gjykatat kanë mbuluar ato pjesë që mund të kënë pasur konfondim apo kanë qenë të paqarta, duke dhënë kontribut në mënyrë të drejtpërdrejtë në mbrojtjen e konkurrencës së lirë dhe në pasurimin e praktikave ligjore në kuadër të mbrojtjes së kësaj të drejte.

Në ligjin për mbrojtjen e konkurrencës, në të drejtën amerikane, për herë të parë parashikimi i dispozitave për përqëndrimet ishte në Aktin Clayton. Konkretisht në nenin 7 të tij, që ndalonte bashkimet dhe përfitim të kontrollit, kur efekti mund të ishte i ndjeshëm për të zvogëluar konkurrencën, ose kur tentote të krijonte një monopol. Bashkimet në këto raste kishin gjasa të krijonin ose të rrisnin fuqinë e tregut, ose të lehtësonin ushtrimin e veprimtarive të ndërmarrjeve që kishin aktivitet tregtar. (Schoenbaum, 1994: COM. REG. 393, 420-21) Problematika që i krijonte “shqetësim” ligjit antitrust kishte të bënte me bashkimet e propozuara mes konkurrentëve të drejtpërdrejtë (shkrirje horizontale). FTC dhe DD kanë zhvilluar Udhëzimet për bashkimet horizontale që përcaktojnë kornizën analitike të agjencive për kontrollin e tyre. Në vazhdim zgjidhjen e kësaj problematike e ka dhënë një Komentari në Udhëzimet për bashkimet horizontale që ofron shumë shembuj specifikë sesi këto parime janë aplikuar në bashkimet aktuale të shqyrtuara nga agjencitë kontrolluese. (Marrë nga: www.ftc.gov/tips-advice) Me kalimin e kohës u rritën edhe problematikat, por në këtë aspekt zgjidhjet janë dhënë nga kontributi i gjykatave me anë të vendimeve dhe agjencive përkatëse të ngarkuara për kontrollin dhe nxjerrjen e vendimeve për zbatim nga ndërmarrjet e interesuara në këto lloj praktikash.

2.4 Historiku i të drejtës europiane së konkurrencës

Pas Luftës së Dytë Botërore Gjermania dhe Britania ishin vendet e para që miratuan rregulla për konkurrencën. Në vitin 1951 gjashtë shtete nënshkruan marrëveshjen për Komunitetin Europian të Qymyrit dhe Çelikut. Për gjashtë vendet nënshkruese, e drejta e konkurrencës kishte rëndësi të veçantë, duke e sanksionuar kështu në nenin 65 dhe 66 të Traktatit, në të cilin ndalohehin kartelet dhe parashikoheshin dispozita mbi përqëndrimet e ndërmarrjeve

dhe abuzimin me pozitën dominuese nga ana e firmave që ushtronin veprimtari tregtare.
(Geber: 2000, 342)

Vite më vonë në Traktatin e Romës u parashikua ligji për konkurrencën si një nga qëllimet kryesorë të Komunitetit Europian. Në nenet respektive të tij u parashikua më me hollësi e drejta e konkurrencës, por fokusi ishte tek praktikata e ndjekura nga qeveritë dhe në veçanti për ato që kishin efekt të konsiderueshëm në fushën e veprimit të Traktatit. Përsa i përket kontrollit të përqëndrimeve, kishte një dështim sepse nuk u arrit që shtetet anëtare të gjenin një zgjidhje për këtë çështje, duke pasur qasje të ndryshme nga njëri vend në tjetrin.

Traktati i Lisbonës në Protokollin Nr. 27 kërkon themelimin e një sistemi, i cili e mbron konkurrencën ndaj falsifikimeve dhe masave kufizuese brenda kufijve të tregut të përbashkët. Traktati i Lisbonës përmban rregulla që rregullojnë konkurrencën për faktin e thjeshtë se nuk besonte tek e drejta e brendshme e vendeve anëtare dhe tek parametrat e sanksionimit të saj. Traktati i Romës parashikonte se dispozitat duheshin të zbatoheshin mbi bazën e rregulloreve të Këshillit Europian. Nisur nga parashikimet e traktateve u miratua rregullorja 17/62/KE. Kjo rregullore parashikoi mekanizmat e zbatimit ligjor të cilat janë në fuqi edhe sot në të drejtën e konkurrencës së BE-së. Në këtë rregullore përcaktohej se roli i komisionit në hetimin, ndjekjen penale, dhe procesin e vendim-marrjes i nënshtrohej kontrollit gjyqësor të BE-së. (Neni 17, Rregullorja e KE-së 17/62)

Në vitet 1990 - 2004 u bë i mundur miratimi i rregullores për përqëndrimet e kompanive që ishin në atë periudhë një ndër problemet më të mëdha jo vetëm për KE-në, por për të gjithë arenën ndërkombëtare. (Rregullorja e KE-së 4064/89, ndryshuar me rregulloret 1310/97/KE, 1997)

Aktorët e konkurrencës në të drejtën europiane në ditët e sotme janë dy: a) Institucionet (1. Komisioni me Drejtorinë e Përgjithshme të Konkurrencës; 2. Gjykata e Përgjithshme dhe gjykatat, 3. Autoritetet dhe juridiksionet kombëtare të ngarkuara me konkurrencën); b) Ndërmarrjet. Gjatë periudhave të ndryshme të zhvillimit të së drejtës së konkurrencës ka pasur përveç zhvillimeve ligjore, rregullore dhe akte nënligjore në funksion të zbatimit të këtij ligji. Sigurisht që një rol të rëndësishëm ka luajtur në rregullimin e kësaj të drejte edhe gjykata me vendimet e saj, duke i dhënë zgjidhje problematikave të ndryshme që kanë dalë gjatë implementimit dhe zbatimit të ligjit.

E drejta e konkurrencës së BE-së luan një rol vendimtar në të drejtën ekonomike europiane. Detyra kryesore e kësaj të drejte në Bashkimin European është që të mbrojë dhe stimulojë konkurrencën e lirë, ku nëpërmjet saj duhet të garantohet funksionimi i tregut të brendshëm dhe të sigurohet një shpërndarje efiçente e burimeve.

Për një periudhë të gjatë kohore nuk u arrit që të hartohej një rregullore për shkrirjet e ndërmarrjeve. Shkak u bë mosdakortësia e vendeve anëtare mbi rregullimin e kësaj praktike në nivel komuniteti, duke e vënë theksin tek kufiri ndërmjet kontrollit komunitar dhe atij të vendeve anëtare. Në këtë drejtim u veprua në Dhjetor të vitit 1989 me miratimin e Rregullores 4046/89, ku më vonë u plotësua dhe u përmirësua me *Rregulloren*² 139/2004. Çështje thelbësore e rregullorës së shkrirjeve ishte fakti nëse një përqëndrim duhej lejuar apo jo, dhe masa në të cilën duheshin marrë parasysh efiçencat e prodhuara nga përqëndrimi. Qasja e Rregullores ishte që aspektet strukturore të përqëndrimit të ndërmarrjeve të përbashkëta të trajtoheshin sipas rregullores për bashkimet/shkrirjet, ndërsa aspektet e sjelljes

² Në të gjitha rastet kur përdoret termi Rregullore pa e specifikuar, në këtë hulumtim shkencor i referohemi Rregullores së BE-së Nr. 139/2004 “Mbi Kontrollin e Fuzionit të Shoqërive Tregtare”.

së përbashkët lidhur me ndikimin mbi konkurrencën, të koordinimit ndërmjet ndërmarrjeve të pavarura, që shqyrtoheshin nga neni 101. (Zajmi: 2012, 153) Ky i fundit përbënte një dokument në të cilin vlerësohej mundësia për të mbrojtur konkurrencën në treg nga fenomeni i përqëndrimeve, por kjo mbrojtje do të bëhej përmes zbatimit të dispozitave antitrust, nenit 101 dhe 102 (veçanërisht këtij të fundit) të Traktatit Funksionimit të Bashkimit Europian. Sipas këtij orientimi, do të konsideroheshin të ndaluara ato operacione përqëndrimi të cilat realizoheshin nga ndërmarrje në pozitë dominuese. Por, ky lloj kontrolli i përqëndrimeve paraqiste tre lloj problemesh. Së pari, ai lejonte kontrollin vetëm të atyre përqëndrimeve të cilat realizoheshin nga ndërmarrjet në pozitë dominuese. Së dyti, kontrolli mund të bëhej vetëm në një moment të dytë (ex post) pasi përqëndrimi ishte realizuar, dhe së treti, nuk ishte e mundur të kontrolloheshin pasojat antikonkurruese të përqëndrimeve të realizuara (Pace: 2007, 379 e vijuese) Gjatë shek. të XXI pastaj, këto praktika janë rregulluar nga Komisioni që është i ngarkuar me nxjerrjen e vendimeve si dhe nga gjykatat që kanë dhënë një kontribut të çmuar në këtë fushë të së drejtës europiane të konkurrencës.

Rregullorja e përqëndrimeve është projektuar në fillim për të reduktuar konfuzionin dhe burokracitë që rrjedhin nga operacionet e përqëndrimeve në shkallë të gjerë në Komunitet. Kontrolli në nivel Komunitar është shfaqur i rëndësishëm për të lejuar ndërmarrjet e shteteve të Komunitetit të konkurrojnë në arenën ndërkombëtare. Bashkimet/shkrirket ndërmjet sipërmarrjeve të suksesshme europiane janë perceptuar si një mënyrë me të cilën industritë mund të konkurrojnë në mënyrë efektive në tregjet globale. Kontrollat kombëtare janë konsideruar të jenë më shumë për të parandaluar përqëndrimet e rëndësishme në nivel kombëtar që të mos kufizohet konkurrenca e lirë. Përveç kësaj, kontrollet kombëtare marrin

në konsideratë efektet konkurruese në tregun kombëtar edhe nëse operacioni ka kuptim konkurrues në një industri globale. (Went: 2007, 106-109)

2.5 Vështrim historik i të drejtës së konkurrencës në Shqipëri

Shqipëria kaloi për një periudhë të gjatë 45-vjeçare një izolim si pasojë të diktaturës komuniste duke pas-sjellë defiçenca në sistemin: ekonomik, tërësisht të prapambetur; juridik, sepse nuk kishte pronë private; dhe politik, në kuadër të organizimit shtetëror. Sistemi ekonomik i aplikuar gjatë regjimit diktatorial ishte modeli i ekonomisë së planifikuar, si në të gjithë vendet ish-komuniste. Përsa i përket sistemit juridik kuptohet që ishte i përbërë nga normat ideologjike monopartiake që zbatoheshin pa u përshtatur me realitetin dhe në funksion të regjimit.

Në vitin 1991 u shfuqizua kushtetuta komuniste duke sjellë kështu ndryshime politike që u shoqëruan me implementimin e ekonomisë së tregut që duhej të aplikohesh si pjesë përbërëse e sistemit demokratik të implementuar rishtazi. Ky proces kishte në thelb transformimin e ndërmarrjeve nga shtetërore në private. Që ndërmarrjet private të operojnë në mënyrë të lirë dhe të pavarur, instrumenti kryesor është e drejta e konkurrencës.

Mbrojtja dhe sanksionimi i kësaj të drejte i ka fillesat në Kodin Civil dhe përkatësisht në nenet 638, 639. Në keto dy dispozita, mbrojtja e konkurrencës së pandershme është e trajtuar në mënyrë sipërfaqësore dhe e vendos theksin tek pronësia intelektuale, mjetet e tregtisë që nuk përputhen me tregtinë e ndershme – ku këto raste shoqërohen me përgjegjësi civile – dhe parashikohet sanksioni i dëmshpërblimit për veprimet që janë kryer me faj nëse vërtetohet ekzistenca e konkurrencës së pandershme ndaj personit që i ka kryer ato. (Neni 638, 639 i Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë: 2008)

Ligji i Konkurrencës duhet të konsiderohet si një nga bazat për ndërtimin e një ekonomie të tregut të lirë, e shkëputur nga trashëgimia e regjimit komunist të vendeve të Europës Lindore e Qendrore, si dhe të ish - Bashkimit Sovjetik. Dispozitat ligjore mbi konkurrencën u miratuan në periudhën 1990-1996. Shteti shqiptar ndjeu nevojën e miratimit të një paketë ligjore, kur rreziqet që lidhen me praktikant antikonkurruese filluan të bëhen të dukshme në tregun kombëtar. Ligji i parë Nr. 8044, “Mbi Konkurrencën” në Shqipëri u miratua në Dhjetor 1995. Ligji mbi konkurrencën përfshinte dispozita për monopolin, dominimin në treg, kartelet, marrëveshjet e fshehta, bashkimet/shkrirjet e ndërmarrjeve dhe konkurrencën e pandershme. Zbatimi i këtij ligji ishte caktuar në Drejtorinë për Konkurrencën Ekonomike, pjesë e Ministrisë së Tregtisë dhe Turizmit të asaj periudhe. Objekti i ligjit parashikonte përcaktimin e rregullave të tregut, operatorët, si dhe të drejtat dhe detyrimet në kushtet e konkurrencës së ndershme. Ligji përcaktonte të drejtat dhe detyrimet e ndërmarrjeve dhe konsumatorëve. Megjithatë, disa sektorë të rëndësishëm të industrisë si telekomunikacioni, sigurimet, bujqësia, etj., janë përjashtuar nga rrezja që përfshin objekti i ligjit. Kjo nismë ishte një hap shumë pozitiv në drejtim të krijimit të një tregu të lirë dhe një ekonomie konkurruese në Shqipëri.

E drejta është një sistem që evoluon dhe për rrjedhojë këto ndryshime shfaqen në ligjet apo normat e reja që krijohen në fusha të ndryshme të së drejtës. E drejta e konkurrencës i është nënshtruar gjithashtu një evolucioni. Në ligjin nr. 9129, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” është i prekshëm ndikimi në këtë fushë i të drejtës së vendeve të zhvilluara europiane. Në kuadër të mbrojtjes së lirisë ekonomike vërehet ndikimi nga teoria e Ordoliberalizmit si një ideologji e zhvilluar në vitet 1930 – 1940 nga një grup neo-liberalësh të Universitetit të Freiburgut në Gjermani. Ordoliberalët ishin kundër ideologjive totalitariste

dhe socializmit, sepse këto ideologji binin në kundërshtim me idenë që zhvilluan ata, atë të ekonomisë sociale të tregut. Ordoliberalët argumentonin faktin se akumulimi i pushtetit vinte si rrjedhojë e pamundësisë së sistemit ligjor për të bllokuar krijimin dhe abuzimin me fuqinë ekonomike. (Moschel: 2001, 17)

Ndryshimet e pësura në ligj në vitin 2006 dhe 2010 janë në përputhje të plotë me Traktatin e Lisbonës, konkretisht me nenet 101, 102 dhe 107. Ligji i ndryshuar nuk përmban asnjë përkufizim për sa i përket mbrojtjes së konkurrencës. Në nenin 1 të tij përcaktohet objekti, i cili ka në fokus mbrojtjen e konkurrencës së pandershme, të lirë dhe efektive në treg, duke përcaktuar rregullat e sjelljes së ndërmarrjeve në tregun e lirë dhe trajtimin e institucioneve përgjegjëse si dhe të përgjegjësive të tyre.

Kalvari i ndryshimeve ligjore mbyllet në këtë pikë sepse me krijimin e Autoritetit të Konkurrencës bëhet i mundur dhe rregullimi juridik në vazhdimësi, duke nxjerrë dhe urdhëra për zbatim qoftë nga organet kontrolluese dhe zbatuese qoftë nga kompanitë që operojnë në treg. Autoriteti i Konkurrencës vepron për të siguruar një konkurrencë të lirë dhe efektive në treg në zbatim të ligjit "Për Mbrojtjen e Konkurrencës" duke u mbështetur në tre shtylla kryesore që përcaktojnë mbrojtjen e konkurrencës: abuzimin me pozitën dominuese; marrëveshjet e ndaluara në formën e kartelevë dhe bashkimet ose përqendrimet e ndërmarrjeve, si dhe të gjithë kuadrin ligjor që rregullon aktivitetin e një institucioni të pavaruar në Republikën e Shqipërisë. Ky institucion e ka për synim final që tregu të gjenerojë zhvillimin e tij në kushtet e ekonomisë moderne. (Marrë nga: <http://www.caa.gov.al/>)

Parashikimet ligjore për mbrojtjen e konkurrencës së lirë janë të implementuara në ligjin "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", si dhe në ligjin "Për Mbrojtjen e Konkurrencës". Në kuadër të ligjit për tregtarët dhe shoqëritë tregtare janë disa dispozita që parashikojnë një

paketë të plotë të procedurave për riorganizimin e shoqërive me përgjegjësi të kufizuar dhe shoqërive aksionare, nëpërmjet bashkimit, ndarjes ose nëpërmjet ndryshimit të formës. Operacione të tilla, kryesisht, krijojnë katër problematika ligjore që ligji duhet t'i zgjidhë në mënyrë adequate:

1) Mbrojtja e ortakëve ose aksionerëve të shoqërive të përfshira në procesin e riorganizimit. Ortakët ose aksionarët e shoqërisë që përthithet ose ndahet duhet të pranojnë një këmbim aksionesh, dhe për rrjedhojë, duhet garantuar një raport i përshtatshëm i këmbimit të aksioneve. Ky këmbim ka pasoja si për ortakët apo aksionarët e mëparshëm të ndërmarrjes përthithëse ose marrëse, ashtu edhe për aksionarët/ortakët e shoqërisë së përthithur: nëse kompensimi nëpërmjet aksioneve të shoqërisë përthithëse ose marrëse është tepër i lartë, kjo gjë, de facto, rezulton në një “subvencion” që aksionarët e mëparshëm ua japin aksionarëve të rinj. Ortakëve ose aksionarëve, të cilët janë kundër riorganizimit, duhet t'u jepet mundësia të kërkojnë që kursi i këmbimit që ofrohet të jetë nën kontrollin e gjykatave, dhe/ose të kërkojnë që aksionarët e tyre t'ua riblen nëse nuk dëshirojnë të marrin pjesë në riorganizim. (Ligji 129/2014)

2) Mbrojtja e kreditorëve, të drejtat e të cilëve kanë lindur përpara riorganizimit, kur kreditorët nuk marrin pjesë në riorganizim dhe mund të gjenden përballë një debitori me një aftësi paguese më të vogël, ose me një shumëllojshmëri kreditorësh në vijë preferenciale.

3) Mbrojtja e punëmarrësve të shoqërive që marrin pjesë në riorganizim. Ligji përcakton që rrjedhojat e bashkimit të shoqërive për punëmarrësit dhe përfaqësuesit e tyre, si dhe masat e propozuara lidhur me ta duhet të parashikohen në projekt-marrëveshjen e bashkimit. Një detyrim ligjor i përfaqësuesit të shoqërisë është të informojë këshillin e punëmarrësve për çështjet që lidhen me riorganizimin. Të drejtat për publikimin e informacioneve në rastin e

riorganizimit kanë të bëjnë me kërkesat e direktivës 2001/23/KE për masat mbrojtëse për të drejtat e punonjësve në rast të kalimit të pronësisë së ndërmarrjeve apo pjesëve të tyre. (Neni 7 i Direktivës 2001/23/KE)

4) Kalimi “automatik” i aktiveve të ndërmarrjeve ekzistuese në subjektet juridike të formuara rishtazi. (Dine, Blecher: 2016, 241 e vijues)

Sipas ligjit nr. 9121 dt. 28.7.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” Kreu III neni 10 përcakton se, përqëndrime të ndërmarrjeve kemi në rastet kur shkaktohet një ndryshim i qëndrueshëm i kontrollit si rrjedhojë e: a) bashkimit të dy ose më shumë ndërmarrjeve ose pjesëve të ndërmarrjeve të pavarura nga njëra - tjetra; b) përfitimt të kontrollit të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, nga një ose më shumë persona fizikë, të cilët njëkohësisht kanë kontrollin e një ose më shumë ndërmarrjeve ose pjesë të këtyre të fundit, përmes blerjes së aksioneve, kuotave ose aseteve, kontratës ose çdo mjeti të ligjshëm; c) kontrollit të drejtpërdrejtë ose të tërthortë mbi një ose më shumë ndërmarrje ose të një pjese të këtyre të fundit; d) krijimit të një ndërmarrje të përbashkët e cila nuk ka si objekt apo pasojë bashkërendimin e veprimtarive konkurruese ndërmjet dy ose më shumë ndërmarrjesh të pavarura. Nga këtu pastaj, kompetencat për të pasuruar këtë pjesë kryesore të së drejtës së konkurrencës në Shqipëri i ka marrë Autoriteti i Konkurrencës, ku me anë të Komisionit kontrollon këto praktika dhe nxjerr vendime ose udhëzime për zbatim nga ndërmarrjet që kërkojnë t’i ndjekin.

Pothuajse 1/3 e gjithë vendimeve të AK-së janë në fushën e kontrollit të bashkimeve. Ky është një aspekt shumë i rëndësishëm i aktivitetit të këtij organi që nga krijimi i tregut të lirë. Duke marrë parasysh këtë strukturë të tregut e cila shthuret nëpërmjet sjelljes abuzive të shoqërive tregtare, duke përfshirë operacionet e përqëndrimeve, do të sjellë një dëm për konsumatorët dhe konkurrencën e lirë. (Autoriteti i Konkurrencës, Raporti i vitit 2013)

Pavarësisht numrit të konsiderueshëm të bashkimeve të mbikqyrura nga AK-ja në RSH, numri i shkrirjeve të ndaluara akoma është minimal. Duke iu referuar kësaj praktike ka shumë pak shembuj të tërheqjes së njoftimit, ku asnjëra prej të cilave nuk është shkaktuar nga rreziku i një ndalimi të bashkimit ose vendosja e një gjobe. (Vendimi i AK-së, Nr. 150 2010: 88)

Aktiviteti i AK-së në fushën e kontrollit të përqëndrimeve ka prekur sektorë të ndryshëm të ekonomisë shqiptare, duke përfshirë: sigurimet, sektorin bankar, energjitikën, tregtinë e lirë, ndërtimet, privatizimin dhe rafinimin e naftës, etj.

Ligji shqiptar i konkurrencës është i zbatueshëm për sipërmarrjet publike dhe sipërmarrjet private të cilat kanë marrë nga shteti të drejtat ekskluzive për operimin në shërbime me interes të përgjithshëm social dhe ekonomik ose që kanë karakterin e një monopoli që sjell të ardhura në masën që ligji i përcakton si subjekte kontrolli nga Autoriteti. Veprimtaria e këtyre ndërmarrjeve nuk është penguar, por duhet t'i nënshtrohet kontrollit të AK-së, ku për këtë të fundit do të jetë një sfidë e madhe me të cilën duhet të përballet.

2.6 Konkluzion

Në këtë kapitull janë trajtuar konceptet përkatëse të së drejtës së konkurrencës duke vendosur në fokus historikun e saj që nga krijimi në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, fillimet në Bashkimin Europian dhe krijimin e kësaj të drejte në shtetin e ri të pas viteve '90 në Shqipëri. Në këtë pjesë të punimit, vihet në dukje qëllimi dhe objektivat e të drejtës së konkurrencës në përgjithësi dhe përqëndrimeve të ndërmarrjeve në veçanti. Theksohet, sesi sanksionimi i kësaj të drejte kontribuon në një zhvillim të qëndrueshëm të personave juridikë me karakter tregtar dhe mirë-funksionimin e tregut në tërësi. Një vëmendje e veçantë i kushtohet impaktit pozitiv që ka zhvillimi i të drejtës dhe praktikave antikonkurruese në kuadër të

përqëndrimeve duke rritur cilësinë e konkurrueshmërisë dhe besimin në ushtrimin e veprimtarisë. Qasjet pro dhe kundër aplikimit të këtyre të drejtave janë pjesë e trajtuar në këtë kapitull ku tregohen qëndrimet e grupeve të autoreve për argumentët nëse janë për aplikimin e këtyre praktikave nga formacionet ekonomike ose nëse janë kundër këtyre operacioneve për përqëndrimet e shoqërive tregtare.

Zhvillimi i kësaj të drejte u vendos në qendër të kapitullit të shqyrtuar duke nxjerrë në pah mënyrat e ndryshme të ecurisë në vendet e marra në shqyrtim për efekt studimi. Në të drejtën e BE-së kjo e drejtë filloi që me Traktatin e Qymyrit dhe Çelikut duke vazhduar më tej me rregullimet ligjore që pasuan ndër vite progresin dhe aplikimin e konkurrencës efektive në kuadër të garantimit të të drejtave të konsumatorit dhe ecurisë pozitive të tregjeve të vendeve komunitare. Një rol të veçantë, përveç hartimit të legjislacionit dhe rinovimit të tij sipas nevojave të tregjeve që gradualisht po shkojnë drejt globalizimit, ka luajtur edhe Komisioni European për monitorimin e sjelljeve të ndërmarrjeve në kuadër të konkurrencës efektive dhe përqëndrimeve duke garantuar një premisë pozitive për zhvillim për tregun european dhe kompanitë ndërkombëtare që kërkojnë të ushtrojnë veprimtari në Europë.

Në rastin e Shqipërisë u trajtua zhvillimi i të drejtës së konkurrencës, dhe Autoriteti si organi kryesor që përbën këtë institucion, duke vënë në dukje dhe ndryshimet ligjore ndër vite, duke filluar që me ligjin e parë për mbrojtjen e konkurrencës deri në ndryshimet e fundit ligjore për efekt të përmirësimit të praktikave nëpërmjet adoptimit të ligjeve të Bashkimit European por edhe ligjeve të shteteve të zhvilluara perendimore, të cilat kanë ardhur jo vetëm nga nevoja por edhe nga Marrëveshja e Stabilizim Asociimit (MSA) si dhe statusi si “Vend Kandidat” për Bashkimin European që Shqipëria e ka marrë së fundmi.

Në përfundim të këtij kapitulli, mund të themi se kuadri ligjor i Shqipërisë mbi përqëndrimet e ndërmarrjeve ekziston “de jure”, por duhet parë nëse aplikohet “de facto” në bazë të mangësive të mundshme ligjore apo praktikës gjyqësore, që në rastin e Shqipërisë është shumë e mangët.

KAPITULLI III – OPERACIONET E PËRQËNDRIMIT TË NDËRMARRJEVE ME ANË TË BASHKIMIT/SHKRIRJES (MERGER)

3.1 Përqëndrimet e ndërmarrjeve dhe mënyra e krijimit të tyre në kuadër të konkurrencës efektive

Përqëndrimi ndodh kur dy ose më shumë ndërmarrje bashkohen në një ndërmarrje të vetme dhe pushojnë së ushtruari aktivitet si njësi të ndara ekonomike dhe ligjore. Bashkimin e kemi me shkrirje, kur dy shoqëritë shkrihen me njëra tjetrën dhe formojnë një shoqëri të re, dhe me përthithje, kur një shoqëri tregtare përthithet nga një tjetër, ku kompania përthithëse mban identitetin ligjor ndërsa kompania tjetër pushon së ekzistuari si person juridik. (Ghidini, Cavani, Di Porto: 2003, 27) Menaxhimi i përbashkët ekonomik është gjithashtu një mënyrë përqëndrimi duke bërë të mundur kombinimin e aktiviteteve të ndërmarrjeve të pavarura në një njesi të vetme ekonomike duke ruajtur personalitetin juridik respektiv.

Operacionet e përqëndrimit të ndërmarrjeve konsiderohen si procese që sjellin reduktimin e kostove dhe rritjen e efikasitetit. (Fattori, Todino: 2011, 267) Përqëndrimet synojnë të ndikojnë në mos-zhvillimin e strukturave të tregut duke forcuar kështu pozitën dominuese të një ose më shumë ndërmarrjeve në atë nivel që të krijohen premiset për shkeljen e konkurrencës së lirë në dëm të konkurrentëve ose konsumatorëve. Për këtë arsye, në çdo vend demokratik dhe modern, kontrolli i këtyre përqëndrimeve është i normuar dhe i sanksionuar në legjislacionet përkatëse, dhe duhet theksuar se jo të gjitha bashkimet e shoqërive tregtare janë abuzuese.

Fillesat e sanksionimit të kësaj praktike në të drejtën europiane janë që me Urdhëresën e Vjetër të Kontrollit të Fusioneve. Më vonë u nxor dhe Urdhëresa e Re e Kontrollit të Bashkimeve nr. 139/2004. Një përqëndrim ka një dimension kumunitar nëse:

- E ardhura e agreguar botërore (nga aktiviteti i zakonshëm dhe pas taksave mbi të ardhurat) e të gjithë sipërmarrjeve të shqyrtuara (në rast blerjeje të pjesshme të ndërmarrjes, vetëm e ardhura që lidhet me pjesën që është subjekt përqëndrimi duhet të merret parasysh) është më shumë se 5 (pesë) miliardë euro, dhe:
- E ardhura komunitare e agreguar e secilës nga të paktën 2 ndërmarrjet pjesëmarrëse është më shumë se 250 milionë euro, përveç kur, secila nga ndërmarrjet pjesëmarrëse arrin më shumë se dy të tretën e të ardhurës së agreguar komunitare në një shtet anëtar.

Në rast se nuk arrihen këto pragje, një përqëndrim ka gjithsesi dimension komunitar nëse:

- E ardhura botërore e agreguar e të gjitha ndërmarrjeve pjesëmarrëse është më e madhe se 2.5 miliardë euro, dhe:
- Në secilin nga të paktën tre shtete anëtare, e ardhura e kombinuar e agreguar e të gjitha ndërmarrjeve pjesëmarrëse është më shumë se 100 milionë euro, dhe:
- Në secilin nga të paktën tre shtete anëtare të përfshira për qëllim të pikës së dytë më sipër të cituar, e ardhura e agreguar e të paktën dy prej ndërmarrjeve të shqyrtuara është më shumë se 25 milionë euro, dhe:
- E ardhura e agreguar komunitare e secilës nga të paktën 2 ndërmarrjet e shqyrtuara është më shumë se 100 milionë euro, përveç kur, secila nga ndërmarrjet pjesëmarrëse arrin më shumë se dy të tretën e të ardhurës të saj të agreguar komunitare në një shtet të vetëm anëtar.

Për mbikqyrjen e këtyre veprimeve u angazhua Komisioni. (Këshilli European, Urdhëresa nr. 139/2004, 2004: ABL L 24, 1)

Në Shqipëri përqëndrimet e ndërmarrjeve janë të sanksionuara në ligjin për mbrojtjen e konkurrencës. Në të drejtën shqiptare të konkurrencës, që të jemi para një bashkimi me qëllim abuzimi, duhet që të bashkohen dy ose më shumë ndërmarrje ose pjesë ndërmarrjesh të pavarura nga njëra - tjetra; në çdo transaksion, nëpërmjet të cilit një ose më shumë ndërmarrje përftojnë kontroll, të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, të një ose më shumë ndërmarrjeve ose të një pjese të këtyre të fundit; kur krijohet një ndërmarrje e përbashkët, që kryen të gjitha funksionet e një *njësie ekonomike të pavarur*³. Organi kompetent për vëzhgimin e këtyre praktikave abuzuese është Autoriteti i Konkurrencës. Autoriteti, në bazë të ligjit për mbrojtjen e konkurrencës dhe akteve nënligjore në zbatim të tij duhet të marrë në shqyrtim përqëndrimet e ndërmarrjeve në rastet kur shkaktohet një ndryshim i qëndrueshëm i kontrollit si rrjedhojë e bashkimit të dy ose më shumë ndërmarrjeve ose pjesëve të ndërmarrjeve të pavarura nga njëra-tjetra; përfuturit të kontrollit të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, nga një ose më shumë persona fizikë, të cilët njëkohësisht kanë kontrollin e të paktën një ndërmarrje tjetër; nga një ose më shumë ndërmarrje të cilat ushtrojnë kontrollin, mbi një ose më shumë ndërmarrje, ose të një pjese të këtyre të fundit, përmes blerjes së aksioneve, kuotave apo aseteve, kontratës ose çdo mjeti tjetër të ligjshëm; kontrollit të drejtpërdrejtë ose të tërthortë mbi një ose më shumë ndërmarrje ose të një pjese të këtyre të fundit. (Ligji, 9121/2003)

Moment i rëndësishëm është kur Autoriteti nuk merr në shqyrtim përqëndrimet dhe rastet janë: 1. Komisioni ndalon përqëndrimet e ndërmarrjeve, që kufizojnë, në mënyrë të

³ Konsiderohet se ka funksionin e një njësie ekonomike të pavarur, kur një ndërmarrje ka të gjitha burimet e kërkuara që të veprojë si e tillë. Pra, varësia ekonomike e ndërmarrjes është e përcaktuar nga asambleja e saj.

ndjeshme, konkurrencën në treg ose në një pjesë të tij, në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese. 2. Komisioni, në vlerësimin e përqëndrimeve, mund të marrë gjithashtu parasysh, eficientat ekonomike që mund të rrjedhin nga përqëndrimi, nëse plotësohen të gjitha kushtet e mëposhtme: a) eficientat në fjalë kontribuojnë në rritjen e mirëqenies së konsumatorëve ose, të paktën, neutralizojnë efektet e mundshme negative që mund të sillte përqëndrimi; b) eficientat ekonomike janë ose do të jenë rezultat i përqëndrimit nën shqyrtim dhe, për krijimin e tyre, nuk ekzistojnë mënyra alternative më pak antikonkurruese, se përqëndrimi në fjalë; c) eficientat ekonomike duhet të jenë të verifikueshme. 3. Komisioni, në raste të veçanta, mund të mos ndalojë përqëndrimet, kur njëra nga ndërmarrjet pjesëmarrëse rrezikon seriozisht të falimentojë e nuk ka mundësi tjetër më pak antikonkurruese se realizimi i përqëndrimit nëse: a) ndërmarrja ndodhet në një situatë të tillë që, pa këtë përqëndrim, duhet të dalë nga tregu në një të ardhme të afërt; b) nuk ka mundësi për riorganizimin e veprimtarisë së kësaj ndërmarrje.

Në qoftë se i referohemi legjislacionit në fuqi duhet bërë një ndarje midis riorganizimit të shoqërive në kuadër të ligjit “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” dhe ligjit “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”. Riorganizimi i shoqërisë mund të realizohet nëpërmjet bashkimit me një shoqëri tjetër, ndarjes në dy apo më shumë shoqëri, ose me shndërrimin e formës ligjore. Riorganizimet e shoqërive tregtare parashikojnë edhe raste të veçanta bashkimi, ku mund të përmendet përthithja e një shoqërie nga mëma, e cila zotëron të paktën 90% të aksioneve të shoqërisë së përthithur. Problematikat e hasura në këtë aspekt kanë të bëjnë me mbrojtjen e interesave të pakicës, ku ligji ka përcaktuar që APA mund të mblidhet për të dhënë miratim kur këtë e kërkojnë aksionarët ose ortakët e shoqërisë mëmë, që zotërojnë të paktën 5% të

kapitalit të regjistruar. Një rast tjetër ka të bëjë me përrhithjen e një shoqërie nga mëma, e cila zotëron 100% të aksioneve të shoqërisë së përrhithur.

Procesi i bashkimit me përrhithje bën që shoqëria përrhithëse të detyrohet të rrisë kapitalin në mënyrë që aksionet/kuotat e reja t'u shpërndahen aksionarëve/ortakëve të shoqërive të përrhithura.

Në legjislacion është e parashikuar një parakusht për të gjitha llojet e ristrukturimeve në tërësi dhe të përqëndrimeve në veçanti, ku shoqëritë mund të kryejnë operacione të tilla vetëm në rast se kanë qenë të regjistruara për të paktën 1 (një) vit, me qëllim garantimin e qëndrueshmërisë fillestare të shoqërisë. Ligji përcakton se përfaqësuesit ligjorë të shoqërisë, ekspertët e vlerësimit ashtu si dhe shoqëria janë përgjegjës solidarisht dhe pa kufizim ndaj të tretëve për dëmin e shkaktuar. Dispozitat e ligjit në fjalë parashikojnë që, pas zhdëmtimit të të tretëve, këto subjekte mund të ngrenë padi ndaj njëri - tjetrit për të vërtëtuar përgjegjësinë individuale në shkaktimin e dëmit. (Ligji 9901/2008) Subjektet e sipërcituara nuk mund të bëhen përgjegjës për dëmet që pësojnë të tretët nëse procedurat ligjore të bashkimit dhe vlerësimit janë ndjekur në mënyrë korrekte. Kështu, e rëndësishme është të vihet në dukje rëndësia e respektimit të procedurave dhe standarteve ligjore nga të gjithë aktorët e përfshirë në këto lloj operacionesh. (Malltezi: 2011, 279)

Një moment i rëndësishëm është ndarja e shoqërive, e cila realizohet duke transferuar të gjitha aktivet dhe pasivet e veta në favor të dy ose më shumë shoqërive ekzistuese apo të themeluara rishtazi. Shoqëria që ndahet vlerësohet e prishur, por nuk kalon në proces likuidimi. (Ligji 9901/2008, Neni 227) Sipas përcaktimeve ligjore, në të gjitha rastet vendimin për ndarje e merr AP-ja, dhe ky vendim duhet regjistruar në QKB. Njësoj si rastet e bashkimit dhe ndarjes, parashikimet ligjore kanë trajtuar edhe rastet e shndërrimit të

shoqërive në këto forma: a) shndërrimin e shoqërive me përgjegjësi të kufizuar, në shoqëri aksionare dhe anasjelltas; b) shndërrimin e një shoqërie aksionare me ofertë private në një shoqëri aksionare me ofertë publike dhe anasjelltas. Një proces i tillë nuk çon në prishjen e shoqërisë që shndërrohet e për rrjedhojë nuk sjell pasoja mbi të drejtat dhe detyrimet që shoqëria ka marrë përsipër ndaj të tretëve. (Ligji 9901/2008, Neni 228/3) Shoqëria e shndërruar mbart të gjitha detyrimet ndaj kreditorëve të shoqërisë në formën e mëparshme dhe ligji gjen përsëri me vend rregullimin e të drejtave të kreditorëve dhe garancive që u ofrohen. Si tek ndarja dhe bashkimi, ashtu edhe tek shndërrimi i ndërmarrjeve kemi vendimin e AP-s që ligjëron dhe bën të mundur kalimin e shoqërisë nga një formë në një tjetër, duke publikuar në QKB vendimin për ndryshim forme.

Në këto raste kur shoqëria kërkon që të aplikojë operacionet, kreditorët janë të mbrojtur sepse mund të kërkojnë që pretendimet e tyre të shlyhen ose të sigurohen me garanci, dhe mund t'i drejtohen gjykatës në rast se nuk është dhënë garanci e mjaftueshme. Aksionarët që nuk kanë dhënë pëlqimin, nga ana tjetër, kanë të drejtë t'ia shesin aksionet e tyre shoqërisë së re me vlerën e tregut. Këtu aplikohet instituti i parablerjes që është një parashikim i ligjor i Kodit Civil. E drejta e parablerjes zbatohet vetëm në rastet kur objektet janë në bashkëpronësi të dy ose më shumë personave dhe një ose disa nga bashkëpronarët kërkojnë që ta tjetërsojnë me kundërshtëpërbllim pjesën e tyre në favor të personave të tretë jo bashkëpronarë. Ligji përcakton që më parë, pjesa që kërkohet të tjetërsohet duhet t'i ofrohet bashkëpronarëve dhe në rast se këto të fundit nuk duan që t'i blejnë, pastaj mund t'i drejtohen personave jashtë bashkëpronësisë. E njëjta situatë vlen edhe për pronësinë mbi personat juridikë. (Nuni: 2010, 179) Në mënyrë alternative aksionarët mund të kërkojnë që shoqëria përthithëse të këmbejë aksionet e tyre me përparësi pa të drejtë vote, në aksione me të drejtë vote.

3.2 Përfthimi i kontrollit në kuadër të bashkimit/shkrirjeve

Praktika e përqëndrimit ndodh kur një ose më shumë ndërmarrje ose pjesë ndërmarrjesh të pavarura nga njëra - tjetra, bashkohen duke krijuar një ndërmarrje të re. Mënyrat e krijimit mund të jenë shkrirje për bashkim ose shkrirje për krijim. (Galgano: 2009, 1024) Një përqëndrim mund të ndodhë edhe në rastet kur një shoqëri është përthithur nga një tjetër, ku shoqëria përthithëse e mban identitetin ligjor, ndërsa shoqëria e përthithur shuhet si njësi ligjore dhe për rrjedhojë edhe ekonomike. Bashkimi me krijimin e një shoqërie të re, nuk lejon që shoqëritë e përfshira në bashkim të vazhdojnë ekzistencën, por si rezultat i shkrirjes së aseteve krijohet një entitet ligjor i ri, krejtësisht i ndryshëm nga shoqëritë e përfshira në bashkim. (Neni 215, Ligji 9901/2008)

Për ta konkretizuar po ilustroj një vendim të KK-së. Komisioni i Konkurrencës⁴, pas shqyrtimit të raportit mbi njoftimin e përqëndrimit CMA CGM Albania shpk / CMA CGM Agencies Worldwide / Pelikan shpk, në lidhje me transaksionin, vërejti se përqëndrimi realizohet në bazë të “Marrëveshjes së Ortakëve” e lidhur më datë 25 Qershor 2014, ndërmjet palëve CMA CGM Agencies Worldwide dhe Pelikan shpk në cilësinë e ndërmarrjeve mëmë, me objekt krijimin e ndërmarrjes së re të pavarur CMA CGM Albania shpk. Ndërmarrja e përbashkët CMA CGM Albania shpk, u krijua në bazë dhe në zbatim të “Marrëveshjes së Ortakëve”, në të cilën shoqëritë Pelikan shpk dhe CMA CGM Agencies Worldwide ranë dakord që të investojnë pjesë të kapitalit të tyre themeltar për krijimin e ndërmarrjes së përbashkët CMA CGM Albania shpk, ku përkatësisht Pelikan shpk do të ishte zotërues i 40%

⁴ Vendime të ngjashme: Vendimi Nr. 299, datë 06.12.2013 “Mbi autorizimin e përqëndrimit” të realizuar nëpërmjet shitblerjes së 100% të aksioneve të shoqërisë Europa Kazino 2009 sha nga z. Edmond Plaku dhe Vendimi Nr. 318, datë 02.06.2014 “Për vendosje gjobe” ndaj shoqërisë/ndërmarrjes Heaney Assets Corporation për mosdhënie të dhënash brenda afatit kohor të përcaktuar në vendimin e Komisionit.

të kuotave të kapitalit themeltar dhe CMA CGM Agencies Worldwide, do të ishte zotërues i 60% të kuotave të kapitalit themeltar. Ndërmarrja e përbashkët CMA CGM Albania shpk nuk do të funksiononte si një ndërmarrje për të bashkërenduar veprimtarinë e mëmave të saj, por si një ndërmarrje e përbashkët në përputhje të plotë me nenin 10.3 të ligjit, dhe për pasojë në bazë të pretendimeve përbënte një përqëndrim.

Tregu përkatës i produktit u analizua në përputhje me rregulloret dhe udhëzimet për përqëndrimet dhe sipas veprimtarisë që kryejnë palët pjesëmarrëse në këtë transaksion, tregu përkatës produkti u konsiderua: Transporti detar i kontenierëve (import/eksport). Tregu përkatës gjeografik: Për vlerësimin e këtij transaksioni dhe efektet që do të sjellë në treg, tregu përkatës gjeografik u konsiderua tregu i brendshëm / territori i Republikës së Shqipërisë. (Komisioni i Konkurrencës, Vendimi 340/2014)

Komisioni pasi shqyrtoi çështjen vlerësoi se CMA CGM Albania shpk në mënyrë të pavarur nga aktiviteti i shoqërive mëma, duke mos cënuar dhe interferuar në asnjë rast veprimtarinë e tyre apo pozitën e tyre në treg, do të vepronte në cilësinë e agjentit të shoqërisë CMA CGM, duke pritur dhe trajtuar kontenierët e kësaj linje që mbërrijnë dhe nisen nga Shqipëria (import/eksport). Shoqëria Pelikan sh.p.k. nga ana e saj, me krijimin e ndërmarrjes së përbashkët (JV) CMA CGM Albana shpk, do të hiqte dorë nga aktiviteti të cilin e kryente deri tani si agjent i shoqërisë CMA CGM dhe do të vazhdonte punën e saj në aktivitetet e tjera të transportit dhe logjistikës sipas Statutit dhe Aktit të Themelimit të saj. Krijimi i shoqërisë CMA CGM Albania shpk nuk do të sillte asnjë efekt në strukturën dhe konkurrencën e tregut vendas. Me krijimin e kësaj shoqërie të re JV, palët besonin se do të kishte rritje të përfitimeve në dobi të konsumatorëve në aspektin e rritjes së cilësisë së shërbimeve si edhe të rritjes të kapaciteteve transportuese. CMA CGM Agencies Worldwide

do të vazhdonte aktivitetin e saj në transportin e ngarkesave të kontenierizuar (import/eksport) brenda territorit të Republikës së Shqipërisë me ndryshimin e vetëm se kontenierët e shoqërisë CMA CGM Agencies Worldwide që mbërrinin dhe niseshin nga Shqipëria, që deri atëherë ishin trajtuar nga shoqëria Pelikan shpk, me krijimin e shoqërisë CMA CGM Albania shpk do të trajtoheshin prej saj. Si konkluzion, ky përqëndrim, pra krijimi i shoqërisë (JV) CMA CGM Albania shpk nuk do të sillte ndryshime në strukturën dhe konkurrencën e tregut vendas. Sa më sipër, ky përqëndrim nuk shfaqte shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese, dhe për këto arsye duhet të autorizohet në përputhje me nenin 56/1 të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar. Komisioni për këto arsye, vendosi të autorizonte përqëndrimin e realizuar nëpërmjet krijimit të një ndërmarrje të pavarur CMA CGM Albania shpk nga ndërmarrjet CMA CGM Agencies Worldwide dhe Pelikan shpk.

Organizata Botërore e Tregtisë është një ndër institucionet më të rëndësishme ndërkombëtare në rregullimin e marrëdhënieve tregtare ndërmjet subjekteve të ndryshme, person (fizik, juridik) - person (fizik, juridik) apo person - shtet. Në kuadër të marrëdhënies me biznesin, kjo organizatë jep kontributin e vet me sanksionimin e të drejtës së konkurrencës dhe në veçanti të përqëndrimeve, dhe kështu mundësohet implementimi i rregullave për konkurrencën efektive nëpërmjet dispozitave të ndryshme të cilat e sanksionojnë këtë fushë të së drejtës. Një element i mundshëm në një marrëveshje ndërkombëtare të tillë ka të bëjë me dispozitat për bashkimet dhe marrjet e kontrollit të ndërmarrjeve (mundësisht duke përfshirë edhe aleancat strategjike). Marrëveshjet e bashkimeve ndërmjet shoqërive tregtare ndërkufitare dhe marrja e kontrollit mund të përbëjnë një kërcënim për konkurrencën në

tregun ndërkombëtar, por politikat kombëtare mbi bashkimet kanë ndryshuar edhe më shumë se ata që janë në marrëveshjet e kompanive të ndryshme. (Guizzi: 2010, 280). Deri kohët e fundit, shumë qeveri kanë përdorur politikën e bashkimit si një instrument në strategjinë kombëtare industriale, duke bllokuar hyrjen e ndërmarrjeve të huaja në sektorë të “ndjeshëm” strategjikë. Shumë vende në zhvillim ende shohin nevojën për kontrollin e bashkimeve si një mjet për t’u siguruar që kompanitë e huaja multinationale të mos kontrollojnë sektorët strategjike për zhvillim të vendeve respektive. (Marrë nga: <http://lse.ac.uk>) Marrëveshjet për dispozitat thelbësore në këtë fushë të së drejtës janë shumë të vështira për t’u arritur nga vendet që e aplikojnë, ndoshta përtej ambicieve dhe negociatave aktuale. Marrëveshja që është arritur për bashkimet në BE, erdhi vetëm tridhjetë vjet pasi u nënshkrua Traktati i Romës. Megjithatë, ka pasur masa procedurale në marrëveshjet bilaterale të OECD-së që ndihmojnë për të shmangur konfliktet mes politikave kombëtare të bashkimit. Pavarësisht kuadrit ligjor që e parashikon, në të gjitha rastet e përqëndrimit supozohet se akti i shkrirjes është një kontratë ndërmjet kompanive. Kjo kontratë duhet regjistruar në bazë të ligjit nr. 131/2015 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”⁵ meqënëse me anë të saj formalizohet edhe marrëveshja mes palëve. QKB-ja ka për detyrë administrimin e regjistrit tregtar në Republikën e Shqipërisë dhe përcakton subjektet që regjistrohen bashkë me procedurat e regjistrimit të kërkuara nga legjislacioni në fuqi. (Neni 17, Ligji 131/2015) Në rast të mosdepozitimit të aktit në këtë organ të administratës shtetërore, marrëveshja midis ndërmarrjeve mbetet vetëm në kuadër të marrëdhënies mes tyre dhe jo jashtë kësaj reze,

⁵ Kur është nisur punimi shkencor ka qenë Ligji i vjetër “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, por në vitin 2015 ligji u ndryshua duke ndryshuar kompetencat organit dhe emrin në Ligji Nr. 131/2015, “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”, kështu që në punim janë reflektuar edhe ndryshimet e fundit ligjore në këtë aspekt.

duke mbajtur statusin e *akteve të brendshme*⁶ të shoqërive. Sidoqoftë, procedura e bashkimit të shoqërive fillon me hartimin e projekt-marrëveshjes për realizimin e bashkimit që hartohet nga përfaqësuesit ligjorë të shoqërive që përfshihen në bashkim.

Përsa i përket ndërmarrjeve pjesëmarrëse në bashkim/shkrirje, duhet të përcaktohen ndërmarrjet që janë pjesëmarrëse në praktikën e aplikuar. Kjo ka rëndësi sepse ka të bëjë me faktin se cilat nga ndërmarrjet janë objekt përftimi të kontrollit, në varësi nëse janë një pjesë e tyre apo të tërat.

Rastet më të zakonshme të përfimit të kontrollit janë ato që kanë në qendër një kontroll ekzskluziv të një shoqërie tregtare. Në këto raste statusin e ndërmarrjeve pjesëmarrëse e kanë shoqëritë tregtare përfutuese dhe shoqëritë tregtare të përfutuara. Përftimi i një pjesë të një ose më shumë ndërmarrjeve mund të realizohet edhe në rastet kur llogaritet xhiroja që i takon vetëm palëve që janë objekt transaksioni.

Përftimi i kontrollit të përbashkët në krijimin e një shoqërie tregtare të re, ndërmarrje pjesëmarrëse është secila nga ndërmarrjet që përfton kontrollin e shoqërisë së re të përbashkët. Rregulli është i njëjtë edhe për ndërmarrjen që sjell një ndërmarrje të re të kontrolluar më parë ose një aktivitet tek ndërmarrja e përbashkët e sapo themeluar (Komisioni i Konkurrencës, Vendimi 236/2012)

Një përqëndrim mund të jetë objekt njoftimi për rrjedhojë të ndryshimit në cilësinë e kontrollit në një strukturë kontrolli të përbashkët, si pasojë e hyrjes së aksionerëve të rinj, kontrollues në rastin konkret.

⁶ Aktet e brendshme të shoqërive janë korpusi i dokumentacionit që ka një shoqëri tregtare, që nga statuti deri tek rregulloret e funksionimit të shoqërisë në kuadër të organigramës së shoqërisë.

Kontrolli i përbashkët duhet të njoftohet në mënyrë të përbashkët nga ndërmarrjet përfutuese, ku e njëjta situatë parashikohet edhe për aksionarët e shoqërive, si subjekte operacioni.

Konvertimi i aksioneve ose kuotave të shoqërisë ekzistuese në aksione ose kuota të shoqërisë përthithëse bazohet në një analizë ekonomike të situatës së shoqërisë ekzistuese ndaj të tretëve, kontratave të ardhshme dhe kontributeve të veçanta që mund të sjellë kjo shoqëri. Një aspekt tjetër i rëndësishëm është krahasimi ndërmjet analizës ekonomike dhe llogaritjes së shkëmbimit, në mënyrë që raporti i këmbimit të kuotave apo aksioneve të shoqërisë së përthithur me ato të shoqërisë përthithëse të jetë i drejtë për pronarët e të gjitha shoqërive të përfshira. (Malltezi: 2011, 273) Të drejtat dhe detyrimet e shoqërive pjesëmarrëse në shkrirje nuk shuhet, sikurse nuk shuhet ato të shoqërisë që rezultojnë nga shkrirja apo shoqëria përthithëse, e cila merr të drejtat dhe detyrimet e shoqërive pjesëmarrëse nga shkrirja, duke vazhduar tërë marrëdhëniet e tyre edhe nga ana procedurale. (Pannuci, Matonti: 2011: 148) Në këtë kontekst, marrëdhënia procedurale paraqitet si vazhdimësi, me anë të së cilës është synuar të përjashtohet mundësia që shkrirja të provokojë sipas neneve 299-300 të Kodit të Procedurës Civile ndërprerjen e procesit në të cilin është pjesë një shoqëri pjesëmarrëse në një shkrirje. (Nenet 299-300, Kodi i Procedurës Civile i RSH) Për të përjashtuar asimilimin e shkrirjes me vdekjen e personit fizik është hequr dorë nga teoritë e ndryshme për shoqëritë e inkorporuara apo për shoqëritë pjesëmarrëse në shkrirjen që krijon një shoqëri të re.

Në kuadër të operacioneve të trajtuara më sipër, Komisioni i Konkurrencës në rastin e fundit të shqyrtuar në këtë aspekt ka autorizuar një përqëndrim me shkrirje. KK-ja ka nxjerrë vendimin në sektorin bankar për shoqëritë Alpha Bank S.A dhe EFG Eurobank Ergasias S.A. Konkretisht, Komisioni pas shqyrtimit të raportit mbi njoftimin e përqëndrimit Alpha Bank S.A dhe EFG Eurobank Ergasias S.A dhe relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm, vërejtje në

lidhje me transaksionin se përqëndrimi me objekt bashkimin me përthithje ndërmjet bankave greke Alpha Bank dhe Eurobank, u realizua me anë të ‘Marrëveshjes së Implementimit’ të datës 29 Gusht 2011. Transaksioni realizohej në formën e bashkimit me përthithje i cili në kuptim të nenit 10, pika 1, shkronja a) e Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, është përqëndrim, i cili sjell ndryshim të kontrollit në ndërmarrjen target (Eurobank) nëpërmjet përfuturit të kontrollit ekskluziv të saj nga Alpha Bank. Transaksioni i realizuar ndërmjet palëve pjesëmarrëse në kuptim të nenit 10/1/a të ligjit, ishte ndryshim kontrolli në formën e bashkimit me përthithje. Gjithashtu përqëndrimi i njoftuar përmbushte edhe kushtet e nenit 12 të ligjit përse i përket xhirove (neni 12/1).

Palët në transaksion plotësonin kriteret e xhiros të përcaktuara në nenin 12, pika 1 e ligjit. Kështu, KK-ja analizoi se përse i përket tregut të produktit: Referuar Udhëzuesit “Për Përcaktimin e Tregut Përkatës”, si dhe mbështetur në veprimtarinë e palëve, treg përkatës do të konsiderohej ofrimi i shërbimeve bankare për individë (retail banking) dhe korporata bankare (corporate banking). Konkretisht ofrimi i shërbimeve bankare për individë dhe korporata (Retail Banking dhe Corporate Banking); Depozita dhe shërbime për llogaritë (llogari kursimi, llogari rrjedhëse etj); Kreditim (kredi personale, kredi konsumi, overdraft , kredi për binzese etj); Bono thesari.

Në lidhje me tregun gjeografik, Alpha Bank Albania operonte me 48 degë në të gjithë vendin dhe rreth 60 ATM. Eurobank nuk ishte prezent në tregun Shqiptar, pra nuk kishte ndonjë filial, degë apo shoqëri të lidhur apo aktive (apo ndonjë formë tjetër aktiviteti) në Shqipëri. Për analizimin e këtij rasti, treg gjeografik do të konsiderohej tregu kombëtar, pra, tregu i brendshëm. Në tregun shqiptar ushtronin veprimtarinë e tyre në total 16 banka të nivelit të dytë, me kapital të huaj kryesisht me origjinë nga Bashkimi Europian. Tregu karakterizohej

nga ndryshime të shpejta përse i takon shtrirjes gjeografike dhe ofrimit të produkteve të reja. Tendencat pozitive në zgjerimin e tregut bankar me degë dhe agjenci kanë sjellë përmirësimin në mënyrë të dukshme të mbulimit dhe rritjes së cilësisë për produktet ekzistuese dhe ato të reja. Sipas konstatimeve të Autoritetit të Konkurrencës hyrja në tregun bankar rregullohet nëpërmjet ligjit “Për Bankat në Republikën e Shqipërisë” dhe akteve nënligjore që nxirren në zbatim të këtij ligji. Autoriteti përgjegjës për mbikëqyrjen dhe licencimin e bankave është Banka e Shqipërisë. Tregu është i hapur për konkurrencë, nuk ka barriera ndaj hyrjes së kapitalit të huaj dhe vendas, si dhe formës së organizimit të bankave (degë apo filial). Gjithashtu çelja e degëve dhe e çdo njësie tjetër bankare për ato banka që e kanë marrë licencën brenda territorit të Republikës së Shqipërisë është e lirë dhe nuk paraqitet nevoja për të marrë leje apo autorizim nga Banka e Shqipërisë, e cila zgjeron rrjetin e bankave, rrit konkurrencën dhe si pasojë rrit cilësinë e shërbimit të bankave. Nga ana tjetër edhe dalja nga tregu nëpërmjet shpërndarjes apo likuidimit është e mundur me qëllim zhvendosjen e bankave jo eficiente nga tregu. (Komisioni i Konkurrencës, Vendimi 206/2011)

Në lidhje me pozicionin në treg pas përqëndrimit, transaksioni i bashkimit nuk sillte ndryshim të strukturës së tregut bankar në Shqipëri pasi Eurobank nuk ishte prezent në Shqipëri me asnjë filial, degë, shoqëri të lidhur apo asete (apo ndonjë formë tjetër aktiviteti). Këto sinergji priteshin të arriheshin si rezultat i kombinimit të produkteve, të optimizmit të platformës së shërbimit (retail), prokurimit dhe eliminimit të dublikimit të disa funksioneve qendrore si dhe të krijimit të bazave për forcimin e fitimeve vjetore të Alpha Eurobank dhe forcimit të brendshëm të kapitalit dhe likuiditeteve, të cilat në mënyrë indirekte do të pasqyroheshin edhe në tregun e brendshëm. Komisioni vlerësoi se transaksioni realizohet në

formën e bashkimit me përthithje i cili në kuptim të nenit 10, pika 1, shkronja a) të ligjit është përqëndrim, i cili sillte ndryshim të kontrollit në ndërmarrjen target (Eurobank) nëpërmjet përfuturit të kontrollit ekskluziv të saj nga Alpha Bank. Pas realizimit të përqëndrimit pjesët e tregut të Alpha-Eurobank nuk ndryshonin, si rrjedhojë përqëndrimi i tregut sipas depozitave, kredisë dhe bonove të thesarit mbetet i njëjtë. Tregu do të vazhdonte i hapur për konkurrencë, pa barriera hyrëse dhe karakterizohej nga ndryshime të shpejta përsa i takon shtrirjes gjeografike dhe ofrimit të produkteve të reja.

Sipas analizës së sipërcituar, KK-ja doli në konkluzionin se përqëndrimi i realizuar nuk shfaqte shenja të kufizimit në mënyrë të ndjeshme të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese për shkak të përqëndrimit ndërmjet shoqërive Alpha Bank S.A dhe EFG Eurobank Ergasias S.A, duke e autorizuar përqëndrimin e realizuar nëpërmjet bashkimit me përthithje të shoqërive Alpha Bank S.A dhe EFG Eurobank Ergasias S.A .

Në shembullin e trajtuar më lart janë paraqitur të gjithë aspektet e vlerësimit nga Komisioni për përqëndrimin me shkrirje që shoqëritë tregtare respektive kanë kërkuar të zhvillojnë në kuadër të hapësirave që lejon korniza ligjore.

3.3 Forma e përqëndrimit të përbashkët, joint venture

Shoqëritë tregtare mund të kenë një gamë të gjërë bashkëpunimi. Ky bashkëpunim mund të jetë kontraktual, nëpërmjet ndarjes së pronësisë ose nëpërmjet ndërveprimit në drejtimin e shoqërive tregtare. Një grup korporatash përbëhet nga një korporatë mëmë si dhe disa filiale që janë tërësisht apo në shumicën e tyre nën pronësinë e korporatës mëmë. Pjesa më e madhe e juridiksioneve e përkufizojnë grupin e korporatave në të njëjten mënyrë, por rezultati

funksional i grupimit të kompanive të inkuorporuara, dallon në varësi të ligjit dhe legjislacionit të vendit përkatës. Ndërmarrjet kanë tendencë të krijojnë filiale për krijimin e një linje demarkacioni ndërmjet operimeve të një ndërmarrjeje në marrëdhënie me një tjetër. Në këto raste, shoqëria mëmë ende ka në pronësi filialin, por për shkak se filiali është i inkuorporuar, ka më shumë përparësi se një degë e shoqërisë mëmë, e cila ka menaxhimin, operimet si dhe sistemet financiare të veta. (Dine: 2006, 39)

Joint venture ose shoqëritë e përbashkëta, janë sipërmarrje tregtare të dy apo më shumë personave apo organizatave për të ndarë shpenzimet dhe fitimet e një projekti të caktuar tregtar. Ndërmarrja joint venture nuk është një organizatë tregtare, në kuptimin e një pronësie ortakërie, apo shoqërie tregtare. Ajo ka të bëjë me një marrëveshje mes palësh për një qëllim të caktuar dhe zakonisht për një afat kohor të caktuar. Këto ndërmarrje në disa raste mund të jenë informale në kuadër të një marrëveshje të fshehtë. Marrëveshjet mund të jenë tejet të ndërlikuara siç janë rastet e *konsurciumit*⁷. Megjithatë, këto lloj organizimesh kanë një rritje në numër vitet e fundit, pavarësisht përqindjes relativisht të lartë të mungesës së suksesit. (Marrë nga: <http://sagem-ds.com>) Ndërmarrjet e përbashkëta “Joint Venture” janë të përhapura dhe tërheqëse sepse u mundësojnë shoqërive tregtare të ulin si rreziqet ashtu edhe kostot. Një avantazh që theksohet është kursimi i parave dhe ulja e rrezikut përmes ndarjes së kapitalit dhe burimeve. Për ndërmarrjet e vogla kjo mënyrë e të zhvilluarit është shumë

⁷ Konsorciumi është bashkimi i disa shoqërive por me disa parametra ligjor të ndryshëm nga ata të shpk-ve dhe sha-ve. Konkretisht duhet që: Të jetë themeluar (në përputhje me legjislacionin që i zbatohet themelimit të tyre) si person juridik, me personalitet ligjor të ndryshëm nga ai i ortakëve/aksionarëve të tij; Të ketë aftësi paguese dhe të mos jenë në proces falimentimi apo në procedura likuidimi; Të zotërojnë burime njerëzore, teknike, profesionale, eksperiencë organizative në menaxhimin e kompanive të mëdha; Të zotërojnë burime financiare që nga llogaritë financiare të vitit të fundit financiar, të jenë të paktën të barabarta me 25 milionë euro (ose ekuivalenti në një monedhë tjetër). Marrëveshja e konsorciumit duhet të tregojë anëtarin, i cili do të jetë "kryesues" i konsorciumit, i cili do të ketë shumicën e pjesëmarrjes në konsorcium.

frytë-dhënëse sepse u lejon atyre që të punojnë me ndërmarrjet e mëdha duke pasur kështu qasje në tregje më të zgjeruara si dhe të rrisin teknologjinë nëpërmjet kërkimeve dhe zhvillimeve të hartuara nga më shumë se një subjekt.

Në mënyrë që të krijohet një formë përqëndrimi “joint venture”, duhet që ndërmarrja e përbashkët të kryejë funksionin e një njësie ekonomike të pavarur. Kur një ndërmarrje e përbashkët joint venture përfton kontrollin e një shoqërie, ndërhyrja e Autoritetit të Konkurrencës është vendimtare për të përcaktuar nëse ka përqëndrim apo jo dhe për rrjedhojë e përcakton fakti nëse ndërmarrja e përbashkët konsiderohet ndërmarrje pjesëmarrëse. Në rast se, në një joint venture ndërmarrjet mëma kanë për qëllim përfitimin, atëherë ndërmarrja konsiderohet pjesëmarrëse, ndërsa kur përftimi i kontrollit është në mënyrë direkte dhe të plotë nga kompania mëmë, atëherë kompania mëmë objekt transaksioni do të konsiderohet pjesëmarrëse.

Në të drejtën e BE-së, përqëndrimet e ndërmarrjeve të përbashkëta janë të parashikuara në Rregulloren 139/2004.

Një ndërmarrje e përbashkët do të kapet nga rregullorja e shkrirjeve nëse ajo rezulton në krijimin e një njësie ekonomike të pavarur. Shoqëritë që kanë burime të mjaftueshme financiare dhe që kanë burime për të funksionuar si biznes në një periudhë afatgjatë mund të konsiderohen si ndërmarrje të përbashkëta. Në bazë të nenit 3 të rregullores 139/2004, Komisioni ka marrë parasysh disa elementë kur një transaksion mund të konsiderohet përqëndrim: 1) Palët shkrihen, u transferojnë apo licensojnë mbi baza të përhershme prodhimin e tyre ekzistues, pasuritë e tregtimit dhe shpërndarjen, njërive të ngritura nga ato vetë. Në këto raste punonjësit do të transferohen në njësitë vepruese; 2) Produktet do të tregtohen nën emrin e përbashkët tregtar; 3) Në kuadër të aktivitetit kërkues për zhvillimin

dhe kërkimin, pavarësisht se është i ndarë, shoqëritë mund të bashkëpunojnë në zhvillimin e prodhimeve të ardhshme. (Këshilli European, Rregullorja 139/2004) Në nenin 1 pika 2 të rregullores paraqitet dimensionin komunitar i përqëndrimit. Në këtë dispozitë paraqitet dimensionin komunitar kur: a) fitimi i kombinuar i përbashkët botëror i të gjitha ndërmarrjeve është më shumë se 5 miliardë euro; b) fitimi i përbashkët mbarëkomunitar i secilës prej së paku dy ndërmarrjeve në përqëndrim është më shumë se 250 milion euro, përveç rasteve kur secila nga ndërmarrjet pjesëmarrëse arrin më shumë se dy të tretat e fitimit të saj të përbashkët ndërkomunitar brenda një shteti të caktuar.

Një shembull konkret i operacionit të përqëndrimit është rasti i shqyrtuar nga Komisioni për krijimin e një ndërmarrje të përbashkët, por duhet pasur parasysh se në legjislacionin shqiptar “joint venture” janë bashkime të përkohshme për projekte të caktuara dhe nuk kanë në fokus krijimin e një ndërmarrjeje të re. Ndërmarrjet që bashkohen në kuadër të “joint venture” vazhdojnë të ekzistojnë si persona juridikë. Në rastin që do të trajtohet kemi krijimin e një ndërmarrjeje të përbashkët që mund të konfundohej me një “joint venture”. Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të raportit mbi njoftimin e përqëndrimit “Magyar Telekom Nyrt / Met Holding AG”, vërejti se në lidhje me transaksionin përqëndrimi realizohej me anë të “Marrëveshjes së Aksionerëve” të datës 11 mars 2015, e lidhur ndërmjet palëve: Magyar Telekom Nyrt dhe MET Holding AG (në cilësinë e ndërmarrjeve mëma), me objekt krijimin e një shoqërie të përbashkët të pavarur në formën e Joint Venture full function (JV). Sipas marrëveshjes së aksionerëve, palët kanë rënë dakord që të themelojnë një ndërmarrje të përbashkët si një entitet me personalitet juridik të veçantë, në formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar. Me themelimin e shoqërisë së përbashkët JV, aksionet e saj do të zotërohen në mënyrë të barabartë nga mëmat. Ky transaksion, i cili realizohej në formën e

krijimit të një ndërmarrje të përbashkët të pavarur nga ndërmarrjet mëma (Magyar Telekom dhe MET Holding) në kuptim të nenit 10, pika 3) të ligjit, përbënte një përqëndrim. Gjithashtu përqëndrimi i njoftuar përmbushte edhe kushtet e nenit 12 të ligjit përse i përket xhirove (neni 12/1). (Komisioni i Konkurrencës, Vendimi 364/2015)

Tregu përkatës i produktit: Referuar veprimtarisë ekonomike të palëve të përfshira në transaksion si dhe në përputhje me praktikën e përcaktimit të tregut të aplikuar nga KE, tregu përkatës produkti do të konsiderohej: shpërndarja (furnizimi) me pakicë dhe shumicë e gazit natyror; shitja me pakicë dhe shumicë e energjisë elektrike si dhe gjenerimi i energjisë elektrike. Tregu përkatës gjeografik: Për analizimin dhe vlerësimin e efekteve që do të shkaktojë ky transaksion në tregun përkatës të produktit, tregu përkatës gjeografik u konsiderua tregu i brendshëm.

Duke vlerësuar përqëndrimin Komisioni u shpreh se përqëndrimi nuk sillte asnjë efekt në tregun shqiptar, pasi asnjë prej palëve pjesëmarrëse në këtë transaksion nuk ishte aktive në aktivitetin e tyre ekonomik në tregun e brendshëm dhe për pasojë ky përqëndrim nuk shkakonte mbivendosje të aktivitetit të palëve në Shqipëri. Duke pasur parasysh se në tregun e brendshëm, ndërmarrja Albanian Mobile Communication/AMC (e cila është pjesë e grupit Deutsche Telekom, ku bën pjesë dhe Magyar Telekom), ushtron aktivitetin e saj në një tjetër treg përkatës produkti (tregun e telekomunikacionit), ky transaksion nuk pritej të sillte asnjë efekt në tregun shqiptar. Nga vlerësimi i konkurrencës ky përqëndrim nuk shfaqte shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese sipas parashikimeve të nenit 56/1 të Ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar. Prandaj, duke u bazuar në arsyetimin e sipërcituar, Komisioni vendosi të autorizonte përqëndrimin e realizuar

nëpërmjet krijimit të një ndërmarrje të pavarur JV nga ndërmarrjet Magyar Telekom Nyrt dhe MET Holding AG.

3.4 Përqëndrimet e ndërmarrjeve në nivel horizontal, vertikal dhe konglomerat

E drejta e BE-së është e pasur nga ana legislative në aspektin e përqëndrimeve dhe udhëzimeve mbi vlerësimin e shkrirjeve horizontale. Ekzistojnë dy menyra më anë të të cilave mund të pengohet konkurrenca efektive në kuadër të udhëzimit. (Council Regulation 2004/C 31/03) Këto mënyra kanë të bëjnë me eliminimin e kufizimeve të rëndësishme mbi dy ose më shumë firma, të cilat si rrjedhojë do të kenë rritur fuqinë e tregut, pa përdorur sjelljen e bashkërenduar mes tyre për të krijuar ose shtuar pozitën dominuese në tregun e caktuar, dhe duke e ndryshuar natyrën e konkurrencës në mënyrë që firmat që më parë nuk koordinonin sjelljen e tyre, tani kanë mundësi më shumë ta koordinojnë dhe të rrisin çmimet duke demtuar konkurrencën. (Spaho: Ditët e Studimeve Shqiptare, Universiteti Europian i Tiranës, 2016, 6-9) Pra, që të ekzistojë një shkrirje horizontale duhet të plotësohen tre kushte: 1) sa më i madh të jetë efekti i kufizimit të konkurrencës së lirë, aq më të mundshme do të jenë kursimet nga efienca; 2) ka të bëjë me veçantësinë e përqëndrimit, që nënkupton se efienca nuk mund të arrihen me alternativa jo-konkurruese; 3) verifikueshmëria është kushti i tretë që duhet të plotësohet, dhe ka të bëjë me vendimin e Komisionit, ku ky organ duhet të pranojë efienca që mund të ndodhin dhe se ato duhet të jenë mjaftueshmërisht thelbësore për të tejkaluar potencialin e përqëndrimit në dëm të konsumatorëve.

Nga ana tjetër përqëndrimet vertikale përfshijnë kombinimin e firmave që veprojnë në faza të ndryshme të një zinxhiri të vetëm të furnizimit. Në këtë praktikë problematikat që mund të lindin kanë të bëjnë me rritjen e rrezikut duke kufizuar furnizimin e inputeve ose tregun e

shpërndarjes, në mënyrë të tillë që rivalët të përballen me kosto më të lartë pas bashkimit. Një praktikë e tillë është e ndaluar nga ligji për mbrojtjen e konkurrencës efektive. (Miller, 2012: 675) Diskriminimi është në qendër të bashkimeve vertikale, ku firma mund të diskriminojë në favor të biznesit të vet, bizneset që kërkojnë të konkurrojnë me të. Megjithatë, është e vështirë për të bërë dallimin mes efikasitet dhe diskriminimit, meqenëse në fokus të kompanive të ndryshme është rritja e të ardhurave dhe nuk kujdesen për efektet që mund të ketë sjellja e tyre. Integrimi vertikal mund të rezultojë në një efikasitet të konsiderueshëm për bashkimin e palëve, ku një firmë e tillë ka të ngjarë të përdorë më pak burime në furnizim për vete, në krahasim me furnizimin e të tjerëve, në mënyrë të tillë që kostot e transaksionit nga kjo kompani të jenë minimale. Kjo rezulton në një firmë të integruar vertikalisht që është në gjendje të paguajë për vete një çmim më të ulët sesa të tjerët. (Gaughan: 2007, 124) Zgjidhja për eliminimin e këtyre praktikave për kostot e transaksionit është e vështirë të gjendet edhe në udhëzimet respektive të posaçme, sepse nuk ka informacion të saktë sesi të bëhet dallimi në mes efikasitet dhe ”*pengesave*”⁸. Këtu mund të ketë ndërhyrje nga Autoritetet e Konkurrencës në shtetet Komunitare për të dhënë diferencën qoftë edhe duke e sanksionuar sjelljet e tyre nëpërmjet rekomandimeve të autoriteteve respektive.

Ndërmarrjet konkurrencte aktuale apo potenciale që operojnë në të njejtin nivel tregu, dhe kryejnë përqëndrime, do të konsiderohen se kryejnë operacione përqëndrimi horizontale. Disa lloje të marrëveshjeve horizontale duhet të konsiderohen si të paligjshme në parim. Këto

⁸ Termi “pengesë” është përdorur në përshtatje me gjuhën shqipe sepse në gjuhën angleze është “foreclosure” që do të thotë: “humbja nga mundësia për të ushtruar një të drejtë”, ku kjo e drejtë apo kompetencë që ka të bëjë me kalimin e papajtueshëm të të drejtave për shkak të pengesave që mund të krijohen nga faktorë të jashtëm, sjell pasojë për shoqëritë që kërkojnë të ushtrojnë këto veprimtari.

përfshijnë marrëveshjet midis konkurrentëve të cilët fiksojnë çmimet, tregjet, ndajnë fitimet mes tyre dhe pakësojnë konkurrencën duke ulur efikasitetin e kësaj të drejte. Ka disa marrëveshje horizontale të cilat mund të ndikojnë konkurrencën por mund të gjenerojnë rritjen e efikasitetit, ose mund të shërbejnë për qëllime të tjera të dobishme. (Reg. i Antitrust-it dhe Tregtisë, Rep. (BNA) Nr. 1334/604, 1993) Për shembull, një marrëveshje në të cilën ndërmarrjet angazhohen në një veprimtari të përbashkët hulumtimi dhe zhvillimi, në një prodhim të përbashkët ose në një operacion për asgjësimin e mbeturinave industriale, që mund të rrisë dobishmërinë ekonomike dhe sociale. Ata duhet të trajtohen nën "sundimin e arsyes".

Në rastet kur ndërmarrjet konkurrencte përqëndrohen ndërmjet tyre, rrjedhimisht nuk do të ketë më konkurrencë sepse krijohet një entitet i ri i cili do të ketë ndikim në çmimet e tregut, duke i ndryshuar strukturën, pasi zbeh efektin konkurrues që ekzistonte përpara bashkimit të tyre nëpërmjet reduktimit të shoqërive aktuale apo potenciale. Pengimi i ndjeshëm i konkurrencës së ndershme nëpërmjet përqëndrimeve horizontale mund të realizohet në dy mënyra: a) efekteve të pakoordinuara, nga eliminimi i kufizimeve të konkurrencës mbi një ose më shumë ndërmarrje; b) efekteve të koordinuara, nëpërmjet ndryshimit të strukturës së tregut, duke rritur çmimet në mënyrë fiktive dhe në kuadër të një marrëveshjeje. Në të shumtën e rasteve, këto bashkime bëhen për të fituar pjesët e tregut, por nuk duhet ngatërruar me fuqizimin e pozitës dominuese, sepse referuar rastit të grupit Vienna Insurance, gjykata doli në përfundimin se përqëndrimi i realizuar në këtë lloj formë nuk përbënte krijim apo fuqizim të pozitës dominuese. (Vendimi i GJP-së 160/2010)

Ndërmarrjet që operojnë në nivele të ndryshme të tregut, në prodhim apo shërbime, të cilat në një moment përqëndrohen, konsiderohet se kanë kryer përqëndrime vertikale. Këto lloj

përqëndrimesh kanë një shkallë më të lartë rrezikshmërie për shkeljen e konkurrencës efektive, pasi kanë pasoja direkte në ndërmarrjet e tjera duke i nxjerrë nga tregu konkurrentët dhe duke favorizuar pozitën dominuese. Kjo e fundit është e sanksionuar si shkelje në bazë të ligjit për konkurrencën në legjislacionin shqiptar dhe në legjislacionin e BE-së.

Përqëndrimet në nivel as horizontal, as vertikal realizohen në ato raste kur ndërmarrjet janë në tregje ngushtësisht të lidhura. Zakonisht këto hasen në sektorin e furnizimit të produkteve. Këto lloj përqëndrimesh nuk kanë ndikim direkt në prishjen e konkurrencës së lirë, por në bazë të vendimeve të Autoritetit të Konkurrencës, në disa situata të caktuara mund të shfaqin nuanca abuzive.

3.5 Praktikant antikonkurruese të përqëndrimeve gjatë krizave ekonomike

Vende të ndryshme në periudha të ndryshme gjatë 20-vjeçarit të fundit kanë pasur rritje ekonomike, por kanë kaluar edhe faza të rënies së ekonomive të brendshme shtetërore. Momentalisht Europa, por jo vetëm, nuk është në kushtet e lulëzimit ekonomik. Kjo rënie e fuqisë ekonomike ka pak vite që ka filluar dhe solli probleme nga më të ndryshmet në arenën europiane. Këto probleme u pasqyruan me krizen ekonomike të Spanjës dhe më vonë me atë të Greqisë, duke çuar deri edhe në daljen e Britanisë së Madhe nga Bashkimi Europian. Këto kushte të vështira ekonomike sollën edhe abuzimet nga kompanitë e ndryshme si në bursa ashtu edhe në kufizimin e konkurrencës së lirë. Këto shkelje u paraqiten në mënyra nga më të ndryshmet, duke filluar që nga spekulimet e deri tek marrëveshjet e bashkërenduara dhe përqëndrimet abuzive për të fituar pozitën dominuese. Organet e BE-së morën masa për kontrollin e krizës me anë të teknikave kontrolluese për mbajtjen e konkurrencës në parametra optimalë.

Në një status krize, autoritetet respektive të konkurrencës duhet të rishikojnë praktikat e tyre të zakonshme për të parë nëse ato duhet të rregullohen në dritën e recesionit. (Stephan: 2012, 511-528)

Një raport i OECD arriti në përfundimin se "matja me saktësi e dëmit të shkaktuar nga kufizimi i konkurrencës është e vështirë edhe në rastin më të mirë" të bashkimeve dhe sjelljes përjashtuese me shoqëritë e tjera në treg. (OECD Policy Roundtables: 2011, 11). Kjo ka të ngjarë të jetë edhe më e vështirë gjatë një periudhe krize, kur efektet e kësaj të fundit janë shtuar për shkak të sjelljeve antikonkurruese, të cilat kanë sjellë vështirësi dhe komplikacione për të identifikuar dëmet e konkurrentëve nga sjellja e ligjshme dhe antikonkurruese në tregje të caktuara. Bashkimet/Shkrirjet dhe përftimi i kontrollit të ndërmarrjeve mund të rezultojnë në frenim të inovacionit të tregut dhe dëmi i shkaktuar nga kjo ulje e inovacionit mund të jetë shumë i vështirë për t'u vlerësuar. Kjo tezë mbështet idenë e pyetjes kërkimore që kompanitë veprojnë në interes të vetin dhe në dëm të benefitit të konsumatorit, duke pasur për qëllim ekspansionin e biznesit, që jo domosdoshmërisht ka për objektiv maksimizimin e fitimit.

Supozimet në lidhje me dëmin e mundshëm mund të jenë më të përshtatshme gjatë periudhave të vështira në kuadër të ekonomive shtetërore. Në këto raste, shtimi i dëmit të përgjithshëm në shoqëri është mjaft i ndryshëm nga shtimi i dëmit për firmat individuale. (Lichtenhahn: 2011, 305-342)

Për më tepër, dëmi i ardhur në anën cilësore (i cili është i nevojshëm për t'u analizuar në rastet e bashkimit) është edhe më i vështirë sesa përcaktimi sasior i tij, siç mund të bëhet në rastet e përfimit të kontrollit. Në çdo rast, vlerësime të mjaftueshme të Komisionit janë bërë për efektet e kufizimit të konkurrencës.

3.6 Konkluzion

Operacionet e përqëndrimeve të ndërmarrjeve në kuadër të bashkimit/shkrirjes janë pjesë integrale e trajtuar në këtë kapitull duke treguar normat e të drejtës komunitare dhe dispozitat e parashikuara në legjislacionin shqiptar. Format e operacioneve në kuadër të bashkimit/shkrirjes, si pjesë kryesore e këtij fragmenti, janë trajtuar në vështrim krahasues duke vënë theksin në mënyrat dhe funksionalitetin e aplikimit të këtyre praktikave; praktika të cilat nën vëzhgimin e Autoritetit të Konkurrencës (në Shqipëri apo BE) kanë pasur një zhvillim progresiv duke mos lejuar abuzimin nëpërmjet tyre.

Si konkluzion, bashkimet/shkrirjet e shoqërive tregtare janë një formë e riorganizimit të tyre me formimin e një shoqërie të re (shkrirje për bashkim) ose me anë të përthithjes nga njëra prej ndërmarrjeve që është pjesë e operacionit (shkrirje për krijim).

Referuar ligjit “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” kemi edhe forma të tjera riorganizimi, nëpërmjet ndarjes së tyre, apo shndërrimit të tyre, por që nuk janë objekt i shqyrtimit në punim meqënëse fokusi i punimit është në kuadër të ligjit për “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”.

Në rastet e shkrirjeve ndërmarrja e përthithëse mban identitetin ligjor, ndërsa ndërmarrja e përthithur shuhet si person juridik duke kaluar asetet në ndërmarrjen përthithëse. Në thelb, këto praktika janë kontrata për palët që marrin pjesë në përqëndrim duke krijuar të drejta dhe detyrime respektivisht për palët. Këto praktika janë trajtuar nga vendimet e fundit të Komisionit të Konkurrencës në vitin 2014.

Në këtë pjesë të disertacionit theksohet përfundimi i kontrollit, i cili mund të mos jetë nga një ndërmarrje por nga më shumë se një, ku pjesë e shoqërisë së re është secila nga ndërmarrjet që janë pjesë në transaksion, pjesë e shoqërisë së re janë edhe ndërhyrjet nëpërmjet votës nga

shoqëritë pjesëmarrëse, etj. Por ndërmarrjet mund të kenë një gamë më të gjërë bashkëpunimi duke krijuar formën e shoqërisë së përbashkët joint venture. Këto organizime të mëdha monetare në tregje të caktuara janë krijuar për të ndarë shpenzimet dhe fitimet e një projekti të caktuar. Vihet në dukje fakti se kjo formë organizimi funksionon si njësi ekonomike e pavarur dhe për ndërmarrjet e vogla ka benefite më të mëdha për të rritur fuqinë në treg dhe influencën e tyre nëpërmjet mallrave, shërbimeve apo zhvillimit të teknologjive të reja. Në këtë mënyrë shoqëritë me fuqi të vogël ekonomike kanë avantazh në kursimin e parave dhe uljen e rrezikut të dështimit nëpërmjet ndarjes së investimit.

Një trajtim i veçantë i është kushtuar rasteve kur pengohet konkurrenca efektive nëpërmjet përqëndrimeve të ndërmarrjeve në nivel horizontal, vertikal dhe konglomerat. Në praktikën e trajtuar hasen problematika të ndryshme që mund të lindin me rritjen e rrezikut, duke kufizuar furnizimin e inputeve ose tregun e shpërndarjes, në mënyrë që rivalët të përballen me kosto më të lartë pas bashkimit. Në mënyrë konkrete janë dhënë edhe ndërhyrjet e Autoritetit si organi kompetent në monitorimin e veprimtarisë së këtyre shoqërive. Përqëndrimet në nivel as horizontal, as vertikal, pra konglomerat, realizohen në ato raste kur ndërmarrjet janë në tregje ngushtësisht të lidhura me njëri - tjetrin dhe në disa raste shfaqen në mënyrë abuzive duke sjellë për rrjedhojë nevojën e ndërhyrjes së Autoritetit të Konkurrencës në kontrollin e përqëndrimit në të cilin janë palë disa persona juridikë që kanë statusin e shoqërive tregtare.

Praktikat antikonkurruese gjatë recesionit ekonomik janë po ashtu pjesë e këtij kapitulli duke vënë fokusin tek efektet negative që mund të sjellin përqëndrimet e ndërmarrjeve të cilat kanë një fuqi të konsiderueshme në tregun ku operojnë. Në këtë aspekt bëhet edhe një rivlerësim i përdorimit të këtyre praktikave gjatë një faze recesioni, ku dëmi që mund të shkaktohet në

shoqëri është i ndryshëm nga dëmi që mund të shkaktohet ndaj personave juridike që ushtrojnë veprimtari tregtare.

KAPITULLI IV – OPERACIONET E PËRQËNDRIMEVE

NË KUADËR TË PËRFTIMIT TË KONTROLLIT (ACQUISITIONS)

4.1 Kuptimi i kontrollit të përqëndrimeve

*Kontrolli*⁹ i përqëndrimit të ndërmarrjeve është shumë i domosdoshëm për të evituar praktikën abuzuese në kontekstin e bashkimeve të shoqërive. Kontrolli i përqëndrimeve përbën Kreun III të ligjit “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, konkretisht në nenet 10-17. Referuar legjislacionit kemi përqëndrim: a) për efekt të bashkimit të dy ose më shumë ndërmarrjeve ose pjesëve ndërmarrjesh të pavarura nga njëra – tjetra; b) kur përftohet kontroll i drejtpërdrejtë ose i tërthortë, nga një ose më shumë persona fizikë, të cilët njëkohësisht kanë kontrollin e të paktën një ndërmarrjeje tjetër ose nga një ose më shumë ndërmarrjeve, ose një pjesëve të këtyre të fundit, përmes blerjes së aksioneve, kuotave apo asetëve, kontratës ose çdo mjeti tjetër të ligjshëm; c) nëpërmjet kontrollit të drejtpërdrejtë ose të tërthortë mbi një ose më shumë ndërmarrje ose të një pjese të këtyre të fundit. (Neni 10, Ligji 9121/2003)

Objekt i kontrollit mund të jenë një ose më shumë ndërmarrje, pjesë të caktuara të ndërmarrjeve që përbëjnë në vetvete njësi ligjore dhe mbi asetet e këtyre ndërmarrjeve.

Me anë të kontrollit të përqëndrimeve është bërë një zhvillim progresiv i kësaj të drejte duke zbuluar praktikën abuzuese që lidhen jo vetëm me bashkimet e ndërmarrjeve por edhe me transaksionet e shitblerjeve të aksioneve. (Raporti vjetor i Autoritetit të Konkurrencës: 2008-2009, 8)

⁹ Termi “kontroll” i përdorur sipas kuadrit ligjor mbi përqëndrimet në të drejtën e konkurrencës është i ndryshëm nga përcaktimi i këtij termi në fusha të tjera të së drejtës.

Zotërimi i të drejtave pronësore i aksionarëve ndërmjet tyre më anë të marreveshjeve të fshehta është një moment ku Autoriteti i Konkurrencës mund të bjerë në gjurmë të përqëndrimeve abuzive. Ekzistojnë edhe mënyra të tjera përqëndrimi siç janë marrëdhëniet e varësisë ekonomike. Varësia ekonomike mund të arrihet nëpërmjet kontratave apo të drejtave të caktuara ose nëpërmjet të drejtave të pronësisë. Të gjitha përqëndrimet e ndërmarrjeve i nënshtrohen kontrollit *ex ante* të Autoritetit të Konkurrencës.

Rasti i fundit i trajtuar nga Komisioni i Konkurrencës për përqëndrimin nëpërmjet të drejtave të pronësisë është në vitin 2016. Ky rast ka të bëjë me shqyrtimin e raportit mbi njoftimin e përqëndrimit të ‘Novamatic Gaming Industries GmbH (Gesellschaft mit beschränkter Haftung) (NGI) / Österreichische Holding Gesellschaft mbH (ÖHG)/ Albanisch Österreichische Holding Gesellschaft mbH / Lotaria Kombëtare shpk (LK). Në lidhje me transaksionin e përqëndrimit, Komisioni vërejti se përqëndrimi realizohej me anë të “Kontratës së Blerjes dhe Transferimit të Kuotave” e nënshkruar midis palëve Novamatic Gaming Industries GmbH (Blerësi) dhe Österreichische Holding Gesellschaft mbH (Shitësi), me objekt transferimin e 100% të kapitalit të shoqërisë Albanisch Österreichische Holding Gesellschaft mbH (“Target”), më datë 3 Maj 2016. Objekti i transaksionit ishte përftimi i kontrollit indirekt nga shoqëria Novamatic AG me anë të transferimit të të gjithë kapitalit të shoqërisë Albanisch Österreichische Holding Gesellschaft mbH, dhe për rrjedhojë edhe të shoqërisë Lotaria Kombëtare shpk. Me anë të kësaj kontrate shitësi i shiste blerësit sipas dispozitave të tij, kuotat objekt të kontratës me të gjitha të drejtat dhe detyrimet. Ky transaksion, i cili shkakton përftimin dhe ndryshimin e qëndrueshëm të kontrollit të shoqërisë Albanisch Österreichische Holding Gesellschaft mbH dhe në mënyrë indirekte të shoqërisë Lotaria Kombëtare shpk në formën e ndryshimit të ortakut kontrollues nga Shitësi tek

shoqëria Novomatic Gaming Industries GmbH, në bazë të nenit 10, pika 1) shkronja b) i Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” i ndryshuar, përbënte një përqëndrim. Palët në transaksion plotësonin kriteret e xhiros së përcaktuar në nenin 12, pika 1, germa b) të ligjit. (Komisioni i Konkurrencës, Vendimi 427/2016)

Tregu përkatës i produktit: Referuar Udhëzuesit “Për përcaktimin e tregut përkatës”, si dhe sa më sipër, treg përkatës në analizën e këtij përqëndrimi u konsiderua tregu i lojërave të lotarisë. Tregu përkatës gjeografik: Për analizimin e këtij rasti treg përkatës gjeografik do të konsiderohej territori i Republikës së Shqipërisë.

Novomatic Gaming Industries nuk ishte prezent në tregun përkatës të produktit në Shqipëri, prandaj ky përqëndrim nuk sillte shqetësime për konkurrencën në vendin tonë. Shoqëria Novomatic Gaming Industries ishte prezente në Shqipëri me anë të filialit të saj Eagle Investment sha, një shoqëri holding, e cila ka në pronësi të saj: (i) Astra Albania sha; (ii) Adriatik Game sha; (iii) Albatën shpk, Astra Albania sha dhe Adriatik Game sha, të cilat janë aktive në një treg tjetër produkti, atë të lojërave të fatit me anë të kazinove elektronike, prandaj nuk kishte mbivendosje të veprimtarive të palëve në tregjet përkatëse. Pas realizimit të përqëndrimit nuk do të kishte ndryshime të pjesëve të tregut të shoqërive që operojnë në tregjet përkatëse. Gjithashtu, sipas ligjit të ri për lojërat e fatit në Shqipëri, nr. 155/2015, çdo aktivitet i licencuar i kazinosë elektronike nuk do të jetë më i lejuar pas 31 dhjetorit 2016. Për këtë arsye, të gjitha veprimtaritë e Novomatic Group që kishin lidhje me kazinotë elektronike në Shqipëri do të përfundonin në 31.12.2016. Pas përfundimit indirekt të kontrollit të Lotarisë Kombëtare nga ana e Novomatic Gaming Industries (NGI) pritej të sjellë teknologjitë më të fundit të lojërave të lotarive për të rritur cilësinë e shërbimeve të LK, si dhe do të rrisë atraktivitetin e produkteve të ofruara për pjesëmarrësit në lojërat e lotarive në

Shqipëri. Në ndryshimin e përfutjesit të kontrollit në kontratën koncesionare për lotarinë kombëtare duhet të mbahen parasysh performanca e operatorit dhe kushtet dhe detyrimet që përmban kjo kontratë sipas parashikimeve të Ligjit 95/2013 “Për Miratimin e Marrëveshjes së Licencës për Lotarinë Kombëtare ndërmjet Ministrisë së Financave, si autoritet i autorizuar, dhe shoqërisë Österreichische Lotterien GmbH nëpërmjet shoqërisë “ÖLG Project” shpk”.

Sipas KK përqëndrimi nuk shfaqte shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese, prandaj u vendos që të autorizohet përqëndrimi i realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit nga shoqëria Novamatic Gaming Industries GmbH të 100% të kapitalit të shoqërisë Albanisch Österreichische Holding Gesellschaft mbH.

4.2 Kontrolli nga një person i vetëm dhe kontrolli i përbashkët

Kontrolli në një treg të caktuar mund të ushtrohet nga një *person*¹⁰ që drejton një ndërmarrje të caktuar duke bashkuar veprimtarinë me disa persona që kontrollojnë një ndërmarrje tjetër. Në këto raste një person i vetëm që është aksionari ka fuqinë për të përcaktuar vendimet strategjike të një ndërmarrje. Në disa raste kontrolli paraqitet edhe nga ndërmarrjet që kanë një pozitë dominuese. Kontrolli i përfutur nga një ndërmarrje mund të jetë momenti kur shoqëria tregtare bën të mundur zotërimin e shumicës së aksioneve me të drejtë vote duke i blerë ato.¹¹ Varësia e zotërimit të aksioneve/kuotave ka nxjerrë nevojën për kontrollin faktik.

¹⁰ Ashtu si personat fizikë dhe juridikë, termi “person” në këtë kontekst parashikohet tek organet publike dhe njësitë private.

¹¹ Këtu aplikohet kontrolli ligjor.

Këtë po e ilustruam me një shembull nga praktika e Autoritetit ku një sipërmarrës nëpërmjet shoqërisë që zotëron kërkon përfitim kontrolli mbi një shoqëri tjetër.

Komisioni i Konkurrencës për kontrollin e përqendrimeve ka shqyrtuar çështjen për përfitim e kontrollit nga shoqëria Eurosig sha të shoqërisë Insig sha. Në kuadër të transaksionit Komisioni i Konkurrencës vërejti se përqëndrimi u realizua me anë të “Kontratës për shitblerjen e aksioneve, të shoqërisë aksionare Insig sha” e nënshkruar midis palëve Eurosig sha (Blerësi) dhe Drejtoria e Drejtimit të Pronës Publike (Shitësi), me objekt përfitim e kontrollit të plotë me 100% të kapitalit të shoqërisë Insig sha (Target) nga Eurosig sha, datë 1 Qershor 2016. Objekti i transaksionit ishte transferimi nga Shitësi tek Blerësi i 1700 aksioneve të shoqërisë Insig sha dhe çdo e drejtë që u përket aksioneve, të lira nga çdo barrë. Në datën e mbylljes, Blerësi do të ishte pronari i 100% të aksioneve të Insig sha me vlerë minimale 600.000 lekë për aksion, të lira dhe të pastra nga të gjitha pretendimet dhe barrat e çdo lloji. Ky transaksion i cili shkaktonte ndryshimin e qëndrueshëm të kontrollit të shoqërisë Insig sha në formën e privatizimit të ndërmarrjes shtetërore nga shoqëria Eurosig sha, në bazë të nenit 10, pika 1) shkronja b) i Ligjit Nr. 9121 , datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” i ndryshuar, përbënte një përqëndrim. Palët në transaksion plotësonin kriteret e xhiros së përcaktuar në nenin 12, pika 1, gërma b) të Ligjit. (Komisioni i Konkurrencës, Vendimi 426/2016)

Komisioni i Konkurrencës u shpreh se përvoja i përket tregut përkatës të produktit, referuar udhëzuesit “Për Përcaktimin e Tregut Përkatës”, si dhe mbështetur në veprimtarinë e palëve, treg përkatës do të konsiderohej tregu i sigurimit të jetës. Ndërsa për analizimin e tregut përkatës gjeografik do të konsiderohej i tillë tregu i brendshëm, pra, territori i Republikës së Shqipërisë. Në lidhje me efektet në treg pas përqëndrimit, transaksioni i njoftuar përbënte një

përftim të drejtpërdrejtë kontrolli në masën 100% të shoqërisë Insig sha nga shoqëria Eurosig sha. Të dy shoqëritë do të vazhdonin aktivitetin e tyre si njësi ekonomike të pavarura me emër tregtar respektivisht Insig sha dhe Eurosig sha dhe nuk parashikohej një bashkim mes tyre në periudha afatshkurtra. Transaksioni i ndryshimit të kontrollit mbi shoqërinë Insig, nuk sillte mbivendosje horizontale të veprimtarisë ekonomike të palëve në transaksion sa i përket sigurimit të jetes, pasi shoqëria Eurosig sha nuk ishte prezente në këtë segment produkti. Si pasojë, struktura dhe niveli i përqëndrimit në këtë segment nuk ndryshonte. Ky transaksion nuk sillte asnjë efekt për këtë lloj produkti. Në segmentin e sigurimit të jo – jetës ishin aktive të dy shoqëritë, pjesë e këtij transaksioni. Ky transaksion shkaktonte mbivendosje horizontale të veprimtarisë së palëve apo tregjeve të prekura. Pjesa e tregut të kombinuar për të dy shoqëritë do të rezultonte 21.05%, gjithsesi para dhe pas transaksionit asnjëra nga ndërmarrjet objekt i përqëndrimit të analizuar, Eurosig sha dhe Insig sha nuk zotëronin pozitë dominuese në tregun përkatës. Pavarësisht rritjes së nivelit të përqëndrimit të tregut, ky transaksion nuk e vendoste ndërmarrjen e përqëndruar në një pozicion të tillë, i cili i jepte mundësi asaj të vështirësonte zgjerimin apo të kufizonte aftësinë e aktorëve të tjerë në treg për të konkurruar. Kjo nisur dhe nga fakti i prezencës në treg të konkurrentëve si Sigal Uniqa Group Austria dhe Sigma Inter Albanian Vienna Insurance Group, respektivisht pjesë e grupeve Uniq Group dhe Vienna Insurance Group, grupe lider sa i përket sigurimeve në Austri dhe Europën Qëndrore dhe Lindore, me një prezencë afatgjatë dhe fuqi ekonomike të konsoliduar në tregjet ndërkombëtare.

Kontrolli u përftua kur këto dy entitete duke ju caktuar të drejta apo si mbartës të tyre i fituan ato në kuadër të një *marrëdhënieje juridike detyrimi*¹². Në praktikë ka shumë situata kontrolli indirekte dhe për rrjedhojë edhe në mënyrë abuzive. Raste të tilla paraqiten kur mbajtësi formal i interesave kontrolluese është i ndryshëm nga personi ose ndërmarrja që ka realisht dhe në mënyrë faktike fuqinë për të ushtruar të drejtat që burojnë nga interesi kontrollues, ku kontrolluesi *de jure* është një “mjet” faktikisht, duke fshehur kontrolluesin *de facto*. Ndërmarrja që është mbrapa transaksioneve ka fuqinë reale kontrolluese, fuqi kjo që arrihet nëpërmjet lidhjeve kontraktuale, mbajtësve të aksioneve, lidhjeve familjare, burimeve të financimit, etj.

Kontrolli i përbashkët është në rastet kur dy ose më shumë persona ose dy ose më shumë ndërmarrje ushtrojnë pushtetin vendim-marrës në një shoqëri tjetër tregtare. (Dabbah: 2004, 452) Ky kontroll karakterizohet nga politikat monetare dhe *ndikimet vendimtare*¹³ që ushtrojnë aksionarët ose një grup ndërmarrjesh. Një shembull konkret i kontrollit të përbashkët është rasti i fundit i shqyrtuar nga Komisioni në vitin 2014, ku në lidhje me transaksionin respektiv përqëndrimi realizohej në bazë të “Marrëveshjes për shitjen e kapitalit” e lidhur me datë 9 Janar 2014, ndërmjet palëve “Jiangxi Copper Company Limited, Beijing Metal Challenge Global Trading Co.LTD dhe CRM International (Bjing) Co.LTD” në cilësinë e blerësve dhe “Ekin Maden Ticaret Ve Sanayi AS” në cilësinë e shitësit me objekt transferimin e 50% të aksioneve të “Nesko Metal Sanayi Ve Ticaret AS” në cilësinë e shoqërisë Target, me pasojë përfundimin e kontrollit të përbashkët indirekt të shoqërisë Beralb

¹² Marrëdhënia juridike e detyrimit mund të ketë përmbajtje ekonomike ose joekonomike. Përcaktimi i përmbajtjes bëhet nga qëllimi për të cilin është krijuar marrëdhënia duke vënë theksin tek interesat e palëve në kontratë.

¹³ Ndikimet vendimtare nënkuptojnë fuqinë për të përcaktuar veprimtarinë strategjike të një shoqërie tregtare.

sha nëpërmjet transferimit të 50% të aksioneve të shoqërisë Nesko Metal Sanayi Ve Ticaret AS, nga shoqëria Ekin Maden Ticaret ve Sanayi AS tek shoqëritë Jiangxi Copper Company Limited, Beijing Metal Challenge Global Trading Co. LTD dhe CRM International (Bjing) Co. LTD.

Shoqëria shitëse Ekin Maden shitën XXX aksione (me vlerë nominale XXX) që përfaqësonin pjesën prej 50% të kapitalit e përkatësisht 48% të shoqërisë JCCL, dhe nga 1% Beijing Metal e CRM International. Pas realizimit këtij përqëndrimi shoqëritë blerëse bëheshin aksionere me të drejta të plota në shoqërinë turke Nesko Metal dhe për pasojë përftonin kontrollin e përbashkët indirekt edhe në shoqërinë Beralb sha.

Transaksioni i cili ndryshoi cilësinë e kontrollit në ndërmarrjen target (Beralb sha) në formën e përfutimit të kontrollit të përbashkët indirekt në bazë të nenit 10 pika 1), shkronja b) dhe 12 të Ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, përbënte një përqëndrim që plotësonte kriteret e xhiros dhe duhej të autorizohet nga Komisioni i Konkurrencës në bazë të nenit 56 të Ligjit. (Komisioni i Konkurrencës, Vendimi 309/2014) Përsa i përkiste xhiros së vitit para-ardhës, plotësohej kriteri i xhiros në tregun ndërkombëtar dhe në tregun e brendshëm sipas parashikimeve të nenit 12 të ligjit për të marrë autorizimin e Komisionit të Konkurrencës.

Në lidhje me tregun përkatës Jiangxi Copper Company Limited (JCCL) ishte një prodhues dhe fabrikues i bakrit në Kinë, si dhe furnizues bazë për arin, argjendin, seleniumin, telluriumin, rheniumin si dhe kimikate sulfurore. Sektori ku JCCL ushtronte aktivitetin ishte industria e bakrit në Kinë. JCCL nuk zhvillonte ndonjë aktivitet në tregun shqiptar dhe as në atë turk. Kurse tregu përkatës i produktit duke u bazuar në karakteristikat fizike të metaleve, përdorimin apo mënyrat e ndryshme të përpunimit apo rafinimit të tyre si dhe diferencat në

çmime mund të thuhet se secili prej tyre përbënte një treg të veçantë produkti. Referuar rastit në fjalë, dhe duke u mbështetur në veprimtarinë e palëve në vendin tonë, treg përkatës produkti do konsiderohej: nxjerrja/pasurimi i mineralit të bakrit dhe prodhimi i koncentratit të tij si dhe tregtimi (eksporti) i bakrit dhe nënprodukteve të tij. Në tregun përkatës gjeografik shoqëritë kishin një pozicion, ku Beralb sha e kryente aktivitetin e nxjerrjes dhe përpunimit të bakrit (në formën e koncentratit) në miniera apo fabrika të cilat ishin të shpërndara në territorin e Republikës së Shqipërisë, megjithëse produktin e prodhuar e eksportonte. Beralb sha nuk ushtronte aktivitet në tregun e prodhimit të produkteve finale të bakrit (si tela, monedha etj.) për arsye të investimeve të kërkuara dhe të rezervave të kufizuara. Për analizimin e këtij rasti, Komisioni si treg përkatës gjeografik do të konsideronte tregun e brendshëm, pra territorin i Republikës së Shqipërisë.

Analiza e konkurrencës nga Komisioni u bë e tillë duke dalë në përfundimin se, në Shqipëri janë vlerësuar rreth 71 milion tonë rezerva gjeologjike për mineralin e bakrit sipas tipit të mineralizimeve dhe rajoneve. Beralb sha momentalisht kishte në shfrytëzim objekte minerare në të cilat vlerësoheshin në një sasi rezervash rreth XXX milion ton. Prodhimi aktual në këtë industri ishte në nivelet e 30-35% të prodhimit të realizuar para viteve 1990, pra në këtë sektor kishte shumë mundësi për të rritur vlerat e prodhimit dhe të ardhurave prej tij. Pas viteve 2000, shoqëria Beralb sha ishte e vetmja shoqëri që prodhonte, kryente veprimtarinë e shfrytëzimit dhe eksportonte bakër (në formën e koncentratit të tij) nga burimet e veta minerare duke zotëruar në këtë mënyrë pozitë dominuese në tregun përkatës sipas parashikimeve të nenit 8 të ligjit dhe prezumimit të dominancës për pjesë tregu mbi 50%.

Ndërkohë nga Shqipëria përveç ekstraktit të bakrit eksportonte edhe koncentrat pirit bakri, mbeturina bakri, skrap tunxhi, mbeturina tunxhi, skrap bakri, skrap bronxi, mbetje bakri,

mbetje tel bakri, tub bakri, tel tunxhi, skrap tunxhi. Në totalin e eksportit, bazuar në të dhënat e mundësuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, për eksportin e bakrit dhe nënprodukteve të tij, për vitin 2012 dhe vitin 2013, vihet re se shoqëria Beralb sha zinte mbi X% të sasisë së bakrit dhe nënprodukteve të tij të eksportuara nga Shqipëria – përkatësisht X% në vitin 2012 dhe X% në vitin 2013. Pjesa e tregut dhe dominanca e shoqërisë Beralb sha do të ishte e njëjta edhe pas transaksionit pasi asnjë nga shoqëritë që ishin palë blerëse në këtë transaksion, nuk ishin prezente në Shqipëri. Si pasojë, transaksioni nuk sillte ndryshime në strukturën e tregut pas përqëndrimit. Për më tepër, ky transaksion nuk sillte asnjë ndryshim jo vetëm në nivel horizontal, por edhe sa i takon marrëdhëniet në nivel vertikal. Kjo e fundit ndodh për dy arsye: a) asnjë nga shoqëritë kineze, pjesë të transaksionit, nuk ishin prezente në tregun e brendshëm sa i takon rafinimit / prodhimit të produkteve finale të bakrit në vendin tonë; b) industria e bakrit në Shqipëri ishte e përqëndruar vetëm në nxjerrjen dhe pasurimin e mineralit të bakrit (kalimin në koncentrat).

Referuar palës njoftuese, me anë të këtij përqëndrimi synohej të rritej siguria dhe garancia për fluksin e nevojshëm të investimeve të nevojshme për rritjen në sektorin minerar të bakrit. Vetë shoqëria Beralb sha, me qëllim mbajtjen në punë të investimit të saj më të rëndësishëm - fabrikës së pasurimit të bakrit në Fushë Arrëz -, synonte të aktivizonte edhe disa miniera të tjera ekzistuese, për të cilat ishte pajisur me leje minerare.

Kështu, Komisioni vlerësoi se transaksioni ishte një blerje e pjesshme e shoqërisë Nesko si rezultat i së cilës 48% e aksioneve do të shiteshin tek shoqëria kineze Jiangxi Copper Company Limited (JCCL), dhe 2% të aksioneve do të shiteshin CRM International (Beijing) Co. Ltd dhe Beijing Metal Challenge Global Trading Co. Ltd, respektivisht nga 1% secilës. Aksioneri ekzistues i Neskos, Ekin Maden Ticaret Sanayi AS do të mbetej aksionar me 50%

tek Nesko dhe aksioneri i Beralb sha do të vazhdonte të ishte Nesko. Meqënëse JCCL ishte një ndër prodhuesit lider të bakrit në botë, pjesëmarrja e tyre tek Nesko dhe indirekt tek Beralb do të zgjeronte prodhimin e bakrit dhe koncentratit të tij në Shqipëri, çka do të kishte një impakt pozitiv të përgjithshëm. Transaksioni fuste në industrinë e bakrit në Shqipëri një nga shoqëritë më të mëdha në tregun global në sektorin minerar, nëpërmjet të cilit pritej të realizoheshin investime të reja në minierat ekzistuese dhe në zonat potenciale minerare.

Sa më sipër, transaksioni, nuk solli asnjë ndryshim në strukturën dhe pjesët e tregut përkatës në kuptim të forcimit të pozitës dominuese dhe për këtë arsye duhej të autorizohesh sipas parashikimeve të nenit 56 të Ligjit nga KK-ja. Si konkluzion, përqëndrimi i realizuar nuk shfaqte shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit apo forcimit të pozitës dominuese.

Një tjetër rast që gjykoj se është i rëndësishëm ka të bëjë me shoqëritë e transportit ajror që kërkonin të kryenin operacion përqëndrimi nëpërmjet përfutimit të kontrollit. Vetëm njëra prej shoqërive tregtare ushtronte veprimtari në Shqipëri ndërsa tjetra ushtronte veprimtari në Greqi.

Në Janar të vitit 2011, Komisioni European (KE) – bazuar mbi Rregullin e BE-së “Për Përqëndrimet” – ndaloi shkrirjen e propozuar të kompanive ajrore Aegean Airlines dhe Olympic Air, pasi shkrirja këtyre kompanive do të kishte krijuar një situatë thuajse monopolistike në transportin ajror grek. Rezultati i kësaj manovre do të kishte ngritur çmimet për katër nga gjashtë milion konsumatorët grekë dhe europianë që udhëtonin në drejtimet për, dhe nga Athina. Të marra sëbashku, kompanitë kontrollonin më shumë se 90% të transportit ajror grek vendas dhe hetimi i KE-së shfaqte se nuk kishte ndonjë perspektivë reale që të parashikonte hyrjen e një kompanie ajrore aq të madhe sa të kufizonte kontrollin

mbi çmimin nga kompania e shkrirë. Kompanitë nga ana tyre ofruan të heqin dorë nga vendet e ngritjes dhe aterrimit tek aeroportet greke, por aeroportet greke nuk vuanin nga trafiku i madh ajror siç ishte rasti i aeroporteve të tjera europiane.

Asokohe, Zëvendës Presidenti i KE-së Joaquín Almunia shprehej: "Shkrirja ndërmjet Aegean dhe Olympic do të kishte çuar drejt një situatë pothuajse monopolistike në Greqi dhe kjo do të kishte sjellë çmime më të larta dhe kualitet më të ulët të shërbimeve për grekët dhe turistët që të udhëtonin ndërmjet Athinës dhe ishujve. Detyra e KE-së është të parandalojë krijimin e monopoleve nëpërmjet ushtrimit të fuqive të akorduara nga shtetet anëtare. Ne bëmë më të mirën për të gjetur një zgjidhje, por fatkeqësisht përmirësimet e propozuara nga ana e kompanive nuk do të kishin mbrojtur në mënyrë të përshtatshme interesat e katër milion udhëtarëve që shkojnë në ato drejtime." (Commission: M.5830, 2011)

Kompanitë kishin njoftuar KE-në në përputhje me Rregulloren e BE-së "Për Përqëndrimet" para se të ndërmerinin hapa të mëtejshëm.

Të dyja kompanitë fluturonin në drejtimet e mbuluara nga Drejtoria e Shërbimit Publik, ku Aegean mbulonte katër nga to ndërsa Olympic Air trembëdhjetë. Në përputhje me procedurat e mëparshme, KE analizoi efektet e kombinimit të firmave mbi drejtimet publike që mbulonin kompanitë përkatësisht. Gjithashtu, KE mori një sërë ankesash nga një numër i madh pjesëmarrësish të tregut grek dhe ndërkombëtar, që përfshinin shoqata konsumatorësh, autoritete publike, agjensi turistike, operatorë aeroportesh, operatorë tragetesh dhe linja të tjera ajrore.

Pas shqyrtimit të rastit, KE arriti në përfundimin se shkrirja do të kishte sjellë një situatë thuajse monopolistike në nëntë drejtime, përkatësisht drejtimet Athinë-Selanik, Athinë-Herakleion, Athinë-Chania, Athinë-Kretë, Athinë-Rodos, Athinë-Santorini, Athinë-Mytilini,

Athinë-Chios, Athinë-Kos dhe Athinë-Samos. Asnjëri nga këto drejtime nuk ishte i mbuluar nga Drejtoria e Shërbimit Publik. (Marrë nga: http://europa.eu/rapid/press-release_IP-13-927_en.htm)

Gjithashtu, hetimi i KE-së pasqyroj se shërbimet e trageteve përgjithësisht nuk ishin të mjaftueshme për të zëvendësuar transportin ajror, e rrjedhimisht kanë një ndikim të ulët mbi çmimet e fluturimeve. Frekuencat e udhëtimeve me traget ishin më të ulëta ndërsa kohëzgjatja e udhëtimeve më e lartë. Sa i përket rastit konkret, i vetmi drejtim që mund të zëvendësonte transportin ajror ishte linja me traget Athinë-Mykonos e cila u konsiderua nga KE-ja, që do të shmangte situatën monopolistike.

Hetimi i KE-së shqyrtoi edhe mundësinë e hyrjes së linjave tjera ajrore në treg dhe arriti në përfundimin se nuk kishte linja të tjera që mund të pritej të hynin në treg për të konkurruar kompaninë hipotetikusht të shkrirë në drejtimet e përmendura. Aktualisht, linjat ajrore Aegean dhe Olympic konkurrojnë për këto itinerare dhe pritet të vazhdojnë edhe në të ardhmen në qoftë se nuk shkrihen.

Duke ndjekur Rregulloren, KE i ofroi mundësinë kompanive të jepnin përmirësimet dhe angazhimet e tyre në mënyrë që të mund të vazhdohej me transaksionin. Në këtë kuadër, kompanitë u zotuan se do të lironin vendet e tyre në aeroportin e Athinës dhe se do të rrisnin lejimin e frekuentimit në programet e tyre të aviatorëve dhe marrëveshjeve ndër-ajrore. Gjithsesi, natyra dhe qëllimi i këtyre përmirësimeve ishte i pamjaftueshëm për të garantuar se konsumatorët nuk do të dëmtoheshin nga përqëndrimi. Kjo vinte për faktin se problemi kryesor në këtë çështje nuk ishte mungesa e vendeve në aeroport, siç ishte rasti i shumë aeroporteve të tjera europiane, pasi ata ishin të mjaftueshme për të mos krijuar trafik të madh. Analiza e tregut tregoi gjithashtu se përmirësimet e ofruara ishin të pamjaftueshme për të

joshur një aktor tjetër që do të kishte bazën në Athinë dhe që do të konkurronte kompaninë e shkrirë në çmim.

Në këto kushte, KE nuk kishte alternativë tjetër veç shpalljes se, përqëndrimi do të dëmtonte në mënyrë domethënëse konkurrencën ose një pjesë substanciale të saj. Si rrjedhojë, KE vendosi të ndalonte zhvillimin e transaksionit, i cili do të kishte pasur një impakt negativ mbi konsumatorët grekë për shkak të zvogëlimit të konkurrencës në treg.

Këtu vlen të theksohet fakti se, gjatë viteve 2004 - 2011, KE shqyrtoi njëmbëdhjetë raste bashkimesh dhe ky është rasti i dytë ku procedimi me transaksione u mohua. Rasti paraprak ka ndodhur në vitin 2007, ku Ryanair kishte qëllim të blinte Aer Lingus – të dyja këto firma irlandeze – por KE e kishte mohuar transaksionin me një arsyetim të ngjashëm duke qenë se rastet kanë mjaft ngjashmëri. Gjykata e Përgjithshme e riafirmoi vendimin e KE-së për rastin irlandez në gjykimin e saj të Korrikut të 2010-s.

Të njëjtat shoqëri bëjnë kërkesë për përqëndrim në Autoritetin Shqiptar të Konkurrencës, ku më poshtë po trajtoj vendimin e AK-së.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të raportit mbi njoftimin e përqëndrimit të Aegean Airlines me Olympic Air në lidhje me transaksionin vërejtë se përqëndrimi u realizua nëpërmjet “Marrëveshjes paraprake për blerjen e aksioneve” e nënshkruar më datë 22 Tetor 2012, ndërmjet Aegean Airlines S.A në statusin e blerësit dhe aksionerit të vetëm, dhe Marfin Investment Group në cilësinë e shitësit. Ndërmarrja target Olympic Air S.A do të zotërohej 100% nga Aegean Airlines S.A, dhe do të ishte degë e kësaj të fundit. Marfin Investment Group do të zotëronte Olympic Air S.A 100% të aksioneve dhe nuk do të mbante më asnjë aksion. Përqëndrimi kishte për qëllim të sillte përfitim të kontrollit të vetëm të drejtpërdrejtë nga Aegean Airlines S.A tek Olympic Air S.A në bazë të nenit 10 pika (1) shkronja (b) të

ligjit. Ky operacion kërkonte të sillte ndryshimin e kontrollit mbi ndërmarrjen target Olympic Air S.A dhe për pasojë përbënte një përqëndrim i cili duhej shqyrtuar nga Komisioni i Konkurrencës. Xhiroja totale kalonte minimumin e kërkuar nga dispozitat e ligjit të mbrojtjes së konkurrencës, kështu që në lidhje me tregun përkatës të produktit, shoqëritë Aegean Airlines S.A dhe Olympic Air S.A ishin aktive kryesisht në këto fusha: a) shërbim transporti ajror për pasagjerë, b) shërbim transporti ajror të postës dhe mallrave; c) shërbime të mbështetjes teknike dhe mirëmbajtjes së avionëve ne tokë, etj. Shoqëria Aegean Airlines S.A nuk ishte prezente në Shqipëri. Shoqëria Olympic Air S.A ishte prezente në Shqipëri nëpërmjet degës së saj Olympic Air Albania Branch e cila ushtronte veprimtarinë e saj në shërbimin e transportit ajror të pasagjerëve dhe transportit kargo (postë dhe mallra) në linjën Tiranë - Athinë. Si treg përkatës i produktit në Shqipëri u konsiderua shërbimi i transportit ajror të pasagjerëve dhe kargo në linjën Tiranë - Athinë. Përsa i përkiste tregut gjeografik, për vlerësimin e këtij transaksioni dhe efektet që do të sillte në treg, tregu përkatës gjeografik do të konsiderohej tregu i brendshëm i Republikës së Shqipërisë. (Vendimi i KK-së 267/2013)

Transaksioni i realizuar nëpërmjet transferimit të 70% të aksioneve të përqëndrimit të njoftuar solli një ndryshim kontrolli sipas parashikimeve të nenit 10, pika (1), gërma (b) të ligjit nr. 9121 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar dhe nuk pritej të sillte ndryshime në strukturën e tregut përkatës pasi palët pjesëmarrëse vepronin në tregje gjeografike të ndryshme. Si konkluzion, përqëndrimi i realizuar nuk shfaqte shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese dhe për këto arsye u propozua t’i kërkohej Komisionit autorizimi i këtij përqëndrimi në përputhje me nenin 56/1 të Ligjit nr 9121, datë 28.7.2003 “Për Mbrojtjen e

Konkurrencës”, i ndryshuar. Në bazë të analizës të sipërcituar, Komisioni vendosi që të autorizonte vendimin.

Problematika që shfaqet në këto dy raste ka të bëjë me aspektin e përcaktimeve ligjore në kuadër të subjekteve që janë pjesë e shqyrtimit të Autoritetit. Duke iu referuar vendimit, theksohet fakti se ndërmarrjet që kërkojnë të përqëndrohen nuk janë të regjistruara në Shqipëri sepse si palë në transaksion paraqiten me adresa në shtetin grek.

4.3 Mënyra e kontrollit nëpërmjet ekskluzivitetit dhe hapësirat ligjore për ushtrimin e kësaj veprimtarie

Legjislacioni në fuqi parashikon rregulla specifike për ushtrimin e veprimtarisë nga shoqëritë tregtare. Specifikisht, kuadri ligjor parashikon strukturën e organeve vendim-marrëse brenda kompanive. Këto parashikime ligjore pavarësisht se janë forcërisht të zbatueshme nuk e zbehin pozitën dominuese të aksionarëve, meqënëse janë ortakët aksionarë që vendosin përbërjen e organeve vendim-marrëse. Dispozitat që parashikojnë emërimin e anëtarëve të pavarur që përjashtojnë emërimin e personave që zhvillojnë funksione për shoqërinë mëmë ose që janë nëpunës nuk e përjashtojnë ekzistencën e kontrollit për arsye të sipërcituara.

Marrëveshjet e pastra financiare, të tilla si transaksionet e shitjes së një objekti ku më pas e jep me qira për të ri-blerë asetet në fund të afatit, normalisht nuk përbëjnë një përqëndrim duke qenë se ato ndryshojnë kontrollin mbi menaxhimin dhe burimet. Rasti konkret i këtyre

marrëveshjeve janë kontratat *franchaising*¹⁴, ku marrësi i ekskluzivitetit shfrytëzon burimet e ndërmarrjes për llogari të tij.

4.4 Kontrolli mbi asetet e ndërmarrjeve

Përftimi i kontrollit mbi asetet mund të konsiderohet si përqëndrim vetëm nëse këto asete janë pjesë përbërëse e ndërmarrjes si njësi e saj ose e përbëjnë atë si një e tërë. Konsiderohet përqëndrim nëse këto asete përbëjnë një biznes më një xhiro vjetore në kuadër të pronësisë intelektuale mbi bazën e markave tregtare, patentave, apo të drejtave të tjera të parashikuara nga korpusi ligjor i pronësisë intelektuale. (The Takeover Code, F5/Rule 9, 2013: 137)

Një shqyrtim të veçantë kërkon kontrata *outsourcing*¹⁵ (kontratë e veçantë shërbimesh). Në të shumtën e rasteve këto kontrata nuk përfshijnë transferimin e aseteve apo punonjësve tek ofruesi i shërbimeve të jashtme. (Santoro: 2010, 1113) Në rastet kur ofruesi i shërbimeve outsourcing përfiton të drejtën për të drejtuar asetet dhe nëpunësit, nuk përbën përqëndrim, pasi kjo kontratë është e ngjashme me kontratat e tjera të shërbimeve pavarësisht ekskluzivitetit të përdorimit ekskluzivisht të këtyre aseteve. Nëse ofruesi i outsourcing kryen aktivitete të cilat kanë bazë transferimin e aseteve ose nëpunësit, atëherë situata mund të kërkojë një vlerësim nga Autoriteti i Konkurrencës. Nëse një ndërmarrje është në këto rrethana, pra, është aktive në treg dhe asetet përbëjnë një pjesë ose të gjithë ndërmarrjen, atëherë shoqëria tregtare në fjalë mund të përbëjë përqëndrim. (Catricala, Troiano: 2010,

¹⁴ Franchising është një marrëdhënie biznesi në të cilën pronari i Franchises i jep të drejtën një personi ose një grupi individësh për tregtimin dhe shpërndarjen e mallrave ose shërbimeve duke përdorur emrin e kompanisë së tij. Ndryshe quhen edhe kontrata ekskluziviteti.

¹⁵ Kontrata outsourcing është akti në bazë të së cilit njëra palë i kërkon palës tjetër të kryejë për llogari të tij një pjesë të shërbimeve për të cilat kanë rënë dakort në kontratën specifike.

1313) Përsa i përket aseteve të transferuara, ato duhet të përfshijnë know-how/njohuritë e kërkuara (përsonein përkatës dhe të drejtat e pronësisë intelektuale). Asetet e transferuara duhet të përfshijnë elementët që bëjnë të mundur shfaqjen në treg të përftuesit, pothuajse në të njejtën periudhë me fillimin e sipërmarrjes së përbashkët. Në këto raste Autoriteti i Konkurrencës do të marrë në konsideratë biznes-planet dhe treguesit e përgjithshëm të tregut për vlerësimin e kompanive. (Udhëzimi mbi Kontrollin e Përqëndrimeve ndërmjet Ndërmarrjeve: 2012, 7)

Koncepti i përqëndrimeve në kuadër të transaksioneve të cilat sjellin një ndryshim të qëndrueshëm në kontrollin e ndërmarrjeve përbën shkak për një abuzim potencial në një ristrukturim, ndërsa transaksionet që kanë në bazë të tyre një ndryshim të përkohshëm në kontrollin e ndërmarrjeve, atëherë nuk jemi para përqëndrimit, duke theksuar ashtu siç e parashikon edhe neni 10 i ligjit të konkurrencës se mund të ketë përqëndrim vetëm atëherë kur ndodh një ndryshim kontrolli.

Krijimi i një ndërmarrje të përbashkët nuk përbën një përqëndrim, në rast se ka për objekt apo pasojë *bashkërendimin e veprimtarive konkurruese*¹⁶ ndërmjet dy ose më shumë ndërmarrjesh të pavarura, në këtë rast, krijimi i një ndërmarrje të përbashkët vlerësohet në bazë të nenit 4 të ligjit “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”.

¹⁶ Bashkërendimi i veprimtarisë konkurruese mes ndërmarrjeve është parashikuar në ligjin “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” i ndryshuar. Konkretisht janë të ndaluara këto marrëveshje: ”Ndalohen të gjitha marrëveshjet, të cilat kanë si objekt ose si pasojë pengimin, kufizimin ose shtrembërimin e konkurrencës në treg, veçanërisht marrëveshjet që: a) caktojnë, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, çmimet e blerjes ose të shitjes, apo çdo kusht tjetër tregtimi; b) kufizojnë ose kontrollojnë prodhimin, tregjet, zhvillimin teknik ose investimet; c) ndajnë tregjet ose burimet e furnizimit; ç) në marrëdhëniet tregtare me palët e tjera, zbatojnë kushte të ndryshme për transaksione të njëjta, duke i vendosur ato në gjendje të pafavorshme konkurrence; d) kushtëzojnë lidhjen e kontratave me pranimin nga palët e tjera kontraktuese të detyrimeve shtesë, që për nga natyra ose nga përdorimi i tyre tregtar nuk kanë lidhje me objektin e këtyre kontratave.

Kontrollin nëpërmjet aseteve po e ilustrojmë me një vendim të Komisionit të Konkurrencës. Rasti i fundit për përftimin e kontrollit mbi asete është trajtuar nga Komisioni në vitin 2014. Konkretisht, Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të raportit mbi njoftimin e përqëndrimit Alpha Bank S.A – Citi Bank Internacional PLC - Diners Club of Greece Finance Company S.A, vërejtë se në lidhje me transaksionin përqëndrimi realizohej me anë të “Marrëveshjes për shitjen dhe transferimin e biznesit të Citi Bank për konsumatorin dhe aksioneve të Diners Co.” të datës 13 Qershor 2014, e lidhur midis palëve Alpha Bank S.A, Citi Bank Internacional PLC dhe Citit Bank Overseas Investment Corporation, me objekt përftimin e kontrollit, nga Alpha Bank S.A, të aseteve të zotëruara nga Citi Bank Internacional PLC që i përkisnin aktivitetit të shërbimeve bankare për individë të grupit ndërkombëtar të Citi në Greqi dhe të ndërmarrjes Diners Club of Greece Finance Company S.A nëpërmjet përftimit të masës prej 100% të kapitalit aksionar në këtë të fundit. Transaksioni i cili realizohej në formën e përftimit të kontrollit të pjesshëm mbi një ndërmarrje (biznesi i Citi Bank) dhe të kontrollit ekskluziv në shoqërinë Diners Co sillte një ndryshim afatgjatë në cilësinë e kontrollit, në kuptim të nenit 10, pika 1, shkronja b) e ligjit dhe përbënte një përqëndrim. Gjithashtu përqëndrimi i njoftuar përmbushte edhe kushtet e nenit 12 të ligjit përse i përket xhirove (neni 12/1). (Komisioni i Konkurrencës, Vendimi 328/2014)

Në rastin konkret treg përkatës i produktit do të konsiderohej shërbimi bankar për individë (depozita dhe shërbime për llogaritë (llogari kursimi, llogari rrjedhëse etj), kreditim (kredi personale, kredi konsumi, overdraft, kredi për biznese, etj), bono thesari, etj). Veprimtaritë bankare për korporatat dhe veprimtaritë e transportit të Citi Bank Internacional PLC ishin jashtë qëllimit të transaksionit, pra nuk do të konsideroheshin treg përkatës i produktit. Për

analizimin e këtij rasti, treg gjeografik do të konsiderohej tregu kombëtar, pra, tregu i brendshëm. Duke analizuar pozicionin në treg pas përqëndrimit, Komisioni u shpreh se përqëndrimi nuk sillte asnjë ndryshim të strukturës së tregut bankar në Shqipëri, pasi Citi Bank International PLC dhe Diners Club of Greece Finance Company SA nuk ishin prezente në RSH me asnjë filial, degë, shoqëri të lidhur apo asete (apo ndonje formë tjetër aktiviteti). Transaksioni nuk përfshinte Alpha Bank Albania sha, e cila momentalisht zotërohej dhe do të mbetej në zotërimin direkt dhe 100% të Alpha Bank S.A. Transaksioni i propozuar do të rezultonte në sinergji të dobishme për Alpha Bank S.A, duke e lejuar atë të përballonte mjedisin e ri në industrinë bankare si rrjedhojë e krizës financiare. Alpha Bank S.A do të fitonte akses në praktikat më të mira të zbatuara nga një bankë ndërkombëtare duke e lejuar atë të bëhej konkurruese në nivel europian. Alpha Bank S.A do të fitonte akses në klientë të shtresave të pasura apo shtresave të pasura në zhvillim, likuiditete më të larta, teknika të avancuara për sigurimin e shërbimeve dhe të shitjeve me vlerë neto të lartë, si dhe akses në sistemet e avancuara të administrimit të riskut dhe në një bazë njohurish më të gjerë të mbështetur nga personeli ekspert dhe me eksperiencë si Citi Bank International PLC. Prandaj KK-ja vlerësoi se transaksioni i njoftuar përbënte një ndryshim kontrolli në mënyrë të qëndrueshme që rezultonte prej blerjes nga Alpha Bank S.A: 1. aksioneve të aktivitetit tregtar target të Citi Bank; 2. të gjitha aksionet e lëshuara nga Diners Club of Greece Finance Company S.A. Përqëndrimi nuk sillte asnjë ndryshim të strukturës së tregut bankar në Shqipëri, pasi Citi Bank International PLC dhe Diners Club International L.t.d. nuk ishin prezente në Shqipëri me asnjë filial, degë, shoqëri të lidhur apo asete (apo ndonje formë tjetër aktiviteti). Pas realizimit të përqëndrimit nuk do të ndodhte asnjë ndryshim në strukturën e aksionarëve të Alpha Bank Albania sha. Sa më sipër, ky përqëndrim nuk shfaqte shenja të

kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese dhe për këto arsye u propozua t'i kërkonin Komisionit autorizimin e këtij përqëndrimi në përputhje me nenin 56/1 të Ligjit nr 9121, datë 28.7.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar.

Duke u bazuar në argumentat dhe analizën e sipër-shtjelluar Komisioni vendosi të autorizonte përqëndrimin e realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit nga Aplha Bank S.A, të aseteve të zotëruara nga Citi Bank Internacional PLC që i përkasin aktivitetit të shërbimeve bankare për individë dhe të ndërmarrjes Diners Club of Greece Finance Company S.A.

Këto rregulla për përqëndrimet e ndërmarrjeve nuk janë të aplikueshme vetëm për ndërmarrjet private por edhe për ndërmarrjet që zotërohen nga shteti. Në këto raste, nëse operacioni i përqëndrimit do të konsiderohej *ristrukturim i brendshëm*¹⁷ apo përqëndrim, varet nga fakti nëse ndërmarrjet respektive kanë qenë pjesë të së njëjtës njësi ekonomike. Ndërmarrjet shtetërore kanë një sensitivitet më të madh në kuadër të përqëndrimeve. Shteti është autoritet publik dhe për rrejdhojë ka në epiqendër të veprimit interesat publike. Në rastin e ndërmarrjeve shtetërore po ashtu shteti vepron më shumë si një autoritet publik sesa një aksioner me të drejta të plota. Meqënëse interesi publik prevalon mbi interesin privat, atëherë nëse nuk arrihet qëllimi apo efekti i influencës në vendim-marrje mbi aktivitetin e ndërmarrjes, rezultonte se nuk përbënte kontroll përqëndrimi.

¹⁷ Ristrukturimi i brendshëm mund të shfaqet në disa forma: a) shkrirjen e një ndërmarrje në një subjekt të vetëm në rastet kur dy ndërmarrje funksionojnë si një biznes i vetëm por që kanë entitete të veçanta ligjore; b) në rastin e zmadhimit të pjesëmarrjes aksionare të cilat shoqërohen me ndryshim të kontrollit të transaksioneve, etj.

4.5 Kontrolli nëpërmjet ushtrimit të së drejtës së votës

Kontrolli mund të përfitohet nga një ndërmarrje e cila blen shumicën e aksioneve me të drejtë vote në një shoqëri të caktuar. Ndërmarrja blerëse nëpërmjet përftimeve të së drejtave maxhoritare të votës, ka fuqinë që të përcaktojë vendime strategjike tregtare mbi ndërmarrjen tjetër. Përsa i përket kontrollit të ushtruar nga një person, atëherë fuqia e vendim-marrjes strategjike nuk mund të ushtrohet për efekt imponimi por nëpërmjet vetos strategjike të vendim-marrjes, e cila ka fuqinë për të bllokuar marrjen e kësaj kategorie vendimesh. Kontrolli i vetëm është i aplikueshëm edhe kur statuti i kompanisë mund të kërkojë një shumicë të cilësuar për vendime strategjike, por përfitimi i shumicës së thjeshtë të votave mund të jetë i mjaftueshëm për t'i dhënë përftuesit të drejta veto-je, për rrjedhojë edhe *kontrollin negativ*¹⁸. (Malltezi: 2011, 108)

Për të mundësuar aksionarët e pakicës që të përcaktojnë sjellje tregtare strategjike mund të vendosen aksione preferenciale për të cilat të drejtat e veçanta janë të bashkëlidhura me aksionarin. Ekziston dhe një rast kur një aksionar në minorancë presumohet se ka kontrollin i vetëm. Ky është një moment kur mbi bazat e pjesëmarrjes së aksioneve, modelit të votimit në asamble dhe pozicionit të aksionarëve të tjerë, bëhet e mundur që aksionari i pakicës të ketë një status kontrolli. (Jones, Sufrin: 2011, 854)

Kontrolli i përbashkët karakterizohet nga mundësia për të bllokuar situatën në të cilën dy ose më shumë ndërmarrje kanë fuqinë për t'u impunuar në treg duke refuzuar vendimet strategjike të propozuara. Duhet theksuar se ashtu si tek kontrolli i vetëm edhe kontrolli i

¹⁸ Kontrolli negativ i një ndërmarrje është atëherë kur një aksionar ka të drejtën e ushtrimit të veto-s së tij por nuk ka të drejtën e imponimit të vendim-marrjes strategjike në kompaninë që zotëron. Kontrolli negativ mund të zbatohet kur një aksionar ka 50% të aksioneve në një ndërmarrje, ndërsa 50%-i tjetër është në pronësi të aksionarëve të tjerë.

përbashkët mund të arrihet mbi baza de jure dhe de facto. Një formë specifike e kontrollit të përbashkët ekziston kur janë vetëm dy ndërmarrje të cilat ndajnë në mënyrë të barabartë të drejtat e votës në një ndërmarrje të përbashkët (joint venture). Një formë e tillë përqëndrimi ekziston kur krijohet një kompani e përbashkët dhe paraqitet në treg si një njesi ekonomike e pavarur. (Malltezi, 2013: 417) Këto lloj marrëveshesh mund të jenë formale ose joformale. E drejta e vetos mund të parashikohet në statutin e shoqërisë ose të parashikohet në marrëveshjen mes shoqërive. Kjo e drejtë mund të aplikohet nëpërmjet një organi në kompani, ose nëpërmjet kuorumit të caktuar nga asambleja. Të drejtat e vetos të cilat japin kontroll për poseduesin e tyre përfshijnë vendime për *politikat e ndërmarrjes*¹⁹, duke mundësuar ndërmarrjen më të influencojë në lidhje me sjelljen strategjike të biznesit. Në mungesë të të drejtave specifike të vetos, dy ose më shumë ndërmarrje mund të kenë kontroll të përbashkët kur aksionarët e minorancës kanë ose disponojnë disa mjete ligjore të caktuara për të ushtruar kontrollin. Këto mjete mund të shfaqen nëpërmjet formës së shoqërisë holding (e kontrolluar bashkërisht), ku aksionarët i transferojnë të drejtat e tyre nëpërmjet një marrëveshje mes tyre. Gjendja oligopolistike e këtyre shoqërive e bën më të prekshëm këtë fenomen, prandaj është e nevojshme që të ndërhyjnë instancat që janë të ngarkuara me këtë detyrë të minimizojnë rrezikun e abuzimit me këto ndërmarrje. Sa më shumë ndërmarrje të jenë në treg në të njejtën fushë shërbimesh apo prodhimesh, aq më e vogël është mundësia e abuzimit nga ato.

Autoriteti i Konkurrencës nëpërmjet Komisionit të Konkurrencës si organi i ngarkuar me përgjegjësi për kontrollin e përqëndrimeve ka autorizuar një përqëndrim mes dy shoqërive,

¹⁹ Politikat e ndërmarrjes janë të përbëra nga biznesi plani, buxheti, caktimi i menaxherëve, menaxhimi i resurseve të shoqërisë, investimet, etj.

në një rast për përftim kontrolli në mënyrë të pjesshme, nëpërmjet transferimit të një pjese të aksioneve nga CEZ sha, tek Ministria e Zhvillimit Ekonomik Tregtisë dhe Sipërmarrjes (MZHETS). Pas shqyrtimit të raportit të përqëndrimit për çështjen në fjalë, Komisioni vërejtë se në lidhje me transaksionin e transferimit të 76% të aksioneve të shoqërisë CEZ SH.A (OSHEE SH.A) nga shoqëria CEZ A.S. tek Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes (MZHETS), realizohej nëpërmjet “marrëveshjes për blerje aksionesh”, midis CEZ A.S (Shitësi) dhe Ministria Shqiptare e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes (MZHETS) që vepron në emër të Republikës së Shqipërisë (Blerësi). Objekti i kontratës ishte tërësia e aksioneve të zotëruara nga shoqëria CEZ A.S, që përbënin pjesën prej 76% të aksioneve të CEZ SH.A (OSHEE SH.A). MZHETS përftonte me anë të kësaj kontratë 76% të aksioneve të shoqërisë OSHEE SH.A duke u bërë kështu zotëruesi i vetëm i 100% të aksioneve të kësaj shoqërie dhe duke e rikthyer atë në një shoqëri me kapital tërësisht shtetëror. Ky transferim i aksioneve ishte i nevojshëm për shkak se zgjidhja me mirëkuptim, nga ku edhe nënshkrimi i marrëveshjes më datë 23 Qershor 2014, ka qenë një kërkesë e institucioneve ndërkombëtare financiare, me qëllim lëvrimin e fondeve të nevojshme për rimëkëmbjen e sektorit. Transaksioni i realizuar ndërmjet palëve pjesëmarrëse në kuptim të nenit 10/1/b dhe 10/2 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, ishte përftim i kontrollit të vetëm, për këtë arsye i nënshtrohej procesit të kontrollit të përqëndrimeve.

Në kuadër të procedurave të ndjekura Autoriteti Konkurrencës ishte njohur për përqëndrimin me objekt përftimin e kontrollit të vetëm dhe ekskluziv të shoqërisë OSHEE SH.A nëpërmjet transferimit të pjesës prej 76% të aksioneve të kapitalit aksionar nga CEZ A.S tek MZHETS, nga Ministri i Energjisë dhe Industrisë. Autoriteti i Konkurrencës, menjëherë i është

përgjigjur Ministrisë, ku i ka kërkuar të plotësonte dokumentacionin përkatës sipas legjislacionit për “Përqëndrimet e Ndërmarrjeve”. Gjithashtu Sekretariati i kërkoj Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) dhe Drejtorisë Rajonale Tatimore të Tatimpaguesve të Mëdhenj, bilancet e konsoliduara të shoqërive OSHEE SH.A, Shared Services Albania SH.A dhe CEZ Trade Albania Sh.p.k. për vitet 2011-2013. Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes depozitoi me anë të shkresës nr. 378/3 prot., datë 03.10.2014, Fomularin e Thjeshtuar të Njoftimit të Përqëndrimit dhe dokumentacionin përkatës. Së fundmi, OSHEE depozitoi pasqyrat financiare të audituara për vitin 2013 për shoqërinë CEZ SH.A, me anë të postës elektronike, ndërsa Drejtoria Rajonale Tatimore e Tatimpaguesve të Mëdhenj depozitoi dokumentacionin e kërkuar me shkresë. Të njëjtin dokumentacion dërgoi edhe QKB-ja. Autoriteti i Konkurrencës, më datë 15 Shtator 2014, në faqen zyrtare publikoi njoftimin për shprehjen e interesit të palëve të treta. Nga palët e treta nuk kishte asnjë koment mbi procedurën e kontrollit të përqëndrimit MZHETS - CEZ A.S deri në momentin e dorëzimit të këtij raporti. (Komisioni i Konkurrencës, Vendimi 331/2014)

Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike kishte ekskluzivitet menaxhimin, mirëmbajtjen dhe zhvillimin e rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike të tensioneve 35, 20, 10, 6 dhe 0,4 kV, si dhe menaxhimin e nën-stacioneve me tension 110 kV dhe më të ulët. OSHEE SH.A, gjithashtu kishte ekskluzivitetin e Furnizimit Publik me Pakicë në tregun e energjisë elektrike për konsumatorët tariforë. Përqëndrimi i njoftuar shprehej në formën e rikthimit të një monopoli publik nga një shoqëri private, e cila zotëronte kontrollin e operatorit të sistemit të shpërndarjes pasi kishte 76% të aksioneve. Komisioni i Konkurrencës me Vendimin Nr. 111, datë 15.05.2009 “Mbi autorizimin e përqëndrimit të realizuar nëpërmjet transaksionit të shitblerjes së 76% të aksioneve të OSSH sha nga Ministria e

Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës tek shoqëria CEZ A.S autorizoi transferimin e 76% të aksioneve të kompanisë që zotëronte pozicionin monopoli në tregun e furnizimit dhe të shitjes me pakicë së energjisë elektrike tek konsumatori përfundimtar. Në këtë vendim, Komisioni i Konkurrencës u shpreh për rolin e Entit Rregullator të Energjisë lidhur me dy aspekte si mbrojtja e konsumatorit dhe rregullimi i tregut. Komisioni i Konkurrencës rekomandoi rregullimin dhe monitorimin si instrumenta për zhvillimin e një tregu eficient të energjisë elektrike dhe mbrojtjen e konsumatorit nga fuqia e tregut që zotëronte ky monopol. Në vitet e para pas privatizimit, 2010 dhe 2011, OSSH, si rezultat i uljes së nivelit të humbjeve teknike dhe jo teknike, pati një përmirësim të situatës dhe performancës financiare. Por, që nga viti 2012 e në vijim, treguesit financiarë u përkeqësuan ndjeshëm dhe humbjet arritën në 37 miliardë e 917 milionë lekë (rreth 370 milionë dollarë) ndërkohë që treguesi i humbjeve arriti në 46%. Kjo performancë financiare ndikoi ndjeshëm në uljen e aftësisë paguese të kompanisë CEZ SH.A, për të blerë energji elektrike. Në kushtet e përkeqësimit të performancës së kompanisë së shpërndarjes së energjisë elektrike, më 21 Janar 2013, ERE mori vendimin për heqjen e licensës kompanisë CEZ Shpërndarje SH.A në aktivitetin e shpërndarjes dhe furnizuesit publik me pakicë. Kompania CEZ Shpërndarje SH.A u vendos në administrim të përkohshëm. (Marrë nga: <http://caa.gov.al>) Problematika financiare e operatorit të sistemit të shpërndarjes ka pasur efekt në gjithë tregun e energjisë dhe ekonominë në tërësi, për shkak të rolit të energjisë në industri, tregti, shërbime dhe në mirëqënien e konsumatorëve. Ndërmarrja target e këtij transaksioni objekt shqyrtimi, kishte një efekt të rëndësishëm në treg, i cili lidhet me fuqinë e tregut që ndërmarrja zotëron, si dhe me llojin e të mirës së ofruar, që është një produkt jetik për ekonominë e vendit dhe konsumatorin shqiptar. Në këto kushte, përcaktimi i saktë i marrëdhënieve financiare të kësaj

kompanie, pritej të kishte efekte si në sjelljen e saj, ashtu dhe në mirë-funksionimin e tregut të energjisë elektrike, në përputhje me parimet e konkurrencës së lirë dhe efektive në këtë sektor. Përsa më sipër, monitorimi i rregullimit dhe i sjelljes së ndërmarrjes në treg, nga Autoriteti i Konkurrencës në bashkëpunim të ngushtë me ERE-n me synimin e rritjes së efikasitetit të këtij tregu, ishte i domosdoshëm. Nga pikëpamja e strukturës së tregut ky përqëndrim nuk e ndryshonte pozicionin monopol të ndërmarrjes në treg sipas parashikimeve të nenit 56 të ligjit “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar. Ligji “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” në nenin 3, pika 1, përcakton të njëjtin trajtim për ndërmarrjet për çdo person fizik ose juridik, privat ose publik. Në këto kushte, Komisioni vendosi të autorizonte përqëndrimin e realizuar nëpërmjet transferimit të 76% të aksioneve të shoqërisë CEZ nga shoqëria CEZ A.S. tek Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes. Në këtë mënyrë KK-ja aplikoi praktikën ligjore për të lejuar një përqëndrim në kushtet e sipërcituara.

4.6 Konkluzion

Si konkluzion, në këtë kapitull u trajtua përqëndrimi i ndërmarrjeve nëpërmjet përfutimit të kontrollit, objekti i kontrollit, etj. Kontrolli, mund të përfutet nëpërmjet të drejtave, kontratave ose çdo mënyre tjetër, të cilat, më vete ose të kombinuara krijojnë mundësinë e ushtrimit të një ndikimi vendimtar mbi veprimtarinë ekonomike të një shoqërie, me anë të drejtës së pronës ose të drejtës për të përdorur të gjitha ose një pjesë të aktiveve të një shoqërie.

Në fokus u vendosën mënyrat e përfutimit të këtij kontrolli, të cilat janë nëpërmjet përfutimit të plotë, pra 100% të aksioneve, nëpërmjet një pjese të kapitalit të ndërmarrjes, me anë të

transaksioneve, nëpërmjet ekskluzivitetit, vendosjes së kontrollit mbi asetet, si edhe me ushtrimin e të drejtës së votës. Nga kjo e fundit rezulton se, që të ushtrojnë veprimtarinë si shoqëri të bashkuara, jo vetëm njëra nga shoqëritë duhet të ketë të drejtën e votës vendimtare – pasi kjo do të çonte në kontroll të vetëm nga ndërmarrja në fjalë – por të paktën edhe një tjetër nga ndërmarrjet e përbashkëta duhet ta ketë këtë votë, pasi në këtë mënyrë krijohet një ndërvarësi mes këtyre shoqërive tregtare.

Në veçanti, për përqëndrimet e shoqërive tregtare, Autoriteti njoftohet për autorizim, nëse në vitin e fundit financiar, para përqëndrimit, xhiroja e të gjitha shoqërive pjesëmarrëse së bashku në tregun ndërkombëtar është më shumë se 7 miliardë lekë dhe xhiroja e të paktën një ndërmarrjeje pjesëmarrëse, në tregun e brendshëm është më shumë se 200 milionë lekë. Së dyti, kur xhiroja e të gjitha shoqërive pjesëmarrëse së bashku në tregun e brendshëm është më shumë se 400 milionë lekë dhe xhiroja e të paktën një, në tregun e brendshëm, është më shumë se 200 milionë lekë. Njoftimi bëhet brenda 30 ditëve nga lidhja e marrëveshjes për bashkim, përftim kontrolli ose për krijimin e një ndërmarrje të përbashkët.

Në vëmendje u vendos fakti se, përftimet e kontrollit nëpërmjet ndërmarrjeve të ndryshme janë një nga metodat më të përdorura në tregun shqiptar për të operuar në kuadër të përqëndrimeve. Kryesisht, kjo vjen si rrjedhojë e fuqisë së vogël të tregut të brendshëm duke mos qenë nevoja që të kryhen transaksione për bashkim/shkrirje. Në praktikën e Autoritetit të Konkurrencës të trajtuar në kapitullin e mësipërm, vihet re se edhe shoqëritë e huaja që operojnë në tregun shqiptar, si praktikë përqëndrimi përdorin përftimin e kontrollit nëpërmjet mënyrave që ka parashikuar legjislacioni në fuqi. Nga ana e ligjit material, hapësirat ligjore janë të njëjta si për operacionet e përqëndrimeve në kuadër të përftimit të kontrollit, ashtu edhe në rastet e bashkimit/shkrirjeve. Vlen të theksohet se firmat që ushtrojnë veprimtari

tregtare në Republiën e Shqipërisë, kryesisht, kanë tendencën t'i blejnë kompanitë rivale duke krijuar një tendencë të pozitës dominuese, për të cilat Autoriteti në praktikën e tij duket që nuk i ka kufizuar në masë të gjërë këto përqëndrime. Për rrjedhojë, formacionet e mëdha monetare që ushtrojnë veprimtari në tregun e brendshëm kanë një rol dominues në treg, rol ky që duhet të jetë nën monitorimin e Autoritetit për shkak të dëmeve që mund t'i shkaktohen tregut në përgjithësi por edhe konsumatorit në veçanti.

KAPITULLI V – RREGULLAT DHE PROCEDURAT QË ZBATOHEN PËR OPERACIONET E PËRQËNDRIMEVE TË NDËRMARRJEVE

5.1 Procedurat përqëndrimit të aplikuara nga shoqëritë tregtare në kuadër të rregulloreve të brendshme

Dispozitat e ligjit për riorganizimin e shoqërive tregtare janë të zbatueshme për *shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar dhe shoqëritë aksionere*²⁰ duke lënë jashtë këtyre skemave *shoqëritë komandite dhe shoqëritë kolektive*²¹. (Neni 214, Ligji 9901/2008) Për shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar dhe shoqëritë aksionere, kuadri ligjor në fuqi parashikon mënyrën e hollësishme të riorganizimit, ndërsa për shoqëritë e personit nuk parashikohet kjo praktikë, por kjo nuk duhet kuptuar si vakuum ligjor në praktikën e ndjekur për shoqëritë e personit, pasi riorganizimi nga ana e këtyre shoqërive ka më pak rregulla, meqënëse në këto raste janë personat që i zotërojnë shoqëritë, që përgjigjen pa kufizime ndryshe nga pronarët e shoqërive të kapitalit për dëmet e shkaktuara nga ndjekja e këtyre praktikave.

Procedurat për bashkimin dhe shkrirjet e ndërmarrjeve janë diçka e ndryshme nga sipërmarrja. (Rodger: 2009, 78) Bashkimet dhe shkrirjet janë të rregulluara nga ligjet dhe rregulloret e të drejtës së konkurrencës. Fillimi i një operacioni përqëndrimi me shkrirje mund të bëhet me anë të marrëveshjeve të përbashkëta ndërmjet shoqërisë transferuese dhe

²⁰ Këto lloj shoqëri tregtare janë shoqëri kapitali dhe në tregun modern janë më të aplikuara nga tregtarët për vetë lehtësirat që ofrojnë në ushtrimin e veprimtarisë.

²¹ Shoqëritë komandite dhe kolektive janë shoqëri personash, të cilat nuk janë shumë të përdorura në tregjet moderne, për shkak të përgjegjësisë së pakufizuar që kanë subjektet që gëzojnë pronësinë mbi këto kompani.

shoqërisë së transferuar, por një marrëveshje e thjeshtë nuk mjafton dhe nuk sigurohet një mbulim ligjor i transaksionit, nëse nuk mbart miratimin e Autoritetit të Konkurrencës për të cilat procedura e përcaktuar duhet të ndiqet për efekt vlefshmërie. Procedura e këtyre operacioneve është komplekse, përfshin jo vetëm kompromise ose marrëveshje mes kompanive dhe kreditorëve të saj, por gjithashtu, edhe mbrojtje të interesit publik dhe reflektohet në politikën publike, si pasojë e korrelacionit midis shtetit dhe tregut.

Asamblетë respektive të shoqërive që kërkojnë të kryejnë një operacion përqëndrimi, përcaktojnë qëllimin e organizimit të ri dhe rivlerësojnë kornizat e politikave, për të arritur objektivat e kërkuara. (Mankiw: 2010, 462) Qëllimi i shoqërisë së re, për zgjerimin e biznesit, mund të jetë kryer nëpërmjet kombinimit të biznesit asimilues dhe një korporate e cila mund të kontribuojë në drejtimin e nevojshëm për realizimin e qëllimit, që mund të jetë në kuadër të zgjerimit të biznesit nëpërmjet zgjerimit të aktivitetit tregtar, p.sh: furnizimin e inputeve, për prodhim, duke shtuar produkte të reja dhe të përmirësuara teknologjike, duke siguruar kanale të reja shpërndarëse në segmente të ndryshme të tregut duke zhvilluar qendrat kërkimore dhe aftësitë e personelit, etj.

Menaxhmenti i lartë mund të përdorë kontaktet e tyre me konkurrentët në të njëjtën linjë të aktivitetit ekonomik ose në fusha të tjera të shumëllojshme të cilat mund të identifikohen si bashkimi më i mirë i mundshëm. Partnerët mund të përdorin kontaktet me bankierët, konsulentët financiar dhe agjencive të tjera në gjetjen e partnerëve të përshtatshëm për bashkim. (De Blasi: 2008, 889) Një numër i kandidatëve të korporatës mund të jetë përzgjedhur dhe identifikuar nga drejtuesit e kompanive. Një identifikim i tillë, duhet të bazohet në një informacion të detajuar të bashkimit. Partnerët e mbledhur që bien darkort publikojnë një informacion të tillë që duhet të zbulojë: a) historinë organizative të biznesit

dhe strukturën e kapitalit; b) qëllimet organizative; c) produktet që ofron, dhe konkurrentët në tregun ku operon; d) skema organizative dhe modelet e menaxhimit; e) profili dhe pasuria, e luajtshme apo e paluajtshme (real estate); f) kualifikimin dhe aftësinë e personelit. (Mangini, Olivieri: 2009, 95)

5.2 Hapat dhe negociatat e operacionit të përqëndrimit në ligjin amerikan “Antitrust”

Aksionarët pronarë mund të negociojnë për një kohë të caktuar me disa kompani për të përcaktuar cila është më e përshtatshme për partneritet. Kështu, bëhet e mundur të identifikohet se cila nga shoqëritë potenciale mund të ofrojë kushtet më të favorshme. Aspekte të ndryshme merren në konsideratë lidhur me plan biznesin, qëllimin, formën, dhe datën e bashkimit, profitabilitetin dhe vlerësimin. Pra, përveç anës ekonomike janë edhe aspektet tatimore dhe ligjore pas bashkimit. Në ligjin antitrust në mënyrë që të aprovohet një përqëndrim duhet që të vendoset aprovimi me vendim gjykate. Skema e bashkimit duhet të përgatitet nga ana e kompanive, të cilat kanë arritur në një konsensus të përbashkët dhe pastaj të dërgohet në gjykatë për t’u miratuar. Në mënyrë që të kryhet operacioni i përqëndrimit duhet të ndiqen disa procedura. (I) Nuk ka asgjë të veçantë në formën e paracaktuar për skemën e shkrirjes por skema duhet në përgjithësi të përmbajë këto informacione: (Marrë nga: <http://ftc.gov>) 1) Të dhënat rreth shoqërive të transferuara dhe shoqërive transferuese; 2) Datat e veprimeve; 3) Kushtet kryesore të transferimit të aseteve nga transferuesi tek marrësi me fuqinë për të ekzekutuar vendimet ose për transferimin e akteve ose dokumenteve; 4) Kushtet kryesore të detyrimeve të transferimit nga transferuesi tek marrësi duke mbuluar të gjitha kreditë, bonot, detyrimet e tjera nga banka, institucionet financiare, të besuarit, etj.; 5) Datat kur skema do të hyjë në fuqi; 6) Kushtet si të mbahet aktiviteti tregtar

nga transferuesi ndërmjet "datave e caktuara" dhe "datave efektive"; 7) Përshkrimi i pasojave për shoqëritë, të skemës që hyn në fuqi; 8) Kapitali i transferuesit, kompania specifikuar dhe e autorizuar, kapitali i lëshuar dhe regjistrimi i shoqërisë; 9) Kapitali dhe shpërndarja e tij; 10) Përshkrimi i pjesës së propozuar, raporti i këmbimit, të gjitha kushtet bashkëngjitur me to, certifikatat e aksioneve që do të lëshohen, përgjegjësia e kompanisë, autoritetet për lëshimin dhe ndarjen e aksioneve; 11) Dorëzimi i aksioneve nga aksionari i kompanisë transferuese për shkëmbim në pjesën e re të certifikatës; 12) Kushtet për pagesën e dividendit, renditja e kapitalit/aksioneve; 13) Statusi i punonjësve të kompanisë transferuese nga data efektive dhe gjendja e fondit të kursimit, shpërblimet nga fondi, fondet për pensionin apo ndonjë skemë e veçantë në kuadër të përfitimit të punonjësve; 14) Trajtimi në datën efektive të debive të kompanive transferuese; 15) Dispozita të ndryshme që mbulojnë detyrimet e të ardhurave tatimore, të papriturat e hyrje-daljeve në kuadër të auditimeve; 16) Angazhimi i transferuesit dhe kompanive transferuese drejt aplikimeve, petitionet; 17) Rritja e kufinjve të huamarrjes së kompanisë pas hyrjes së skemës në fuqi; 18) Tagri i ndërmarrjeve të transferuara dhe ndërmarrjeve transferuese të cilat kanë të drejtë të japin pëlqimin për të ndryshuar skemat e përqëndrimit në gjykatë apo kompetenca të tjera që mund të ushtrojnë kompanitë e përqëndruara; 19) Përshkrimi i kompetencave të deleguara në transfertë për efekt të skemës; 20) Miratimi i agjencive të ndryshme në lidhje me veprimtarinë e skemës; 21) Revokimi/anullimi i skemës në mungesë të miratimeve nga autoritetet përkatëse; 22) Mbajtja e shpenzimeve në lidhje me skemën e re. (Marrë nga: www.law.nyu.edu)

(II) Miratimi i Bordit Drejtues për skemën, ku përkatësisht janë të detyruar të miratojnë skemën e bashkimit për të cilën kanë lidhur marrëveshjen.

(III) Miratimi i skemës nga institucionet e specializuara financiare / bankat / të besuarit në

zotërimin e obligacioneve, ku Bordi i Drejtuesve duhet në fakt të miratojë skemën vetëm pasi të jetë liruar nga detyrimet e institucioneve financiare / bankave, të cilat mund të kenë dhënë kredi për këto ndërmarrje.

(IV) Këmbimi i aksioneve në përqëndrim është një fazë e veçantë në të cilën marrëveshjet mes kompanive dhe këmbimit të aksioneve i kërkojnë kompanisë së re të komunikojë informata të çmimeve në bursë.

(V) Hapi tjetër është për të bërë një aplikim në gjykatën përkatëse me anë të një kërkesë duke depozituar dokumentat e nevojshme për vlefshmërinë e përqëndrimit.

(VI) Në këtë fazë gjykata do të përcaktojë drejtimit, datën, kohën dhe vendin, kuorumin e anëtarëve, etj.

(VII) Dërgimi i njoftimeve për anëtarët/aksionarët.

(VIII) Reklamimi i njoftimit të takimit të anëtarëve. Gjykata mund të urdhërojë lëshimin e njoftimit të mbledhjes së aksionarëve. Kompanitë duhet të dorëzojnë draftin e miratuar për njoftimin që do të publikohet në media. (Marrë nga: <https://www.justice.gov>)

(IX) Konfirmimi i njoftimit. Duhet të sigurohet që të paktën një javë para datës së mbledhjes, kryetari i emëruar për takimin të paraqesë një dëshmi me betim në gjykatë për shërbimin e njoftimeve të aksionarëve, nëse ato janë përmbushur në mënyrë të rregullt me të, apo jo.

(X) Mbajtja e mbledhjes së përgjithshme të aksionarëve dhe kalimi i *rezolutës*²². Takimi i përgjithshëm duhet të jetë mbajtur në datën e caktuar. Skema e shkrirjes duhet të miratohet nga anëtarët me një shumicë të numrit të anëtarëve të pranishëm personalisht ose me prokurë.

²² Rezoluta është një vendim i asamblesë së ortakëve për të bërë ose jo ndryshime në organigramën e shoqërisë ose për ndryshimin e strukturës së kompanisë.

Votimi mbi rezolutën duhet të jetë të paktën 3/4 dhe në vlerën e aksioneve të mbajtura nga anëtarët.

(XI) Paraqitja e rezolutave në mbledhjen e përgjithshme me *Sekretarin e Përgjithshëm*²³ (Registrar of Company). Në rast se aksionarët pas mbledhjes së përgjithshme miratojnë skemën e përqëndrimit, duhet që anëtarët në votim të kenë një shumicë me jo më pak se 3/4 e vlerës së aksioneve të shoqërisë. Një kopje e vendimit të miratuar nga aksionarët duhet t'i dorëzohet Sekretarit të Përgjithshëm, brenda 30 ditëve nga data e kalimit të rezolutës.

(XII) Depozitimi i raportit të Mbledhjes së Përgjithshme në gjykatë. Në këtë fazë, kryetari i asamblesë duhet të dorëzojë në gjykatë brenda shtatë ditëve nga data e takimit, një raport që përcakton numrin e personave që marrin pjesë (personalisht apo me prokurë), dhe përqindjen e aksionarëve që kanë votuar në favor të skemës si edhe rezolutën e miratuar. (Marrë nga: <http://www.atg.wa.gov>)

(XIII) Dorëzimi i peticionit të përbashkët (nga dy shoqëritë, pjesë të operacionit të përqëndrimit) në gjykatë për të ligjeruar implementimin e skemës. Brenda shtatë ditëve nga data në të cilën kryetari ka dorëzuar raportin e tij për rezultatin e mbledhjes, kompanitë duhet të bëjnë një peticion të përbashkët në gjykatën respektive për miratimin e skemës së bashkimit.

(XIV) Lëshimi i njoftimit për Drejtorinë Rajonale të Shoqërive Tregtare, ku gjykata me marrjen e kërkesës për bashkim, duhet të dërgojë njoftimin tek organi rajonal.

²³ Një zyrtar përgjegjës për mbajtjen e regjistrat ose të dhënat zyrtare të shoqërive tregtare në legjislacionin amerikan të korporatave.

- (XV) Dëgjesa e petitionit dhe konfirmimi i skemës. Gjykata do të degjojë kundërshtimet e skemës nga organet kompetente ose çdo person që ka të drejtë, dhe në rast se nuk ka kundërshtime, atëherë gjykata mund të kalojë me urdhër miratimin e skemës së përqëndrimit.
- (XVI) Marrja e vendimit të gjykatës nga kompanitë pjesëmarrëse në bashkim. Përqëndrimi do të hyjë në fuqi që në momentin kur gjykata e depoziton vendimin në sekretari.
- (XVII) Transferimi i aktiveve dhe detyrimeve. Gjykata urdhëron kalimin e kapitalit nga shoqëria e shkrirë tek shoqëria e re.
- (XVIII) Ndarja e aksioneve në shoqërinë e re. Në bazë të skemës së përqëndrimit, aksionarët e kompanisë së transferuar kanë të drejtë të marrin aksione në proporcion me vlerën e kapitalit në shoqërinë e krijuar rishtazi. (Lee Van Voorhis, Vadim Brusser: 2010, 76)
- (XIX) Listimi i aksioneve në bursë. Pas shkrirjes, shoqëria që merr përsipër aktivet dhe detyrimet duhet që të vendosë në bursë emetimin e aksioneve të reja.
- (XX) Ruajtja e dokumentacionit të operacionit të përqëndrimit. Kërkohej nga institucionet zyrtare që pa miratimin e tyre nuk mund të bëhet asgjësimi i dokumentave të bashkimit.
- (XXI) Formalitetet e post regjistrimit, që do të thotë implementimi i rregulloreve të reja, plotësimi i dokumentacionit, ndryshimet përkatëse për shoqërinë e re të krijuar, etj.
- (XXII) Revokimi i përqëndrimit nuk është i lejueshëm. Pas miratimit të aksionarëve dhe kreditorëve për skemën e re, nuk është e pranueshme tërheqja nga kjo skemë, nga momenti që depozitohet në gjykatë kërkesa.

Studimet e dhëna më sipër janë bazuar në ngjarje reale dhe sigurojnë pasqyrë praktike në aspektin procedural. Hapat procedural të parashtruar më sipër nuk përbëjnë tabllonë e detajuar të përqëndrimit por janë baza për miratimin e kësaj praktike. Në mënyrë të plotë janë të përcaktuara nga rregulloret e enteve shtetërore të cilat kërkojnë aplikimin e disa kërkesave

formale të tjera dhe shumë të specifikuara siç mund të jenë raporti i këmbimit të shoqërive, aspektet e kontabilitetit të financimit, planet e riorganizimit, etj. Sidoqoftë në këtë temë është e rëndësishme të tregohet procedura për efekt të krahasimit me legjislacionin shqiptar, duke nxjerrë në pah problematikat e hasura në praktikat e kërkuara nga shoqëritë që kërkojnë të kryejnë një operacion të tillë.

5.3 Procedurat e brendshme për përqëndrimet e ndërmarrjeve në legjislacionin shqiptar

Përqëndrimi i ndërmarrjeve realizohet me krijimin e një shoqërie të re kur realizohet me anë të themelimit të një kompanie të re, tek e cila kalohen të gjitha aktivet dhe pasivet e shoqërive ekzistuese që bashkohen në këmbim të kuotave apo aksioneve të shoqërisë së re. Përqëndrimi me anë të përthithjes bëhet i mundur kur kalojnë të gjitha aktivet dhe pasivet e njëres apo më shumë prej ndërmarrjeve, të cilat quhen shoqëri të përthithura, tek një shoqëri tjetër ekzistuese, e quajtur shoqëria përthithëse, në këmbim të aksioneve apo kuotave të kësaj shoqërie. (Neni 215, Ligji 9901/2008) Në mënyrë që të realizohet një praktikë e tillë duhen plotësuar një sërë kriteresh ligjore të cilat kanë karakter procedural. Në legjislacionin shqiptar është përcaktuar se rregullat procedurale për përqëndrimin me përthithje janë të aplikueshme edhe për përqëndrimin e ndërmarrjeve me krijimin e një shoqërie të re.

Faza e parë e operacionit të përqëndrimit është në kuadër të marrëveshjeve fillestare në raport me bashkimin duke dakortësuar kushtet e riorganizimit. Ndërmarrjet që marrin pjesë në bashkim hartojnë një projekt-marrëveshje me shkrim, ku përcaktohen emrat dhe selitë e shoqërive respektive. Në mënyrë që të arrihet një marrëveshje duhet të hartohet një kontratë e cila ka formën e kërkuar nga ligji, dhe nga këtu pastaj shprehet dhe *vullneti i palëve*

*pjesëmarrëse*²⁴. Pranimi i palëve për kalimin e pasurisë së secilës shoqëri që përthithet në këmbim të aksioneve apo kuotave të shoqërisë përthithëse përbën një fazë tjetër të procedurës së operacionit të përqëndrimit. Përfshirja në një marrëdhënie juridike detyrimi, realizimi i një kontrate apo marrëveshje nënkupton edhe marrjen përsipër të detyrimeve që duhet të përmbushen nga palët me korrektësi. (Çuçi: 2010, 65) Raporti i këmbimit të aksioneve apo kuotave dhe çdo shumë e pagueshme në para, kushtet e ndarjes së aksioneve apo kuotave në shoqërinë përthithëse, të drejtat që rrjedhin nga aksionet e shoqërisë përthithëse, të drejtat që u njihen zotëruesve të aksioneve, kuotave apo të drejtave të veçanta të shoqërive të përthithura apo çdo masë tjetër në favor të tyre, përparësitë e veçanta që u jepen administratorëve, anëtarëve të këshillit të administrimit, këshillit mbikqyrës apo ekspertëve kontabël të autorizuar janë një pjesë themelore për arritjen e marrëveshjes mes palëve. Në çdo rast duhet të parashikohen edhe masat për pasojat që mund të sjellë bashkimi punëmarrësve. Me anë të një raporti të hollësishëm bëhet e mundur që të përshkruhet baza ligjore dhe ekonomike e marrëveshjes dhe në veçanti raporti i këmbimit të aksioneve, etj. Secila nga shoqëritë që merr pjesë në bashkim duhet të depozitojë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit dhe të publikojë në faqen zyrtare të saj projekt-marrëveshjen dhe raportin e bashkimit.

Faza e dytë kërkon si kriter raportin e ekspertëve, ku shoqëritë respektive caktojnë ekspertë të pavarur të fushave të ndryshme në mënyrë të përbashkët ose në mënyrë të veçantë për të

²⁴ Në bazë të së drejtës së detyrimeve, vullneti i lirë kontraktor, si parim është evidentuar vetëm në periudhën e kapitalizmit, ku palët në një kontratë filluan të çliroheshin në mënyrën e zgjedhjes së lirë të personave me të cilët kërkonin të hynin në marrëdhënie juridike, llojin e kontratës, kushtet e saj dhe të drejtat e detyrimit që rridhnin nga marrëveshja. Vullneti i lirë kontraktor është një nga kushtet e vlefshmërisë së kontratës, e sanksionuar në Kodin Civil.

vlerësuar kushtet e projekt-marrëveshjes. Ekspertët kanë aksesueshmëri në të gjithë dokumentacionin e brendshëm të shoqërisë si dhe mund të kryejnë hetime në lidhje me dyshimet që mund t'i ngrihen gjatë procedurës së vlerësimit. Gjithë veprimtarinë e tyre ata e përmbledhin në një raport për metodat e aplikuara në mënyrë që të arrihet qëllimi i raportit të propozuar të këmbimit të aksioneve apo kuotave, nëse këto metoda janë të përshtatshme për operacionin si dhe për vështirësitë që mund të kenë hasur gjatë vlerësimit për një arsye apo një tjetër, gjithmonë në lidhje me ndërmarrjet objekt vlerësimi. Ky raport depozitohet gjithashtu në QKB dhe është detyruesisht i publikueshëm në faqen zyrtare të kompanive. Dispozitat ligjore parashikojnë një përjashtim për përfshirjen e ekspertëve duke i dhënë të drejtën kompanive pjesëmarrëse në përqëndrim të mos i përfshijnë vetëm në rast se ortakët e kompanive bien dakort për këtë vendim. Duhet theksuar fakti se publikimi i bashkimit në QKB sjell një sërë pasojash juridike për shoqëritë e përfshira në bashkim, aksionarët/ortakët dhe kreditorët e tyre. Këtu shënohet një moment i rëndësishëm sepse mund të realizohet kalimi tek shoqëria përthithëse e të gjitha aktiveve dhe pasiveve të shoqërisë që përthithet, duke sjellë pasoja si në marrëdhëniet ndërmjet shoqërive, ashtu edhe tek palët e treta.

Faza e tretë është miratimi i marrëveshjes së bashkimit. Në këtë pikë bëhet e mundur miratimi i projekt-marrëveshjes në bazë të rregullave që kërkon ligji të zbatohen për vendim-marrjen e shoqërive tregtare, ku të gjithë aksionarët duhet të vihen në dijeni për ndryshimet përkatëse.

Faza e katërt ka të bëjë me zmadhimin e kapitalit. Zmadhimi i kapitalit është rritja e kapitalit të shoqërisë tregtare nëpërmjet emetimit të aksioneve të reja ose duke rritur *vlerën nominale*²⁵

²⁵ Vlera nominale është çmimi i shpallur i një aksioni në një treg të caktuar.

të aksioneve ekzistuese. Zmadhimi i kapitalit i aplikuar në këto kushte nuk u nënshtrohet parashikimeve që lidhen me ndalimin e zmadhimit derisa të kryhen të gjitha pagesat e pashlyera, kushteve të nënshkrimit të aksioneve dhe kuotave të reja dhe të drejtave të parablerjes në sektorë të ndryshëm të sipërmarrjes. Referuar praktikave europiane dhe legjislacionit shqiptar njihen dy mënyra të zmadhimit të kapitalit, konkretisht me emetim aksionesh të reja, ose duke rritur vlerën nominale të aksioneve ekzistuese. (Code de Commerce, Livre II Art. L225 - 127)

Në **fazën e pestë** kërkohet regjistrimi dhe publikimi duke përfshirë dhe pasojat që do të vijnë për sipërmarrjen nga kryerja e këtyre veprimeve. Regjistrimi i bashkimit pranë QKB-së mund të ketë pasojë kalimin e të gjitha aktiveve dhe pasiveve tek shoqëria përthithëse, duke sjellë kalimin e aksioneve të ortakëve aksionarë të shoqërisë së përthithur tek shoqëria përthithëse dhe çregjistrimin nga QKB-ja të kompanisë së përthithur meqënëse konsiderohet e prishur. Mbrotjtja e kreditorëve është **faza e gjashtë** e operacionit. Nëse kreditorët paraqesin me shkrim titullin dhe vlerën e pretendimeve të tyre, ndërmarrja duhet t'u japë një garanci për kreditë e tyre. Garancia në këto raste është deklarata e përfaqësuesve ligjorë të kompanive që marrin pjesë në bashkim, por në qoftë se kjo deklaratë nuk lëshohet nga organet kompetente të shoqërive tregtare, në bazë të dispozitave të ligjit për shoqëritë tregtare, kreditorëve u njihet e drejta t'i drejtohen gjykatës për nxjerrjen e një garancie të tillë. (Neni 221, Ligji 9901/2008)

Faza e shtatë përcakton mbrojtjen e zotëruesve të obligacioneve të konvertueshme dhe aksioneve me përparësi, të njejtat të drejta që këta persona gëzonin para operacionit të përqëndrimit.

Në **fazën e tetë** fillon një etapë e re për aksionarët dhe zotëruesit e obligacioneve. Në këtë fazë pas publikimit të bashkimit nga QKB-ja, fillojnë afatet e parashkrimit. Këtu fokusi

vendoset tek mbrojtja e të drejtave të aksionarëve, ku ligji për shoqëritë tregtare ka përcaktuar rregullat e administrimit të shoqërive tregtare. Në legjislacionin e të drejtës së biznesit është e qartë mënyra e funksionimit të ndërmarrjeve private duke ruajtur një rezervë në lidhje me rregulloret e brendshme për efekt të autonomisë së tregut të lirë. Siç u përmend më lart, aksionarët i kemi me të drejtë vote dhe pa të drejtë vote. Sidoqoftë, në rastet e përqëndrimeve të kompanive është asambleja e përgjithshme që me anë të pëlqimit të aksionarëve merr përsipër ndjekjen e kësaj praktike. Ekzistojnë raste kur aksionarët e sipërmarrjeve që bashkohen nuk kanë dhënë pëlqimin për një riorganizim të tillë. Këta kanë të drejtë të kërkojnë nga shoqëria blerjen me vlerë tregu të aksioneve apo kuotave të zotëruara, nga shoqëria që krijohet si pasojë e bashkimit. Rezerva ligjore në këtë rast është e tillë që parashikon se aksionarët në mënyrë alternative mund të kërkojnë nga shoqëria përthithëse këmbimin e aksioneve të tyre pa të drejtë vote, në aksione më të drejtë vote. Në këto kushte është e rëndësishme të theksohet se ligji i shoqërive tregtare parashikon një mbrojtje të plotë për aksionarët në kuadër të praktikave të përqëndrimit, por kjo mbrojtje i nënshtrohet afateve të parashkrimit, ku konkretisht këto afate shtrihen deri në 60 ditë pas publikimit nga QKB-ja.

Faza e nëntë është përgjegjësia e organeve të administrimit, ku administratorët, këshillat e organit të mbikqyrjes, si dhe ekspertët e pavarur të licensuar, të angazhuar me vlerësimin e bashkimit, përgjigjen *solidarisht*²⁶, bashkë me shoqërinë përthithëse, për dëmet që kanë pësuar aksionarët dhe kreditorët e shoqërive që kanë marrë pjesë në bashkim. Baza ligjore

²⁶ Detyrimi është solidar kur kreditori ose secili nga kreditorët ka të drejtë të kërkojë ekzekutimin e njërit detyrim tërësisht apo pjesërisht si nga debitorët së bashku, ashtu edhe nga debitorët veç e veç. Qëllimi i këtij parashikimi ligjor është se me anë të tyre i jepet mundësia kreditorit për të realizuar më shpejt në kohë të drejtën e tij.

për dëmet kontraktore dhe jashtëkontraktore është e parashikuar në institutin e shkaktimit të dëmit, që është një nga institutet me më shumë problematika të paezauruara në të drejtën civile dhe që haset shumë shpesh në praktikën gjyqësore. Sanksionimi i kësaj marrëdhënieje juridike parashikohet në nenin 608 të Kodit Civil, sipas të cilit një person që në mënyrë të paligjshme dhe me faj i shkakton një tjetri ose pasurisë së tij një dëm, atëherë ai detyrohet të shpërblejë dëmin që ka shkaktuar. (Neni 608, Kodi Civil i RSH-së) Në mënyrë që të konsiderohet dëm duhet që të konkurrojnë disa kushte së bashku: a) ekzistenca e dëmit; b) ekzistenca e paligjshmërisë së veprimit ose mosveprimit; c) ekzistenca e fajit; d) ekzistenca e lidhjes shkakësore midis veprimit ose mosveprimit dhe dëmit të ardhur. (Semini: 2006, 226-227) Duhet theksuar se e drejta e të dëmtuarve për të ngritur padi është e parashkrueshme, ku referuar legjislacionit në fuqi, personat e dëmtuar kanë të drejtë të ngrejne padi vetëm brenda një afati kohor prej 3 vitesh nga data e regjistrimit të bashkimit. Në praktikë hasen disa raste të veçanta për bashkimin me përthithje, referuar ligjit nr. 129/2014, në të cilin parashikohet se, nëse shoqëria përthithëse zotëron mbi 90% ose të gjithë kapitalin e shoqërisë që do të përthithet, operacioni i bashkimit mund të realizohet edhe pa miratimin e asamblesë së përgjithshme.

Procedura e kërkuar në kuadër të deklarimit në QKB përbën një pjesë kryesore të praktikës së përqëndrimit për efekt vlefshmërie. Ashtu sikurse në regjistrimin fillestar të shoqërive tregtare, QKB-ja duhet të vihet në dijeni nëpërmjet deklarimit të kompanive për ndryshimet e mundshme. Kushti ligjor i deklarimit të hapave për operacionet e përqëndrimeve bën të mundur që të kontrollohet praktika e ndjekur nga Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve të ndërmarrjeve respektive.

Fazat e sipërcituara janë të aplikueshme edhe në rastet e bashkimit të ndërmarrjeve me krijimin e një shoqërie të re, duke unifikuar praktikën e përqëndrimit mes ndërmarrjeve.

5.3.1 Zbatimi i procedurave të përqëndrimit të ndërmarrjeve nga Autoriteti i Konkurrencës

Kontrolli i përqëndrimeve është një nga instrumentat ligjorë që i mundësojnë Autoritetit të Konkurrencës të parandalojë forcimin apo rritjen e përqëndrimit në treg, duke i dhënë të drejtën të mos autorizojë apo të autorizojë me kushte realizimin e transaksioneve të shit/blerjes së aksioneve midis ndërmarrjeve, nëse këto transaksione shkaktojnë forcimin e ndjeshëm të përqëndrimit në tregun përkatës, apo kufizimin e konkurrencës efektive në treg. Neni 13 i Ligjit ndalon bashkimet, të cilat rrezikojnë të krijojnë ose forcojnë një pozitë dominuese. (Neni 13, Ligji 9121/2003) Kjo do të thotë që duhet të ketë një lidhje shkakësore ndërmjet bashkimit dhe pozitës dominuese që mund të krijohet. Kjo lidhje sigurisht që mungon në rastin kur bashkimi i ndërmarrjeve ndodh me qëllim eliminimin e falimentimit të një ndërmarrje të caktuar. Në këtë rast lejohet dhe autorizohet përqëndrimi dhe/ose bashkimi. Gjatë viteve të fundit është vënë re rritja e numrit të përqëndrimeve të njoftuara pranë Autoritetit për marrjen e autorizimit nga ana e Komisionit të Konkurrencës. Ky ndryshim vjen si pasojë e uljes së pragut të xhiros së ndërmarrjeve objekt përqëndrimi që kanë detyrimin ligjor për marrjen e autorizimit të Komisionit të Konkurrencës. Ndërkohë në kuadër të mbikqyrjes së tregut, Autoriteti i Konkurrencës pasi administron të gjithë database-in nga Qendra Kombëtare e Biznesit, fillon me nismën e tij procedurat për njoftimin e të gjitha rasteve që përmbushin kriteret ligjore për t'u autorizuar nga Komisioni i Konkurrencës, por që nuk janë njoftuar nga palët.

Procedura e regjistrimit të ndërmarrjeve kërkon që të respektohet një varg hapash për vlefshmërinë e përqëndrimit. Sidoqoftë, duhet theksuar që vendimi i Autoritetit të Konkurrencës mund të jetë në shumë raste lejues për bashkimin, sepse jo çdo bashkim mund të përbëjë përqëndrim. Për vlefshmërinë e një përqëndrimi duhen plotësuar disa kriterë ligjore, por gjithashtu në mënyrë që të ndiqet procedura duhet që palët pjesëmarrëse në përqëndrim të kenë ndjekur një seri hapash në AK në mënyrë që të procedohet nga Autoriteti për efekt të vlefshmërisë së përqëndrimit. Pra, kërkohet që të veprohet edhe nga subjektet por edhe nga autoriteti në respektim të bazës ligjore për arritjen e ushtrimit të kësaj të drejte. Paraprakisht, duhet që palët e interesuara të kryejnë veprimet e parashikuara nga ligji pastaj në varësi të plotësimit të kushteve ligjore, AK-ja procedon me veprimet e mëtejshme.

Procedura për kontrollin e përqëndrimeve në kuadër të ligjit të konkurrencës kalon në dy faza. **Faza e parë** ka në fokus njoftimet dhe dokumentacionin shoqërues. Në këtë fazë ndiqen disa hapa të caktuar, ku në fillim shoqëritë shprehin interesin për të realizuar marrëveshjen, e cila duhet të konsultohet pranë Autoritetit të Konkurrencës me anë të njoftimit. Njoftimi duhet të përmbajë të dhëna të detajuara për palët, duke u nisur nga emri dhe adresa e ndërmarrjeve, përfaqësuesit, natyra e veprimtarisë që ushtrojnë, objekti i transaksionit si dhe të dhënat financiare. Në këtë pikë është Sekretaria e Përgjithshme që konsulton palët për hapat e mëtejshëm. Nëse palët kanë *përfunduar një marrëveshje*²⁷ për bashkim, atëherë ato duhet të informojnë AK-në. Në të gjitha rastet, njoftimet duhen dorëzuar nga përfaqësuesit ligjorë të kompanive respektive. Njoftimet duhet të plotësohen sipas kërkesave të Formularit

²⁷ Referuar legjislacionit civil, me përfundim marrëveshje kuptohet rënia dakort e palëve për lidhjen e një kontrate apo çdo lloj marrëveshje që ka fuqinë e ligjit për palët. Në asnjë rast nuk duhet ngatërruar me mbarimin e kontratës, që është përcaktuar si zgjidhja e marrëveshjes, pra mbarimi i të drejtave dhe detyrimeve mes palëve pjesëmarrëse në një marrëdhënie juridike.

për Njoftimin e Përqëndrimit në Formën e Thjeshtuar sipas udhëzimit përkatës të Autoritetit. Në rastin e bashkimit apo përftimit të kontrollit, njoftimi kryhet nga blerësi, përfituesi i kontrollit; në rastin e krijimit të ndërmarrjes së përbashkët, ndërmarrjet që përftojnë kontrollin e ndërmarrjes; në rastin e publikimit të ofertës publike, nga ofertuesi. (Autoriteti i Konkurrencës, Rregullorja 165/2010) Njoftimi bëhet efektiv në datën kur kalon në sektorin përgjegjës pranë Autoritetit. Ky moment është i rëndësishëm sepse në varësi të marrëveshjes që kanë lidhur palët pjesëmarrëse në përqëndrim mund të ketë edhe kosto për efekt të hyrjes në fuqi të bashkimit. Në të gjitha rastet kur njoftimi nuk është i plotë bëhet një njoftim me shkrim nga Sekretariati për rregullimin e anës formale të kushteve të kërkuara nga AK-ja, brenda një afati kohor të arsyeshëm për plotësimin e procedurave paraprahe. Në rastet kur informacioni është i pasaktë, i paplotë ose i rremë, atëherë përbën shkak për vendosje gjobe, referuar legjislacionit të konkurrencës që është në fuqi. Si organ për kontrollin e përqëndrimeve, Autoriteti i Konkurrencës me anë të Komisionit të Konkurrencës ka të drejtën e denimit për shkeljet nga shoqëritë tregtare që abuzojnë me statusin e tyre.

Në rastin e shqyrtimit të relacionit mbi përqëndrimin e realizuar mes ndërmarrjeve “Pelikan” shpk dhe CMA CGMA Agencies Worldwide për krijimin e ndërmarrjes së pavarur CMA CGMA Albania shpk (rast i shqyrtuar në kapitullin që trajtohen përqëndrimet e ndërmarrjeve në kuadër të bashkimit), Komisioni vendos ta penalizojë me gjobë shoqërinë Pelikan shpk. (Komisioni i Konkurrencës, Vendimi 341/2014)

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të raportit dhe relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm mbi përqëndrimin e realizuar mes ndërmarrjeve Pelikan shpk dhe CMA CGMA Agencies Worldwide për krijimin e ndërmarrjes së pavarur CMA CGMA Albania shpk vëren se, Autoriteti i Konkurrencës ka marrë njoftimin për përqëndrimin me objekt krijimin e

ndërmarrjes së pavarur CMA CGMA Albania shpk, nga përfaqësuesi i shoqërive Pelikan shpk dhe CMA CGMA Agencies Worldwide. Transaksioni që realizohej krijonte një ndërmarrje të re të pavaruar CMA CGMA Albania shpk nga ndërmarrjet mëma Pelikan shpk dhe CMA CGM Agencies Worldwide, në kuptim të nenit 10/3 dhe 12 të ligjit dhe përbënte përqëndrim, që duhet të autorizohet nga Komisioni i Konkurrencës. Në këtë kuadër, ky transaksion i ishte nënshtruar procedurës së kontrollit të përqëndrimeve, të parashikuara në Kreun e IV, nenet 53-64 të ligjit dhe në “Rregulloren për Zbatimin e Procedurave të Përqëndrimit të Ndërmarrjeve”. Përqëndrimi i realizuar ishte njoftuar jashtë afatit ligjor 30 ditë të parashikuar në nenin 12 të ligjit “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, dhe në kuptim të nenit 73, pika 1, shkronja (dh) e ligjit cilësohej si shkelje e lehtë. Në bazë të tij ishte e dënueshme me gjobë deri në masën 1% të xhiros totale të vitit financiar para-ardhës. Megjithatë, njoftimi ishte bërë jashtë afatit, sjellja e palës njoftuese ka qenë bashkëpunuese për të përmbushur detyrimet ligjore si për njoftimin ashtu edhe për dhënien e informacionit në lidhje me këtë procedurë të kontrollit të përqëndrimit. Nga verifikimi në QKB rezultonte se shoqëria e re ende nuk ishte regjistruar në pritje të marrjes së autorizimit të Komisionit sipas nenit 14/1/a të ligjit dhe për këtë arsye u konkludua se nuk ka pasur efekte në treg. Për këto arsye, Komisioni vendosi një sanksion me gjobë të lehtë në vlerën 100.000 (njëqind mijë) lekë shoqërinë “Pelikan” Sh.p.k si njoftuese e përqëndrimit në krijimin e ndërmarrjes së pavarur CMA CGMA Albania Sh.p.k. të realizuar mes shoqërive “Pelikan” Sh.p.k dhe CMA CGMA Agencies Worldwide.

Faza e dytë është shqyrtimi i njoftimit, fillimi i procedurave nga Komisioni dhe afatet kohore që duhen respektuar. Fillon me informimin e Komisionit, i cili njoftohet me shkrim nga Sekretariati për fillimin e procedurës së kontrollit të përqëndrimit. Ashtu si në procedurat e

ndjekura nga Qendra Kombëtare e Biznesit, edhe në Autoritetin e Konkurrencës kusht i domosdoshëm është publikimi i fillimit të procedurës së kontrollit të përqëndrimit në faqen zyrtare të internetit të AK-së, ku akti i publikimit përmban të dhënat për palët pjesëmarrëse, formën e përqëndrimit, etj.

Publikimi i procedurës paraprake përbën një moment të rëndësishëm të rregullave të aplikueshme për efekt të hapave të ndjekura nga Komisioni i Konkurrencës, sepse referuar nenit 56 të ligjit “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, fillon afati për kryerjen e procedurës paraprake, që është 2 muaj pas ditës së konfirmimit të njoftimit. Duhet theksuar se ky afat është i aplikueshëm në rast se përqëndrimi nuk forcon pozitën dominuese në treg të shoqërive pjesëmarrëse në përqëndrim, nuk kufizon konkurrencën e tregut, dhe nuk ndikon në shkeljen e të drejtave të konsumatorëve. Në rastet kur shfaqen shenjat e përmendura, atëherë Komisioni vendos autorizimin e përqëndrimit me kushte dhe detyrime ose fillimin e procedurës së thelluar. Në këto kushte janë të zbatueshme afate të tjera, dhe konkretisht në rast se përqëndrimi shfaq shenja të tilla, atëherë në mënyrë të vendosur, rast pas rasti nga Komisioni i Konkurrencës, aplikohet njëra nga procedurat e sipërcituara. Kur aplikohet autorizimi me kushte dhe detyrime, afati i përcaktuar në pikën 1 të këtij neni shtyhet me 2 javë, nëse ndërmarrjet pjesëmarrëse angazhohen të marrin masa për eliminimin e kufizimit në mënyrë të ndjeshme të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij, në veçanti, si rezultat i shenjave të krijimit ose të forcimit të pozitës dominuese. Përveç procedurës paraprake është e aplikueshme edhe procedura e thelluar dhe konkretisht referuar ligjit “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, të ndryshuar, është Komisioni organi që vendos ta ndalojë ose jo përqëndrimin brenda një periudhe prej tre muajsh nga fillimi i procedurës së thelluar. (Neni 26, Ligji 10317/2010) Edhe në këtë rast, nëse shoqëritë pjesëmarrëse marrin masa për

eliminimin e kufizimit në mënyrë të ndjeshme të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij, në veçanti, si rezultat i shenjave të krijimit ose të forcimit të pozitës dominuese, atëherë ato kanë një afat prej dy muajsh kohë për t'i reflektuar këto ndryshime. Mungesa e komunikimit brenda këtyre afateve konsiderohet si vendim, që autorizon përqëndrimin dhe realizohet pa rezerva, me përjashtim të rasteve kur: a) afati shtyhet nga Komisioni, me pëlqimin e ndërmarrjeve njoftuese; b) afati shtyhet me kërkesën e ndërmarrjeve njoftuese. Në të gjitha variantet e aplikueshme si rrjedhojë e parashikimeve ligjore, në rast se procedurat pengohen të zbatohen nga kompanitë pjesëmarrëse, atëherë Komisioni vendos pezullimin e afateve.

Nëse vërtetohet se nga ana formale janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore të kërkuara nga AK-ja, pastaj fillojnë procedurat e vendim-marrjes. Në këtë moment, palët mund të dëgjohen nga Komisioni, ku me palë duhet theksuar se kemi të bëjmë jo vetëm me subjektet që marrin pjesë në përqëndrim por edhe me palët e treta, pra, palët e interesuara të cilat mund të jenë persona fizik / juridik që mund të preken drejtpërdrejtë nga operacioni i përqëndrimit. Legjislatori është treguar i kujdesshëm me parashikimin e kësaj procedure për efekt të vendim-marrjes së drejtë. Ekzistojnë raste ku Autoriteti i Konkurrencës nuk arrin të gjurmtojë efektet abuzuese të përqëndrimit sepse siç është trajtuar më sipër, janë raste të vështira për t'u gjurmuar për vetë natyrën e komplikuar të tregut dhe menyrën e funksionimit të tij. Komisioni në rast se konstaton nëpërmjet deklarimeve të palëve pjesëmarrëse në seancat dëgjimore të dhëna të pasakta, apo çdo lloj fshehje për veprimtarinë që ushtrojnë, atëherë mund të vendosë gjobë që mund të shkojë deri në 10% të gjiros së vitit financiar të ndërmarrjes. Për përcaktimin e masës së gjobës merren parasysh rëndësia dhe kohëzgjatja e shkeljes. Fitimi i paligjshëm i ndërmarrjeve në sajë të shkeljeve të këtij ligji, përbën masën minimale të gjobës, kur është e mundur të llogaritet ose të vlerësohet në mënyrë objektive.

(Neni 75, Ligji 9121/2003) Vendimet për autorizimin e realizimit të përkohshëm të përqëndrimit bëhen në ato raste kur Komisioni mblidhet për të marrë një vendim, i cili ka pasoja për një ose më shumë palë. Komisioni njofton me shkrim palët e përfshira në procedurë lidhur me vërejtjet që mund të kenë dhe cakton një afat kohor brenda të cilit ato mund të japin pretendimet e tyre shkresërisht ose/dhe në seancë degjimore. Kur palët nuk paraqesin ankesa as me shkrim as në seancën dëgjimore qoftë edhe me mosprezencen e tyre, atëherë Komisioni merr një vendim dhe e publikon atë. Përsa i përket vendimeve, Komisioni nxjerr këto lloj vendimesh: a) transaksioni i njoftuar nuk përbën përqëndrim; b) autorizon përqëndrimin, kur konstatohet se nuk përbën shkak abuziv; c) vendos fillimin e procedurave të thelluara të kontrollit të përqëndrimit ose autorizimin e përqëndrimit me kushte dhe detyrime, në rast se rezulton nga kontrolli i kryer se operacioni sjell forcim pozite dominuese ose kufizim të konkurrencës në treg, si dhe vendos me nismën e vet fillimin e procedurave të kontrollit të përqëndrimit, kur vërehet se përqëndrimi është kryer në shkelje të detyrimit të ndërmarrjeve për njoftim. (Autoriteti i Konkurrencës, Aktet Ligjore dhe Nënligjore në Fushën e Konkurrencës: 2014, 158) Përsa i përket publikimeve të vendimeve, këto të fundit publikohen në Buletinin Zyrtar si dhe në faqen zyrtare të internetit të Autoritetit të Konkurrencës. Në mënyrë të përmblodhur vendimet e Komisionit të Konkurrencës janë: 1) Autorizimi; 2) Autorizim me kushte; 3) Refuzim për autorizim; nga këto tre vendime që parashikon Autoriteti, një moment i rëndësishëm është ankimi ndaj vendimeve. Ankimi nuk pezullon zbatimin e vendimeve që autorizojnë përqëndrimet dhe marrjen e masave të përkohshme. Gjykata e Tiranës mund të vendosë pezullimin, tërësisht ose pjesërisht, të këtyre masave. Në rast urgjence, për shkak të rrezikut të ardhjes së një dëmi të rëndë dhe të pariparueshëm për konkurrencën dhe kur ka të ngjarë të ketë shkelje të neneve 4 dhe 9 të

ligjit, Komisioni, me nismën e tij, ose në bazë të një kërkesë nga palët e interesuara, në çdo kohë të procedurës, mund të vendosë marrjen e masave të përkohshme, të përcaktuara në nenin 61. Vendimi në mbështetje të pikës 1 të këtij neni, merret për një kohë të caktuar dhe mund të shtyhet në rast nevojë. (Neni 44, Procedurat për Marrëveshjet dhe për Abuzimin e Pozitës Dominuese: 2014, 25)

5.4 Rregullat e aplikueshme në të drejtën e BE-së për kontrollin e procedurave të përqëndrimeve

Një përqëndrim në dimension europian i ushtruar nga shoqëritë tregtare që kërkojnë të kryejnë këtë operacion, legjislacioni parashikon se duhet të njoftohet Komisioni përpara implementimit të tij. Fokusi kryesor i kontrollit të përqëndrimeve ka të bëjë me pasojat potenciale konkurruese që mund të dalin si rezultat i rritjes së pozitës dominuese në një treg të caktuar, pozitë e shkaktuar nga një përqëndrim. (Rodger & MacCulloch: 2008, 275-277)

Marrëveshja, shpallja e ofertës publike, apo përvetësimi i një interesi kontrollues, kërkon që të kryhet procedura paraprake në kushtet kur ndërmarrjet kanë një problematikë reale. Këto shoqëri duhet që të demonstrojnë pranë Komisionit një qëllim jo abuziv në kuadër të operacionit, në mënyrë që të përfundojnë një marrëveshje të tillë. Në rastin e një oferte publike, kur ata kanë njoftuar publikisht autoritetet dhe kanë bërë të qartë synimin për të bërë të tilla përpjekje, Komisioni e merr në shqyrtim nëse marrëveshja ose oferta do të rezultonte në një përqëndrim me dimension Komunitar. Fazat në të cilat kalon procedura e operacionit të përqëndrimit në legjislacionin europian është e ngjashme me atë shqiptar, për arsye se në kuadër të MSA-së dhe gjithë marrëveshjeve që ka Shqipëria me BE-në ka nisur përafrimi i legjislacionit me “Acquis Communautaire” për integrimin në familjen europiane.

Komisioni ka detyrimin që të publikojë njoftimet e ndërmarrjeve të interesuara, të cilat duhet të përfshihen në kuadrin ligjor të rregullores. (Neni 4, Rregullorja 139/2004) Qëllimi i këtij njoftimi është që të përshkruajë në mënyrë të përgjithshme arsyetimin themelor të rastit të referimit në nenin 4/4 dhe 5, Neni 9 dhe Neni 22 i Rregullores së Këshillit KE Nr. 139/2004 të 20 Janarit 2004 “Mbi Kontrollin e Përqëndrimeve ndërmjet Ndërmarrjeve” duke përfshirë edhe ndryshimet e fundit të bëra në sistemin evropian të konkurrencës, në kriteret ligjore që duhen përmbushur në mënyrë që referimi në Komision të jetë i pranueshëm, dhe për të përcaktuar faktorët që mund të merren në konsideratë. Njoftimi, gjithashtu ofron udhëzime praktike në lidhje me mekanizmin e sistemit të referimit, në veçanti në lidhje me mekanizmin e referimit para njoftimit të parashikuar në nenin 4/4 dhe 5 të Rregullores së BE-së. Udhëzimet e dhëna në këtë njoftim zbatohen, me rregullat e referimit të përfshira në *HEE - Hapësira Ekonomike Europiane*²⁸ (EEA).

Njoftimi në fjalë duhet që të përmbajë gjeneralitetet e palëve pjesëmarrëse si dhe të gjithë informacionin e nevojshëm për ndërmarrjet por pa dhënë informacion që mund të rezultojë sekret tregtar duke ruajtur kështu edhe parimin e konfidencialitetit. Gjobat mund të vendosen për të parandaluar dhënien e informacionit të pasaktë ose mashtrues në një njoftim për përqëndrim. (Whish & Bailey: 2012, 890-891) Komisioni ka për detyrë të transmetojë parashtrimet e njoftimit tek të gjithë shtetet anëtare. Shtetet anëtare brenda 15 ditëve nga marrja e njoftimit, shprehin pajtimin e tyre ose mosdakortësinë në lidhje me kërkesën për kalimin e operacionit të përqëndrimit. Në rast se një shtet anëtar nuk merr vendim brenda

²⁸ Hapësira Ekonomike Europiane – European Economic Area, parashikon levizjen e lirë të personave, mallrave, shërbimeve dhe kapitalit brenda tregut të brendshëm të Bashkimit Evropian (BE-së) në mes 28 shteteve anëtare të saj, si dhe tre nga katër shtetet anëtare të Shoqatës së Tregtisë së Lirë Europiane (EFTA): Islanda, Lihtenshtajni dhe Norvegjia.

kësaj periudhe, ai do të konsiderohet se ka shprehur dakortësinë e fuzionit të shoqërive tregtare pjesëmarrëse. Përveç në rastet kur shteti anëtar nuk pajtohet, Komisioni e konsideron se ekziston një treg i tillë i veçantë, ku konkurrenca mund të ndikohet në mënyrë të konsiderueshme nga përqëndrimi, atëherë mund të vendosë për t'iu referuar autoritetit kompetent të atij shteti anëtar për efekt të zbatimit të ligjit të brendshëm për mbrojtjen e konkurrencës efektive. (Weber, Tarba, Öberg: 2014, 264) Pas analizës së njoftimit, komisioni ka të drejtë në rast se nuk plotësohen kushtet e rregullores 802/2004, të kthejë mbrapsht aplikimin për rregullimin nga ana formale. (Neni 4, Rregullorja 802/2004) Një moment i rëndësishëm në procedurën e BE-së për përqëndrimet është xhiroja vjetore e ndërmarrjeve pjesëmarrëse.

Juridiksioni i komunitetit në fushën e kontrollit të përqëndrimeve përcaktohet me aplikimin lidhur me xhiron e shoqërive të interesuara. Kriteret e përfshira në nenin 1 pika (2) dhe pika (3) të Rregullores për Bashkimet. Kur kanë të bëjnë me përqëndrimet, Komisioni dhe shtetet anëtare nuk kanë juridiksion të harmonizuar. Përkundrazi, Rregullorja e Bashkimeve përcakton një ndarje të qartë të kompetencave. Përqëndrimet me një "Dimension Komunitar", dmth ata mbi pragjet e xhiros në nenin 1 të Rregullores për Bashkimet, bien në juridiksionin ekskluziv të Komisionit; Shtetet Anëtare përjashtohen nga zbatimi i ligjit kombëtar të konkurrencës për përqëndrimet, në bazë të nenit 21 të Rregullores. Në këto raste bëhet fjalë për përqëndrimet që bien nën pragjet e përcaktuara për efekt të xhiros, të cilat mbeten në kompetencë të shteteve anëtare. Komisioni nuk ka juridiksion për t'u marrë me ta në bazë të Rregullores.

Pragu i parë: Sipas nenit 1 (par. 2) të rregullores: një përqëndrim ka një përmasë europiane kur xhiroja botërore e ndërmarrjeve të interesuara i tejkalon 5 miliardë euro dhe xhiroja

europiane individuale për të paktën dy prej ndërmarrjeve pjesëmarrëse i tejkalon 250 milion euro. Rregullorja bën gjithashtu një përjashtim, pasi kërkon që ndërmarrja veçmas të mos realizojë më shumë se 2/3 e xhiros totale në Bashkimin Evropian në brendësi të një shteti të vetëm.

Pragu i dytë: Sipas nenit 1 (par. 3) të rregullores: një përqëndrim ka përmasë europiane dhe nëse xhiroja botërore e ndërmarrjeve të interesuara është më shumë se 2.5 miliard euro apo kur xhiroja totale e ndërmarrjeve të interesuara në secilin prej tre shteteve anëtare është mbi 100 milion euro si dhe kur xhiroja totale e realizuar individualisht nga së paku dy prej ndërmarrjeve të interesuara në secilin prej tre shteteve anëtare është më e lartë se 25 milion euro dhe xhiro totale individuale e realizuar në BE nga së paku dy ndërmarrje të interesuara është më e lartë se 100 milion euro. Rregullorja bën edhe në këtë rast një përjashtim, pasi kërkon që ndërmarrja veçmas të mos realizojë më shumë se 2/3 e xhiros totale në BE në brendësi të një shteti të vetëm. (Benacchio: 2010, 485)

Për të arritur tek krahasimi i realitetit që paraqet operacioni i synuar i përqëndrimit mes ndërmarrjeve të interesuara dhe pragjeve të parashikuara në rregulloren e BE-së, duhet bërë llogaritja e xhiros së tyre. (Nourissat: 2012, 349)

Një kontroll i hollësishëm i bëhet ndërmarrjeve nga organet kompetente për të gjithë aktivitetin tregtar, duke ushtruar kontroll për taksat dhe tatimet. Llogaritja e xhiros për ndërmarrjet e veçanta bëhet duke llogaritur xhiron totale që përbëhet nga shuma e përftuar nga ndërmarrjet pjesëmarrëse prej shitjes së produkteve në të gjithë veprimtarinë e zakonshme të ndërmarrjeve gjatë vitit financiar para-ardhës pas zbritjes së tatimeve, taksave dhe tarifave të tjera që lidhen drejtpërdrejtë me xhiron e ndërmarrjeve. (Raganelli: 2006, 412)

Ndërsa për ndërmarrjet që janë pjesë e një grupi, Komisioni merr në konsideratë xhiron në

mënyrat e tjera duke aplikuar procedura të veçanta. (EU Competition Law Rules Applicable to Merger Control: 2010, 155)

Në bazë të ligjit, Komisionit i janë dhënë pushtete të gjëra hetimi. Përveç të drejtës për të kërkuar informacion nga ndërmarrjet që marrin pjesë në operacionin e përqëndrimit, në bazë të nenit 14, Komisioni mund të kryejë hetime në vend. Në nenin 13 parashikohet edhe gjobvënia në rast të shkeljeve të konstatuara. Komisioni referuar ligjit material ka dy faza për hetimin e përqëndrimeve të njoftuara. Në fazën e parë Komisioni kryen një hetim paraprak dhe mund të vendosë nëse një përqëndrim del jashtë Rregullores ose është brenda qëllimit të saj por nuk përputhet me tregun e brendshëm, dhe në këtë moment fillojnë procedimet. Normalisht keto vendime duhen marrë brenda 25 ditëve pune nga njoftimi; sipas nenit 10 pika (1). Ligji parashikon dispozita edhe për rastet e tjera të ndryshme nga ata të sipërcituara. Faza e dytë e hetimit aplikohet tek përqëndrimet ku hasen dyshime mbi përputhshmërinë e tyre me tregun e brendshëm, ku Komisionit i paraqiten disa opsione, të renditura në nenin 8 të Rregullores. Në këto kushte nga organi në fjalë mund të vendoset nëse përqëndrimi apo ndërmarrja e përbashkët përqëndruese nuk thyen kriteret thelbësore me të cilën gjykohen këto çështje sipas ndryshimeve të mundshme nga ndërmarrjet që janë palë në operacionin e përqëndrimit. Në këtë rast mund të vendoset nëse përqëndrimi nuk është në përputhje me tregun e brendshëm, sepse bëhet shkak për pengesën e konkurrencës efektive në Komunitetin European, dhe specifikisht duke krijuar apo forcuar një pozitë dominuese, apo sepse një ndërmarrje e përbashkët përqëndruese nuk do të përfitojë nga neni 101 pika 3. (Neni 101, Traktati i Bashkimit European)

Në kushtet e përmendura më lart, vihet theksi tek përqëndrimet brenda objektit të Rregullores, në mënyrë që të vlerësohet në përputhje me objektivat e saj dhe dispozitat që

trajtojnë këto lloj operacionesh, me qëllimin e krijimit të saj, nëse janë apo jo në përputhje me tregun e përbashkët. Në marrjen e këtij vlerësimi, Komisioni duhet të marrë në konsideratë;

a) Nevojën për të ruajtur dhe zhvilluar konkurrencën efektive brenda tregut të përbashkët në funksion të legjislacionit në fuqi, ndër të tjera, konkurrenca potenciale nga ndërmarrjet e vendosura brenda apo jashtë Komunitetit në strukturën e të gjitha tregjeve, që mund të prekë përqëndrimi respektiv;

b) Pozicionin në treg të ndërmarrjeve pjesëmarrëse dhe fuqinë e tyre ekonomike dhe financiare, alternativat në dispozicion të furnizuesit dhe përdoruesit, qasjen e tyre në tregje, çdo pengesë ligjore apo të tjera të hyrjes, furnizimin dhe trendet e kërkesës për mallra dhe shërbime përkatëse, interesat e konsumatorëve, dhe zhvillimin e progresit teknik dhe ekonomik me kusht që kjo të jetë në avantazhin e konsumatorëve dhe të mos formojë një pengesë për konkurrencën e ndershme.

Në varësi të plotësimit të kushteve dhe kritereve ligjore, Komisioni vendos nëse duhet ta shpallë përqëndrimin të përputhshëm me tregun e brendshëm ose jo. Duke u nisur nga praktika e ndjekur, organi në fjalë e referon përqëndrimin e kërkuar në shtetin anëtar duke e vënë në dijeni për operacionin. (Durand: European Competition Law Annual, Hart Publishing 2007) Kështu, pasi të përcaktohet tregu përkatës në terma gjeografikë dhe të prodhimit, do të vendoset nëse ka një pozitë dominuese që është krijuar apo forcuar nga përqëndrimi, ku në të gjitha rastet duhet të ketë një lidhje shkakësore ndërmjet krijimit dhe forcimit të pozitës dominuese dhe ndikimit mbi konkurrencën e lirë.

Prova për të vendosur nëse një përqëndrim është i pajtueshëm me tregun e brendshëm duhet gjetur në dispozitat e Rregullores 139/2004. Një përqëndrim që nuk e pengon në mënyrë

absolute konkurrencën efektive në tregun e brendshëm apo në një pjesë të madhe të tij, do të konsiderohet i pajtueshëm me tregun e brendshëm, dhe e anasjellta për rastet kur do të deklarohet i papajtueshëm me tregun e brendshëm. Pra, qasja e përdorur në rastet e analizuara më sipër trajton në mënyrë konkrete përqëndrimet të cilat ndalohen nëse pengojnë në mënyrë të ndjeshme konkurrencën efektive, edhe nëse nuk krijon apo forcon pozitën dominuese. Ky përbën kriter thelbësor pas njoftimit të Komisionit për operacionin konkret.

Në vijimësi të trajtimit të bërë më sipër po e sqarojmë me një shembull sesi zhvillohet një përqëndrim duke iu referuar praktikës. Në çështjen IV/M57 lidhur me përqëndrimin ndërmjet Pajisjeve Dixhitale Ndërkombëtare (Digital Equipment International) dhe Mannesman Kienzle GmbH 1992/4 CMLR, paraqitet një vendim i praktikës së ndjekur nga Komisioni për rastet e sipërcituara. Një furnizues në pronësi të plotë të korporatës së Pajisjeve Dixhitale (Digital Equipment Corporation – DEC) lidhi një marrëveshje me Mannesman Kienzle – (MK) për të vendosur një ortakëri të kufizuar sipas ligjit gjerman për Digital/Keinzle, një shoqëri që do të ndante kuotat e aksionarëve në 65% nga DEIL dhe 35% nga MK. Ndërmarrja e re e përfutur kërkonte të blinte shoqërinë e MK-së, ku kjo e fundit pas transaksionit duhej të tërhiqej nga objekti i biznesit të mëparshëm për shitjen e kompjuterave, duke shprehur dakortësinë që të mos konkurronte me ndërmarrjen e re Digital/Keinzle. DEC kishte një pozitë në treg që nuk e kalonte kufirin e 10%-it. Në këto kushte, përqëndrimi i propozuar nuk ngrinte dyshime serioze mbi përputhshmërinë e tij me tregun e brendshëm, pavarësisht se DEC ishte një nga furnizuesit më të mëdhenj në rang global për sistemet kompjuterike të lidhura në rrjet, por MK ishte shumë më e vogël. Ky përqëndrim u miratua referuar nenit 6(1)(b) të Rregullores.

Në një rast tjetër u ndalua përqëndrimi mes Deutsche Boerse AG dhe NYSE Euronext, për të krijuar bursën më të madhe të botës me arsyetimin, se ky përqëndrim do të dëmtonte konkurrencën. Komisioni Europian u shpreh se marrëveshja do të kishte krijuar një kuazi-monopol në fushën e derivativëve europiane që tregtohen në bursë. Çfarëdoj kursimesh që do të mundësoheshin, nuk do të ishin të mjaftueshme për të balancuar dëmin që do t'i shkaktonte konsumatorëve. Pas këtij vendimi, bursat u shprehën se do të fokusohen në ndjekjen e strategjive individuale dhe po negocionin që të ndërprisnin përqëndrimin, pa e apeluar çështjen në Gjykatë. Deutsche Boerse dhe NYSE Euronext apelian tek Presidenti i Komisionit Europian për të shpëtuar përqëndrimin duke argumentuar se ndalimi do të dëmtonte bursat europiane dhe do të nxiste bizneset të largoheshin për në vende të tjera të botës.

Komisioni u shpreh se marrëveshja u bllokua për të mbrojtur ekonominë europiane nga efektet negative të një kombinimi i cili praktikisht do të kishte eliminuar konkurrencën efektive në treg. Shoqata e Tregjeve Financiare në Europë që përfaqëson huadhënësit dhe ndërmjetësit financiarë, duke përfshirë Goldman Sachs Group Inc., Bank of America Corp., Deutsche Bank AG dhe UBS AG, u shpreh se rregullatorët europianë morën vendimin e duhur, sepse shqetësimet për konkurrencën ishin më të larta se benefitet potenciale që mund të lindnin nga përqëndrimi. Në fakt kishte probleme të rëndësishme në kuadër të ligjit antitrust mbi normat e interesit europian, mbi aksione europiane dhe indekset e aksioneve europiane. CME Group Inc., pronar i bursës më të madhe të botës, ofronte shumë pak rivalitet për Deutsche Boerse dhe NYSE konkretisht për këto derivativë. Blerja nga Deutsche Boerse e NYSE Euronext do të kishte vendosur 90% të tregut të derivativëve të Europës dhe rreth 30% të tregtimit të aksioneve në duart e një kompanie të vetme. Edhe në një rast tjetër BE

hodhi poshtë zyrtarisht blerjen e planifikuar për një vlerë prej 42 miliardë USD të Honeywell International Inc. nga General Electric Co., çka përbënte herën e parë që një përqëndrim i propozuar mes dy kompanive amerikane u bllokua vetëm prej rregullatorëve europianë. Zyrtarë të BE-së u shprehën, se përqëndrimi mes GE dhe Honeywell do të kishte pakësuar në mënyrë drastike konkurrencën në industrinë e aviacionit dhe do të kishte rezultuar përfundimisht në çmime më të larta për klientët, veçanërisht për linjat e aviacionit. Më tej, kompanitë nuk i ndërmorën hapat e nevojshme për të adresuar çështjet e ngritura nga Komisioni. GE, konglomerati më i madh në botë, ofroi të shiste asete të veta me të ardhura vjetore në vlerë prej 2.2 miliardë dollarë në mënyrë që të siguronte aprovimin nga BE-ja dhe u shpreh se vendimi i BE-së ishte zhgënjyes. Sipas tyre, blerja do të kishte shkuar në të mirë të konsumatorëve, në terma të cilësisë, shërbimit dhe çmimeve. Rregullatorët në SHBA nga ana e tyre, e kishin miratuar blerjen, me disa kushte të një rëndësie të vogël. Por përfaqësuesit e BE-së ishin të shqetësuar që pushteti i GE-së në tregun e produkteve dhe paisjeve aerospaciale do të ishte antikonkurrues. Analistë nga bota e financës u shprehën, se ky rast i bllokuar nga BE-ja tregonte dallimin mes rregullatorëve në SHBA dhe BE, duke vendosur një precedent interesant në këtë aspekt. Duket se për SHBA-në në trajtimin e rasteve me rëndësi të madhe, bëjnë pjesë impaktet që ka një përqëndrim tek konsumatorët, ndërkohë që BE-ja duket se fokusohet më shumë në shqetësimet e konkurrentëve (operatorët). Pati edhe reagime nga zyrtarë amerikanë dhe anëtarë të Kongresit, të cilët kritikuan veprimet e BE-së lidhur me këtë rast dhe kërkuan dëgjime në Kongres, dhe masa për t'u "hakmarrë" ndaj BE-së.

Në një rast tjetër Komisioni pengoi blerjen nga Airtours plc të First Choice Holidays plc²⁵⁷. Përqëndrimi i propozuar u konsiderua se ndikonte ofertën e paketave të udhëtimeve jashtë të

rezidentëve në Mbretërinë e Bashkuar dhe veçanërisht, ato lloj paketa udhëtimesh, të cilat bëhen në rrugë ajrore për në destinacione me distancë të shkurtër, në zonën kontinentale ose ishullore në Europën Jugore dhe Afrikën Veriore. (Marrë nga: <http://europa.eu>) Struktura e tregut ishte që atëherë shumë e përqëndruar, me katër kompani të integruara vertikalisht të cilat ndanin në mes tyre rreth 80% të tregut të operatorëve turistikë për destinacione me distancë të shkurtër. Pjesa tjetër e tregut ishte e fragmentuar mes një numri të madh aktorësh më të vegjël në treg, ku asnjëri prej tyre nuk ishte i integruar plotësisht dhe shumica me përqindje tregu më të vogël se 1%. Blerja e First Choice do të krijonte një strukturë tregu në të cilin tre kompanitë e mbetura të integruara vertikalisht do të kishin bashkarisht një pozicion dominues, duke qenë se First Choice do të zhdukej qoftë si konkurrues me të drejtat e veta ashtu edhe si ofrues i vendeve në linjat e aviacionit “charter” dhe “distribution” për agjenci udhëtimesh për tek operatorët e pintegruar. Airtours dorëzoi një paketë të rishikuar të sipërmarrjeve tek Komisioni, por ajo nuk u mor në konsideratë, sepse u dorëzua jashtë afatit dhe duke pasur parasysh afatet ligjore për një vendim përfundimtar, koha për vlerësimin dhe konsultimin e paketës së re ishte e pamjaftueshme. Gjithashtu, nuk ishte e qartë nëse sipërmarrjet e rishikuara do të parandalonin krijimin e një pozicioni dominues. Prandaj, Komisioni vendosi që të mos e konsideronte paketën e rishikuar.

BE-ja, gjithashtu, ndaloi krijimin e një joint venture të planifikuar mes Bertelsmann AG, Taurus Beteiligungs GmbH & Co. KG (Kirch-Group) dhe Deutsche Bundespost Telekom²⁵⁸. Komisioni konsideroi se kompania që do të krijohet, Media Service GmbH (MSG), do të ishte një joint venture e përqëndruar sipas nenit 3 të Rregullores së Përqëndrimeve. Përqëndrimi do të plotësonte kriterin e të pasurit një efekt në nivel europian dhe do të tejkalonte pragun e shitjeve prej më shumë se 5 miliardë euro. Kompania e

planifikuar do të jepte shërbime administrative dhe teknike për prodhuesit e televizioneve dixhitale me pagesë. Komisioni u shpreh se përsa i përket legjislacionit të konkurrencës, kompania do të merrte pozicioni lideri në treg ose do të forconte pozicionin e liderit në tre tregje. Komisioni vendosi që kishte shumë pak gjasa që konkurrentë të rinj do ta kishin të mundur të hynin në treg për shkak të pozicionit dominues të Telekom në rrjetin e televizioneve kablllore dhe përfshirjen e Bertelsmann dhe Kirch-Group në stacionin e televizionit me pagesë “Premiere” dhe gjithashtu në burimet e tij të gjera. Komisioni e konsideroi tregun e televizionit me pagesë si një treg autonom dhe besonte që kjo do të krijonte ose forconte gjithashtu pozicionin e liderit në treg të Bertelsmann dhe Kirch-Group. Më tej, Komisioni e konsideroi pozicionin e asokohshëm të mbajtur nga dy kompanitë të cilat bashkë me Canal Plus mbanin stacionin e vetëm televiziv me pagesë dhe burime të kufizuara programesh, si avantazh konkurrues i konsiderueshëm në tregun në rritje të televizionit me pagesë. Gjithashtu Komisioni besoi që përqëndrimi gjithashtu do të përforconte pozicionin dominues të Telekomit në tregjet e televizioneve kablllore. Pritej që pas derregullimit të planifikuar të shërbimeve bazike të telefonisë, edhe tregu i televizioneve do të derregullohej. MSG do të mund të shërbente vetëm për përforcimin e pozicionit të atëhershëm dominues në treg të Telekom. Komisioni edhe njëherë iu referua burimeve të programeve të kontrolluara nga Bertelsmann dhe Kirch dhe e pa këtë si një pengesë për konkurrencën e lirë në të ardhmen. (European Commission. Mergers: Commission prohibits Ryanair's proposed takeover of Aer Lingus, 27 Shkurt 2013)

Palët që janë pjesëmarrëse në përqëndrim kërkohet që në njoftimin e tyre të ofrojnë detajet e kontaktit për klientët kryesorë, furnizuesit dhe konkurrentët. Komisioni i publikon këto për palët e treta, përmes kërkesave me shkrim për informacion për të kërkuar komentet e tyre në

javët e para pas njoftimit. Përveç kësaj, një botim i shkurtër në Gazetën Zyrtare të Komunitetet Evropian do të ftojë të tretët dhe palët e interesuara të paraqesin vërejtje me shkrim brenda 10 ditëve nga publikimi. Hetimi i Komisionit bashkëngjit të dhënat e marra nga palët e treta. Nuk ka procedurë formale të ankesave për palët e treta, kështu që kanë mundësi të mjaftueshme gjatë fazës së parë dhe fazes së dytë për të bërë të njohur pikëpamjet e tyre. Është mjaft e zakonshme për palët treta të paraqesin parashtrës të hollësishme me shkrim, dhe zyrtarët e Komisionit janë përgjithësisht të gatshëm të takohen me ankuesit. Praktikën e fundit të Komisionit madje ofrojnë për të ashtuquajturin "trekëndësh", takime ndërmjet stafit të Komisionit, palëve njoftuese, dhe ankuesit, edhe pse takime të tilla janë në përgjithësi të rralla. Ankuesit mund të dedikojnë burimet e nevojshme duke luajtur një rol të rëndësishëm në procedurat e legjislacionit të Bashkimit Evropian. Palët e interesuara mund të kërkojnë të marrin pjesë në ndonjë seancë dëgjimore që mund të jetë e organizuar në fazën 2 të përqendrimit. Ata, për këtë qëllim mund të kenë qasje në një version të redaktuar të Deklaratës së Kundërshtimeve të Komisionit, gjithashtu mund t'u kërkojë të komentojnë për ndonjë nga mjetet juridike të propozuara nga palët njoftuese për përqendrim. Ndryshe nga palët e njoftuara, palët e treta nuk kanë të drejtë për akses në dosjen e çështjes në shqyrtim nga Komisioni. Një përjashtim vlen për shitësin dhe kompaninë e synuar për t'u përqëndruar (target company), të cilat mund të jenë të rëndësishme sidomos në rast të ofertave të pafavorshme (hostile bids). (Marrë nga: <https://clearygottlieb.com>)

Detyrimi kryesor i ankuesve që është i përcaktuar si barrë prove është fakti se ato duhet të tregojnë nëse një vendim ka pasoja ligjore, dhe se nga ky vendim ata janë prekur individualisht në mënyrë direkte. Vendimet e Komisionit sipas Rregullores janë të

rishikueshme nga Gjykatat Komunitare. Kryesisht çështjet e trajtuara nga gjykatat kanë pasur një natyrë ekonomike më shumë sesa juridike. (Scano: 2006, 49)

Referuar rregullave të përcaktuara nga baza ligjore dhe praktikat e ndjekura në kuadër të vendimeve gjyqësore të gjykatave kompetente, Komisioni vendos nëse një operacion përqëndrimi duhet lejuar ose duhet refuzuar, duke i lënë ndërmarrjet e interesuara në gjendjen e mëparshme, apo kur përbëjnë një shkak abuziv veprimet e ndërmarra, t'i caktojë penalitetet e parashikuara në legjilacionin në fuqi.

5.4.1 Aksionarët e pakicës si subjekte të shqyrtimit në Rregulloren e Përqëndrimeve të Bashkimit European

Një aksionar në minorancë do të konsiderohet "kontrollues" në kuptimin e pushtetit që ka në vendim-marrje, dhe meqënëse gëzon këtë status, potencialisht subjekti vendim-marrës do t'i nënshtrohet një shqyrtimi në bazë të Rregullores 139/2004 të Bashkimit European, në qoftë se ajo i jep blerësit mundësinë të ketë "ndikim vendimtar" mbi sjelljen strategjike të synuar të kompanisë.

Ky mund të jetë rasti në tre situata: së pari, "kushtet pozitive" që kanë në fokus kontrollin e vetëm. Situata e parë, referuar nga Komisioni si kontrolli "pozitiv" i vetëm, lind kur një aksionar pakice i mundëson blerësit për të përcaktuar në mënyrë të njëanshme sjelljen strategjike të kompanisë së synuar. Ky mund të jetë rasti nëse një aksionar në minorancë nëpërmjet aksioneve preferenciale ose të drejtave të veçanta të akorduara, mund të ushtrojë të drejtën e votës ose ka fuqinë për të emëruar më shumë se gjysmën e anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës ose Bordit Administrativ. (Commission Notice under Council Regulation (EC) 139/2004, 2008 OJ C95, paras. 54 and 56)

Së dyti, "kushtet negative" ku paraqitet situata përsëri me kontroll të vetëm. Situata e dytë, i referohet kontrollit "negativ" të vetëm, i cili krijohet kur një aksionar i pakicës që nuk është në gjendje të përcaktojë vetë vendimet strategjike, por megjithatë është në gjendje të bllokojë miratimin e vendimeve të tilla. Një situatë tipike e këtij lloji ndodh kur një aksionar zotëron 50% të aksioneve, ndërsa pjesa e mbetur prej 50% mbahen nga një numër i vogël i aksionarëve të tjerë, ose kur një *maxhorancë e kualifikuar*²⁹ është e nevojshme për miratimin e vendimeve strategjike që mund të arrihen vetëm në qoftë se aksionari i pakicës përdor veton.

Së treti është situata e kontrollit të përbashkët, i cili realizohet kur dy ose më shumë aksionarë të një kompanie duhet të arrijnë marrëveshje për vendimet e rëndësishme në lidhje me kompaninë në të cilën kanë pronësi, veçanërisht për shkak se secili prej tyre mund të vendosë veton ndaj vendimit. Dallimi kryesor për kontrollin "negativ" të vetëm është se dy ose më shumë aksionarë kanë kompetencat përkatëse të vetos të cilat mund të çojnë në situatat e mundshme të bllokimit. (Einar & Maeleng: 2005, 254-256)

5.5 Konkluzion

Përsa i përket Rregullores për operacionet e përqëndrimeve, parashikohen dispozita shumë më të hollësishme sesa ligji jonë për të drejtën e konkurrencës. Dispozitat e sofistikuara që janë të parashikuara në ligjin material të BE-së për operacionet e përqëndrimeve synojnë që të bëhet një hetim i plotë dhe i thellë jo vetëm nga instancat e BE-së, por edhe në nivel

²⁹ Termi i maxhorancës së kualifikuar është i përdorshëm në rastet e votimeve për vendimet strategjike që kërkojnë një numër votash që e tejkalon 50%-in në mënyrë të konsiderueshme në shoqëritë aksionere, të cilat kanë në përbërje të tyre aksionarë të minorancës. Këto lloj sistemesh nuk gjejnë shumë aplikim në shoqëritë tregtare shqiptare për shkak të strukturës së kompanive që operojnë në tregun e brendshëm shqiptar.

shtetëror / kombëtar. Në mënyrë thelbësore, Rregullorja përfshin zgjedhje të rëndësishme ekonomike dhe politike, nga implementimi i mbrojtjes së efikasitetit duke përjashtuar në tërësi konsideratat “incognito” që i adresohen apo kërkohen nga shoqëritë që janë të interesuara për shkrirje.

Proceduralisht, pasqyrohet nevoja e njoftimit të menjëhershëm në mënyrë që kontrollet komunitare të jenë efektive. Këtu mund të përmendim edhe hetimin si pjesë kryesore të procedurës. Procedurat janë krijuar në kuadër të përjasjes së vendimeve dhe politikave të biznesit në mënyrë të tillë, duke balancuar shpejtësinë e zbatimit të kompetencave komunitare. Në këtë fushë, një rol të rëndësishëm janë duke luajtur edhe gjykatat komunitare, duke u pozicionuar si aktorë kryesorë në interpretimin e Rregullores dhe shqyrtimit gjyqësor. Është e qartë se ndryshimet e legjislacioneve të brendshme të shteteve komunitare dhe politikat për zbatimin e konkurrencës efektive në Europë do të kenë pasoja të rëndësishme për ndërmarrjet që ushtrojnë veprimtari brenda hapësirës ekonomike europiane. Ndryshimet legislative të BE-së do të ndikojnë në planifikimin e procesit për bizneset dhe duhet të merren parasysh nga këshilltarët apo administratorët e kompanive përpara përfundimit të çdo transaksioni që duhet të regjistrohet. Komisioni në përcaktimin e prioritetëve vendos në qendër të procedurave zbatimin e politikave, duke marrë parasysh faktin se detyrimi i deklarimit të transaksioneve është një gur themeli i sistemit të kontrollit të bashkimit në BE për përqëndrimet e ndërmarrjeve. Në thelb, nuk mund të ketë justifikim për një shoqëri tregtare apo përfaqësuesit dhe këshilltarët e saj, deklarimi i padijenisë që transaksioni ka tejkaluar kufijtë përkatës ose që nuk e kishin kuptuar se kompania që përfaqësojnë kishte fituar kontroll de facto. Qartësisht paraqitet se, komuniteti i biznesit dhe këshilltarët e korporatave financiare duke mos përjashtuar CEO-t që veprojnë në fushën e përqëndrimeve

duhet të jenë të vetëdijsëm për kërkesat që duhen shqyrtuar në të gjitha rastet e transaksioneve të ndërmarrjeve para se të implementohet në mënyrë të përcaktuar operacioni, dhe në rast se ato përfshijnë një bashkim de facto apo blerje (përfitim kontrolli), në mënyrë subjekti të jetë në gjendje të respektojë njoftimet dhe detyrimet për shkak të qëndrimit në BE, duke aplikuar rregullat e kontrollit të bashkimit të brendshëm të shoqërive të interesuara. Zhvillimet në politikat e zbatimit të autoriteteve të konkurrencës, duke përfshirë ato europiane, kanë sanksionuar, siç përcaktohet më sipër, në mënyrë të ashpër dhe nuk duhen neglizhuar apo të mos merren në konsideratë nga praktikuesit, sidomos kur ka shpenzime ligjore dhe publicitet negativ. Sanksionet në këtë aspekt janë krijuar për të mbrojtur një procedurë të zbatimit të këtyre operacioneve nga Autoriteti i Konkurrencës për të gjithë kompanitë që janë faktorë në përqëndrim.

Po t'i referohemi legjislacionit shqiptar në lidhje me kushtet që duhet të plotësojë një fuzion për t'u marrë në shqyrtim nga Komisioni, vihet re se pragu minimal për marrjen në shqyrtim të një përqëndrimi në kuadër të xhiros vjetore duhet të jetë në një fashë më të ulët, duke marrë parasysh tregun e vogël që ofron Shqipëria për operimin e shoqërive tregtare shqiptare dhe të huaja. Kjo do sillte benefite të mëdha si në të drejtën e konkurrencës ashtu edhe në të drejtën e konsumatorit. Pavarësisht se janë ligje të ndryshme, konkurrenca ka lidhje direkte dhe të drejtpërdrejtë me të drejtën e konsumatorit duke sjellë pasoja në mënyrë direkte tek sjellja e operatorëve të tregut.

KAPITULLI VI – PROBLEMATIKAT E

PRAKTIKËS GJYQËSORE NË CIVIL LAW DHE COMMON LAW

6.1 Sistemet ligjore Civil Law dhe Common Law në kuadër të ndryshimeve thelbësore

Koncepti i stilit të të menduarit që vjen nga letërsia është përdorur prej kohësh në fushën e jurisprudencës. Në sistemet e të drejtave haset koncepti i Codex Iuris Canonici. Kanuni parashtrohet se, në qoftë se nuk ekziston një ligj i qartë dhe i shprehur, ligji që duhet të zbatohet duhet të gjendet me analogji ose të merret nga parimet e përgjithshme të së drejtës, ose nga doktrina udhëheqëse dhe e qëndrueshme, ose nga stili Curia Romane (organ kongregacionesh, gjykatash e ofiqesh përmes të cilave papa drejtonte Këshillin Katolik Roman). Po e njejta praktikë pune është e aplikueshme edhe për ndërdisiplinaritetin e shkencës juridike që është në bashkëveprim me shkencat e tjera – prandaj në këtë pikë lindin dhe diferencat – e në kuadër të faktorëve që kontribuojnë në stilin juridik të grupeve të tëra të sistemeve ligjore. (Zweigert: 2008, 99-104) Faktorët vendimtarë në përcaktimin e stilit të një sistemi ligjor janë: 1) zhvillimi historik; 2) mënyra e të menduarit mbizotëruese dhe karakteristike në çështjet ligjore; 3) institucionet veçanërisht të dallueshme; 4) lloji i burimeve ligjore që njeh sistemi respektiv dhe mënyra sesi aplikohen ato; 5) ideologjia që përshkon sistemin.

Në varësi të këtyre faktorëve u realizua me kalimin e viteve edhe ndarja e sistemeve ku ndër më kryesorët do të përmendim Civil Law dhe Common Law. Bazën, të dy këto sisteme, e kanë nga e drejta romake dhe gjermanike, por jo të gjithë sistemet e të drejtës që janë të aplikueshme në Europë dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës (për qëllim studimi janë marrë

sistemet e të drejtës vetëm në këto dy kontinente) bëjnë pjesë në të njejtën familje ligjore. Vendet që kanë adoptuar sistemin Civil Law kanë karakteristikë kodifikimin e të drejtës me norma ligjore abstrakte për të pasur një sistem shumë të artikuluar dhe për të menduar sipas konstruksioneve juridike; ky proces ka filluar me hartimin e kodeve të ndryshme (hap i ndërmarrë veçanërisht nga krijimi i Kodit Civil Francez). Situata shumë të ndryshme paraqiten në familjen ligjore anglo-saksone, e cila po të vështrohet nga ana historike shfaqet si e drejtë e çështjeve dhe jo si e drejtë që është në fuqi. Këtu, theksi vihet tek precedenti. Pra, e drejta anglo-saksone vjen nga praktika gjyqësore që vendos në qendër gjykatën, ndërsa e drejta kontinentale vjen nga teoritë dhe studimi.

Po të heqim një shenjë barazie për mënyrën e të aplikuarit të së drejtës së konkurrencës në kuadër të karakteristikave të të drejtave respektive, do të shohim se paraqiten problematika të ndryshme në këto dy sisteme. Për vetë ndryshimet që kanë sistemet, parashtrohen mënyra të ndryshme të të menduarit dhe dhënies së zgjidhjes për mosmarrëveshjet që paraqiten në gjykata. Praktika gjyqësore e Common Law ndryshon rast pas rasti nga praktika gjyqësore e BE-së. Sidoqoftë, në disa prej rregullimeve juridike, si në sistemin Common Law ashtu edhe Civil Law, ekzistenca e të drejtës subjektive kushtëzohet nga fakti nëse ekziston padia që e mbron atë, “ubi remedium, ubi ius”, “atje ku ekziston mbrojtja, ekziston dhe e drejta”. (Tërpollari: 2014, 64-65) Po përmendim faktin se pa padi nuk ka drejtësi, sepse në kushtet e operacioneve të përqëndrimeve shumë herë mund të ketë të dëmtuar nga veprimtaria e shoqërive tregtare që ushtrojnë aktivitetin e tyre, dhe në këtë pikë, të dy sistemet garantojnë mbrojtje për të dëmtuarit.

6.2 Çështje gjyqësore për operacionet e përqëndrimeve në të drejtën amerikane të konkurrencës

E drejta amerikane e konkurrencës është krijuar përpara së ky sistem i të drejtës të aplikohet në Europë. Si një ndër qendrat më të zhvilluara në rang global, SHBA-ja ka zhvilluar jo vetëm tregjet financiare, por edhe ka rritur në mënyrë të ndjeshme rregullimet ligjore në funksion të kontrollit të operacioneve të shoqërive tregtare që kërkonin të ndiqnin praktika që maksimizonin fitimin e tyre pa marrë parasysh efektet negative që mund të sillnin në tregje të caktuara, duke mos anashkaluar edhe shkaqet abuzive. Në kushte të tilla janë krijuar struktura të ndryshme për të hetuar dhe kontrolluar veprimtarinë e ndërmarrjeve që kanë si qëllim një shkak abuziv. Instanca të ndryshme kanë funksione të caktuara për të rregulluar këto premisa jo të drejta dhe për të mbrojtur konsumatorët dhe tregjet nga veprime të tilla. Që me aktet e hershme Sherman dhe Clayton, si pionerë të mbrojtjes së konkurrencës efektive, ka pasur një zhvillim pozitiv edhe legjislationi në tërësi në të drejtën e biznesit, por edhe në veçanti për përqëndrimet e ndërmarrjeve. Një nga institucionet më të rëndësishme në dhënien e drejtësisë dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve mes shoqërive tregtare dhe organeve që rregullojnë veprimtarinë e tyre, janë gjykatat. Vendimet e gjykatave janë të zbatueshme nga çdo subjekt i së drejtës. Për rrjedhojë, edhe në kushtet e ndërmarrjeve të cilat kanë mosmarrëveshje për të zgjidhur në kuadër të problematikave të ndryshme që hasin gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre ekonomike, i drejtohen gjykatave për zgjidhjen e konflikteve apo për të çuar në vend të drejtat e shkelura. Kështu, shumë problematika që nuk janë zgjidhur nga organet e institucioneve përkatëse janë dërguar në gjykatë për t'u zgjidhur. Praktikrat gjyqësore në një shtet të së drejtës së konsoliduar janë një domosdoshmeri për vazhdimësinë e progresit social politik dhe ekonomik të një vendi të caktuar. Shtetet e

Bashkuara të Amerikës kanë adoptuar dhe implementuar sistemin Common Law, dhe për rrjedhojë, vendimet e gjykatave janë shumë të rëndësishme për vetë sistemin e të drejtës, si një sistem që ka në thelb precedentin dhe jo normat e shkruara dhe të kodifikuara. Përqëndrimet e ndërmarrjeve janë praktika të cilat janë shumë të vështira për t'u zbuluar nëse kanë një shkak abuziv apo kanë ndjekur një rrugë abuzive në funksion të një qëllimi personal fitimprurës në dëm të tregut në tërësi dhe konsumatorëve në veçanti. Në vazhdim po trajtojmë një nga rastet më të ndërlikuara që ka trajtuar gjykata në SHBA. Rasti në fjalë është *Komisioni Federal i Tregtisë vs Phoebe Putney*.

Bazuar në seksionin 13 (b) të Aktit të Komisionit Federal të Tregtisë AKFT si edhe seksionin 16 të Aktit Clayton, në prill të vitit 2011 akuzuesit nisën një padi dhe paraqitën kërkesën për një urdhër kufizimi të përkohshëm për të ndaluar veprimtarinë e palës mbrojtëse, përfshirë atë të kompanive që lidhen në formë kontrolli me të (kompani mëmë dhe/ose bijë, degët etj.), sa i takon qëllimit të saj për përfitim të kontrollit mbi spitalin Palmyra Park. Pala paditëse ishte Komisioni Federal i Tregtisë, ndërsa pala mbrojtëse ishte grupi Sistemi i Shëndetit Phoebe Putney sha (përgjatë kazusit do emërtohet “Phoebe Putney”), spitali Palmyra Park dhe Autoriteti Spitalor i Qarkut Albany-Dougherty “ASQ”. Paditësit e bazuan ankesën e tyre mbi kronologjinë e ngjarjeve që do të shtjellohen më poshtë. (Case No. 1:11-cv-58 WLS)

Në korrik të vitit 2010, Joel Wernick që shërbente si CEO dhe president i kompanisë Sistemi i Shëndetit Phoebe Putney, autorizoi Robert Baudinon si konsulent dhe përfaqësues ligjor të kompanisë që të fillonte bisedimet me Autoritetin Spitalor të Qarkut Albany-Dougherty “ASQ” sa i takon blerjes së mundshme të spitalit Palmyra Park nga Spitali Memorial Phoebe Putney “SMPP”, që ishte i kontrolluar nga Phoebe Putney. ASQ kërkonte një shumë të konsiderueshme parash dhe kjo e vështirësoi gjetjen e një banke investimesh që ta justifikonte

një kërkesë të tillë. Si pasojë, Baudino erdhi me propozimin që transaksioni të strukturohej në mënyrë të atillë që Palmyra Park të blihej nga ASQ, një veprim ky që do të shmangte rrezikun e zbatimit të ligjit antitrust. Pasi Palmyra Park të merrej nën kontroll nga ASQ-ja, ky i fundit do ia lëshonte me qira Phoebe Putney-t me një çmim prej USD 1.00 për një periudhë dyzet vjeçare. Kushtet e kontratës parashikonin që Phoebe Putney do të garantonte shumën prej USD 195 milion për blerje si dhe mbulimin e penalteteve në rast se palët nuk i përmbaheshin kushteve të kontratës. Finalizimi u arrit në vitin 2011, kur Palmyra Park iu kalua me qira sipas kushteve të kontratës Phoebe Putney-t.

Duke marrë parasysh këto fakte paditësit shprehën në padi, bindjen se ASQ-ja dhe Phoebe Putney kanë strukturuar subjektin e transaksionit në mënyrë të atillë që të shmangin aplikimin rregullave të antitrust-it nga Komisioni Federal i Tregtisë nëpërmjet marrjes nën kontroll të Palmyra Parku-t nga ASQ-ja dhe dhënies me qira tek Phoebe Putney për një periudhë dyzet vjeçare. Paditësit shprehën qartazi pretendimin e tyre se kjo skemë, ku ASQ-ja ishte blerësi - por që spitali do të kontrollohej nga Phoebe Putney - e vendoste këtë të fundit në një pozicion monopoli në tregun e shërbimeve të përgjithshme akute mjekësore, pasi Palmyra Park dhe Phoebe Putney (PHMS) ishin dy spitalet kryesore që shërbenin jo vetëm në qarkun Dogherty, por edhe në gjashtë qarqet e tjera rrethuese.

Në këto kushte paditësit kërkuan ndihmën e gjykatës për pezullimin e veprimtarisë deri sa Komisioni Federal i Tregtisë të përfundonte procedurat e nisura në lidhje me vlerësimin e vlefshmërisë ligjore në lidhje me blerjen e Palmyra Parku-t. Gjithashtu, paditësit ngritën pretendimin se pala mbrojtëse nuk kishte imunitet shtetëror pasi ASQ nuk ishte përfshirë mjaftueshëm në zhvillimin e transaksionit, duke i lënë në dorë Phoebe Putney-t negocimin, strukturimin dhe zbatimin e transaksionit pa mbikqyrjen e nevojshme të ASQ-së. Pra, duke

pasur si qëllim parandalimin e dëmit ndaj konkurrencës gjatë periudhës së procesit të nisur nga Komisioni Federal i Tregtisë, paditësit gjykonin si të arsyeshëm pezullimin e transaksionit deri sa Komisioni të dilte me një vendim administrativ.

Duke u bazuar në argumentat e mësipërme, gjykata i pranoi argumentat e paditësve dhe në 2011-ën vendosi pezullimin e veprimtarisë së palës mbrojtëse. Sidoqoftë, rreth një muaj më vonë, pala mbrojtëse depozitoi kërkesën për kthimin e vendimit të pezullimit duke argumentuar se doktrina e lëvizjes shtetërore i jepte në mënyre të qartë imunitet nga ligjet e antitrust-it dhe e bënte të diskutueshme kërkesën e paditësve. Si rrjedhojë, pala mbrojtëse kerkoi heqjen e urdhërit të pezullimit të veprimtarisë meqë transaksioni përfitonte imunitet nga aplikimi antitrust-it.

Në këto kushte, gjykata u vendos para faktit se përpara se të gjykonte substancën e argumentave të palës paditëse, duhej fillimisht të përcaktonte nëse aktet ligjore të antitrust-it ishin të aplikueshme.

Në këndvështrimin e tyre, pala mbrojtëse argumentoi se (i) ASQ-ja ishte një nëndivizion shtetëror, (ii) statuti i shtetit të Georgia-s e autorizon ASQ- në të blejë spitale të tjera si pjesë të veprimtarisë së ASQ-së për të operuar, kontrolluar dhe mirëmbajtur spitalet publike dhe facilitetet përkatëse dhe se (iii) efekti antikonkurrues i aktivitetit të ASQ-së është i parashikueshëm në mënyrë të arsyeshme nga legjislacioni si rrjedhojë e të drejtës për të blerë spitale të ndryshme. Sipas palës mbrojtëse, ligji e definon qartë që ASQ vepron vetëm në qarkun e caktuar dhe për rrjedhojë është evidente që spitalet e blera nga ana e saj do të ishin konkurrues me njeri - tjetrin. (Marrë nga: <https://courtlister.com>)

Vec kësaj, mbrojtësit pretendonin se veprimet e ASQ-së, Palmyra Park dhe Phoebe Putney janë imune nga ligjet e antitrust-it, pasi sipas tyre privatët që ishin të kontraktuar nga

autoritetet shtetërore gëzonin të njejtin trajtim. Logjika e këtij pretendimi qëndronte mbi faktin se pala paditëse e konsideronte transaksionin si vepër ndërmjet privatëve – ku palët ishin Palmyra Park dhe Phoebe Putney – duke anashkaluar faktin se ASQ-ja do ishte mbikqyrëse e procesit, gjë që e kthente këtë transaksion në një të mirë publike. Pra, sipas tyre, arsyet personale të personave privatë për hyrjen në këtë transaksion bëhen irrelevante pasi nuk ka një moment specifik ku influenca e palëve private bëhet aq e madhe sa të mos aplikohet doktrina shtetërore. Fakti që ASQ-ja është e vetmja palë që do të blente Palmyra Park-un konfirmon që transaksioni është në konturat e veprimtarisë së ASQ-së dhe si rrjedhojë e përjashton transaksionin nga aplikimi i ligjeve të antitrust-it. Pra, pala mbrojtëse vë në dukje se si përfundim ASQ-ja do ishte i vetmi organ që do të kishte kontroll mbi Palmyra Park-un, si dhe do të mbante përgjegjësi për veprimtarinë e spitalit. Sipas Phoebe Putney, termat e kontratës së qirasë ndërmjet kompanisë dhe ASQ-së, ku përfshihet klauzola se kompania do të supervizohej në mënyrë të vazhdueshme nga ASQ-ja, e përjashtonte kompaninë nga aplikimi i antitrust-it.

Si kundërpërgjigje, paditësit argumentonin se përfshirja e ASQ-së në këtë rast ishte thjesht një mbulim për të arritur në një situatë që de facto do e kthente Phoebe Putney-n në një kompani monopoliste. Sa i takon ASQ-së, pala paditëse pretendonte që megjithëse ASQ-ja është një entitet shtetëror, ligji nuk e lejonte marrjen nën kontroll të vendim-marrjes së autoritetit si dhe të fuqisë supervizuese të saj nga ana e aktorëve privat për nxjerrjen e përfitimeve pa mbikqyrje nga ana e këtyre të fundit. Pra, pala paditëse ka pikëpamjen se veprimet e ASQ-së ishin në kundërshtim me të drejtat e dhëna nga ligji, pasi Phoebe Putney, dhe jo ASQ-ja, ka qenë de facto vendim-marrësi për planifikimin, ngritjen e fondeve dhe zbatimin e transaksionit. Ata e bazuan këtë argument në faktin se, ASQ-ja nuk kishte ngritur

pyetje gjatë prezantimit të transaksionit, dhe zgjidhjet e paraqitura për zhvillimin e transaksionit ishin hartuar nga Phoebe Putney, veprime këto që e përjashtonin aplikimin e imunitetit.

Në këto kushte, gjykata duhej të vendoste nëse eliminimi i konkurrencës në mënyrën e trajtuar në padi ishte një rezultat i parashikueshëm në mënyrë të arsyeshme nga veprimtaria normale e ASQ-së.

Arsyetimi i gjykatës ishte i tillë që sipas ligjit, shteti i Georgia-s i ka deleguar ASQ-së pushtetin për të blerë dhe më pas për të dhënë me qira spitale të tretëve për një periudhë jo më shumë se dyzet vjet. Gjithashtu, ligji e autorizonte ASQ-në të formonte dhe të operonte në mënyrë direkte ose indirekte një ose më shumë rrjete spitalësh. ASQ-ja duhet të operonte si një entitet non-profit.

Këto specifikime si dhe kufizimi territorial i autoritetit të ASQ-së tregonin se legjislacioni i shtetit të Georgia-s kishte si qëllim të garantonte që ASQ-ja të permblushte detyrën e vet për promovimin e shëndetit publik edhe nëse kjo veprimtari mund të ndikojë konkurrencën e tregut. Pra, gjykata arsyeton se ligji në lidhje me aktivitetin e ASQ-së inkurajon dhe madje mund të kërkojë autoritetin spitalor të bashkëpunojë me entitete private për të arritur objektivat e vendosura për shëndetin publik. Seksionet 31-7-75(4), (6), (7) dhe (27) shprehin se, detyrimi i një autoriteti spitalor është të sigurohet që njerëzit të marrin shërbimet e duhura, detyrë e cila mund të arrihet nëpërmjet blerjes së spitaleve ekzistuese, ndërtimit të spitaleve të reja si edhe nga shitja apo dhënia me qira e spitaleve të tretëve, përfshirë kompanitë private që ushtrojnë aktivitet spitalor.

Për më tepër, mungesa e një buxheti vetjak të ASQ-së si dhe ndalimi i operimit të spitaleve me përfitim nga ana e autoritetit, e bëjnë të parashikueshëm në mënyrë të arsyeshme faktin

që autoriteti spitalor do të bashkëpunonte me entitete private për të operuar në këtë sektor pa ndihmën e palëve të treta, përse i takon fondeve, resurseve dhe personelit. Autoriteti spitalor do ta kishte shumë të vështirë të operonte vetëm, çka do ta vështirësonte përmbushjen e misionit të tij. Prandaj, për sa kohë ASQ-ja përcaktonte se transaksioni i propozuar do të përmbushte në mënyrë të vazhdueshme misionin e tij për të plotësuar nevojat e shëndetit publik dhe për sa kohë ASQ-ja mbante kontrollin mbi Palmyra Park-un, ASQ-ja mund të bashkëpunonte me aktorë privat si Phoebe Putney për të ekzekutuar transaksionin e propozuar pa mbajtur përgjegjësi për ligjin antitrust. (Marrë nga: <http://scotusblog.com/>)

Gjykata arriti në përfundimin e mësipërm, pasi me gjithë pranimin e pretendimeve të palës paditëse, se transaksioni mund të jete motivuar dhe kontrolluar nga motivet personale të Phoebe Putney-t. Në këtë rast, fakti që ASQ-ja ka autorizuar blerjen e Palmyra Park-ut pa marrë në konsideratë impaktin që mund të kishte mbi konkurrencën në treg bëhet i pa rëndësishëm. Arsyeimi prevalues ishte që ASQ-ja kishte krijuar një makineri për të strukturuar dhe zbatuar transaksionin, megjithëse Phoebe Putney kishte negociuar, promovuar dhe lobuar për transaksionin. Pretendimi që shkaktohen “pasoja antikonkurruese në treg” u hodh poshtë për faktin se ASQ-ja ka kompetencë të strukturojë manaxhimin e spitaleve duke përfshirë privatin, që do të thotë se shteti i ka deleguar përgjegjësinë ASQ-së të manaxhojë sistemin shëndetësor të qarkut, edhe nëse palët private që mund të ngrejnë shqetësim për çrregullimin e konkurrencës kanë njëfarë roli në procesin e vendim-marrjes. Si përfundim, bazuar në analizën e mësipërme, gjykata vendosi se ASQ-ja ishte imune nga aplikimi i antitrust-it në rastin konkret.

Gjykata vendosi gjithashtu se imuniteti nga ligji i antitrust u aplikua edhe mbi Phoebe Putney-n pasi ajo gjykoi se veprimtaria e kundërshtuar në këtë çështje ishte në realitet e

drejtuar nga ASQ-ja dhe jo nga kompania. Ndërkohë, gjykata e pranoi faktin se kompania ka shërbyer si negociatore, garantuese dhe financuese e transaksionit. Ajo gjykoi se një veprimtari e tillë vjen si rezultat i inkurajimit për përfshirje së palës private nga ana e ASQ-së ose shërbesës së palës private si agjente e ASQ-së, çka i jepte të drejtën palës private të gëzonte imunitet nga aplikimi i antitrust-it. Për sa kohë autoriteti ishte imun, ashtu ishte edhe aktori privat që shërbente për të kryer detyrimet e ASQ-së. (Marrë nga: <https://supremecourt.gov/>)

Fakti që Phoebe Puntney kishte interes në kontrollimin e Palmyra Park-ut dhe që kishte vepruar në interesin e vet duke negociuar dhe strukturuar transaksionin nuk kishte domethënie, pasi prevalonte fakti që legjislacioni e shpreh përfshirjen e palës private me gjithë marrjen parasysh të efektit advers që mund të kishte mbi konkurrencën në treg përfshirja e aktorit privat.

Për më tepër, edhe nëse Phoebe Putney nuk do të ishte palë private e mbrojtur nga ligji, ajo mund konsiderohej si një agjente e ASQ-së sa i takon negocimit, planifikimit, financimit dhe ndihmesës së dhënë në realizimin e transaksionit. Fakti që e vërtetonte këtë ishte dokumenti i marrëveshjes së blerjes që shprehte se ASQ-ja ishte blerësi, Palmyra Park shitësi dhe Phoebe Putney garantuesi i detyrimit të ASQ-së. Kjo do të thoshte se ASQ-ja mbetej pronari i Palmyra Park-ut. Kontrata parashikonte që aktori privat do të shërbente si manaxheri operimit të përditshëm të spitalit të blerë, duke pranuar marrëveshjen se spitali do të administrohej sipas intruksioneve të ASQ-së dhe jo sipas dëshirës së kompanisë private. Kontrata e shprehte qartazi këtë duke pohuar se aktori privat do ishte përgjegjësi për ndërmarrjen e të gjitha veprimeve të nevojshme si dhe kërkesave nga ana e ASQ-së që përputhen me direktivat e ASQ-së. Për më tepër, Phoebe Putney duhej t'i përmbahej planeve për bamirësi si dhe

politikave të përkujdesjes për të varfrit dhe të asistonte ASQ-në të përmbushë detyrat e tij ligjore. Pra, shpjegimet e mësipërme tregojnë se ndërkohë që kompania private do ta merrte me qira spitalin, vendim-marrësi përfundimtar do ishte ASQ-ja dhe Phoebe Putney do ishte agjentja. Për shembull, Phoebe Putney duhet të merrte aprovimin e ASQ-së për mbajtjen e konsulentëve, financierëve ose pjesës tjetër të stafit të saj profesional ose për firmosjen e kontratave që e tejkalonin vlerën e USD 10,000. Gjithashtu kompania duhej të përgatiste dhe ti paraqiste ASQ-së buxhetin vjetor të Palmyra Park-ut për rishikim si dhe nuk duhej të bënte ndryshime në licensimin, modelin e pagesës, klasifikimin apo veprimtaritë e Palmyra Park-ut pa aprovim të nënshkruar nga ASQ-ja.

Si përfundim, për shkak se Phoebe Putney nuk do të ishte në gjendje të kontrollonte në mënyrë të pavarur veprimtarinë e Palmyra Park-ut dhe për shkak se kontrolli i atribuohet ASQ-së, gjykata vendosi se Phoebe Putney do të gëzonte imunitet nga aplikimi i antitrust-it. Duke marrë parasysh faktin se palët në këtë transaksion gëzonin imunitet sa i takon aplikimit të antitrust-it, gjykata vendosi të hiqte urdhërin e pezullimit të transaksionit, duke i dhënë të drejtë palës mbrojtëse.

6.3 Praktika gjyqësore në të drejtën e BE-së në kuadër të përqëndrimeve të ndërmarrjeve

E drejta Europiane e Konkurrencës ka pasur zhvillim shumë të rëndësishëm në këto vitet e fundit. Si pasojë e hapjes së tregut të përbashkët europian ka pasur dhe zhvillime pozitive në *acquis communautaire*. Këto ndryshime progresive kanë shfaqur edhe rezultatet e tyre në kuadër të mbrojtjes së tregjeve të brendshme por edhe komunitare si edhe mbrojtjen e të drejtave të konsumatorit.

Raste të ndëshkimit nëpërmjet gjobave për vonesë raportimi në kohë të shkrirjeve pranë autoriteteve janë trajtuar nga gjykatat europiane dhe Gjykata e Përgjithshme si instanca më e lartë e shqyrtimit gjyqësor në nivel europian.

GJP-ja, në bazë të një parregullsie procedurale, anulloi vendimin me të cilin Komisioni refuzoi të autorizonte bashkimin midis UPS dhe TNT në sektorin e shpërndarjes ekspres të paketave të vogla (shërbimet e një ndërmarrje që përfshijnë nga ofruesi i shërbimit transportin brenda ditës nga njëri vend në tjetrin).

Komisioni shkeli të drejtat e mbrojtjes së UPS duke u mbështetur në një analizë ekonometrike duke mos diskutuar formën përfundimtare gjatë procedurës administrative. Kompania amerikane United Parcel Service (UPS) dhe kompania holandeze TNT Express (TNT) operonin si specialistë në nivel global në sektorin e transportit dhe shërbimeve të logjistikës. Në Hapësiren Ekonomike Europiane, UPS dhe TNT - si dhe kompanitë e Shteteve të Bashkuara FedEx dhe kompania gjermane DHL - ishin të pranishme në tregje me shpërndarjen ndërkombëtare të paketave të vogla.

Në vitin 2012, UPS njoftoi Komisionin Europian për blerjen e propozuar të TNT-së nën rregulloren e Bashkimit. Me vendimin e datës 30 Janar 2013, Komisioni e ndaloi propozimin për blerjen e TNT-së nga UPS. Në thelb, u konsiderua se një marrje e tillë kontrolli do të ishte kufizim i konkurrencës në 15 shtete anëtare europiane për sa i përket ofrimit të shërbimit të shpejtë të paketave të vogla. Në ato shtete anëtare, blerja do të kishte zvogëluar numrin e operatorëve të rëndësishëm në atë treg duke lënë dy apo tre të tillë. Sipas Komisionit, tregu komunitar do të ishte i dëmtuar, duke shkelur të drejtat e konsumatorëve, dhe do të sillte rritjen e çmimeve. (Marrë nga: <https://curia.europa.eu>) UPS ngriti padi përpara GJP-së duke kërkuar anulimin e vendimit të Komisionit.

Gjykata vërejti se u shkel respektimi i të drejtave të mbrojtjes dhe, në veçanti, kërkoi që ndërmarrja në fjalë të ketë pasur mundësi për një seancë dëgjimi, gjatë procedurës administrative, për të bërë të njohur pikëpamjet e saj mbi të vërtetën dhe rëndësinë e fakteve dhe rrethanave të pohuara; dhe akses në dokumentat e përdorura nga Komisioni.

Gjykata konstatoi se analiza ekonometrike e përdorur nga Komisioni në vendimin e tij të datës 30 Janar 2013 u bazua në një model ekonometrik të ndryshëm nga ai që kishte qenë subjekt i një shkëmbimi të pikëpamjeve dhe argumenteve gjatë procedurës administrative. Komisioni bëri ndryshime jo të papërfillshme në analizat e diskutuara më parë me UPS. Nga këto ndryshime, Komisionit iu kërkua që të komunikonte modelin për analizën përfundimtare ekonometrike për UPS-in përpara miratimit të vendimit të kontestuar. Duke dështuar në kryerjen e kësaj procedure, Komisioni shkeli të drejtat e mbrojtjes së UPS-it.

Duke marrë parasysh se, gjatë procedurës administrative, UPS mund të kishte qenë në gjendje të mbrohej më mirë nëse do të kishte pasur në dispozicion, para miratimit të vendimit të kontestuar, versionin përfundimtar të modelit ekonometrik të zgjedhur nga Komisioni, Gjykata anuloi vendimin e 30 Janarit 2013 në tërësi, pa shqyrtuar pretendimet e tjera të parashtruara nga UPS. (General Court of the European Union, Case T-194/13 United Parcel Service, Inc. v Commission, 7 March 2017)

Rastet e mëposhtme paraqesin dy shembuj të ndëshkimeve për vonesë raportimi të shkrirjeve pranë autoriteteve përkatëse nga ana kompanive të përfshira në transaksion.

Në Hollandë, Autoriteti për Konsumatorin dhe Tregun (AKT) është instanca përkatëse për raporimin e shkrirjeve. Një rast i dokumentuar gjobe për shkak të vonesës së raportimit, është ai i shkrirjes së kompanive Sofiprotéol dhe Bunge, të cilat operonin në industrinë e farave të prodhimit të vajit. Gjjobat e vëna nga Autoriteti ishin 677,000 euro për Sofiprotéol dhe EUR

1,730,000 për grupin Bunge, të cilat rezultojnë nga transaksioni i Dhjetorit të vitit 2009, kur grupi Bunge transferoi aksionet e tija tek kompania Saipol, që ishte pjesë e grupit Sofiprotéol. Autoriteti gjykoi se ky transaksion e kalonte kontrollin e kompanisë Bunge tek Sofiprotéol dhe si pasojë kalimi duhet të ishte raportuar paraprakisht pranë AKT-së, por Sofiprotéol e kishte raportuar atë në prill të 2010-ës.

Në këtë çështje të trajtuar, AKT-ja e kishte aprovuar blerjen në maj të 2010-ës, çfarë do të thoshte se kjo shkrirje nuk do të kishte efekte mbi konkurrencën në treg, por më vonë zbuloi se palët e kishin kryer transaksionin pa ndjekjen e procedurave të nevojshme. Ky rast afirmon këndvështrimin e autoriteteve që mosdeklarimi është një shkelje që është veçanërisht e dallueshme nga efekti që shkakton shkrirja mbi konkurrencën. Prandaj, palët private dhe konsulentët e tyre duhet të ishin të kujdesshëm që të mos vendosnin për raportim apo jo sipas pikëpamjes së tyre, por t'i referoheshin dokumentave ligjorë dhe pragut të përcaktuar për raportimin e shkrirjeve.

Rasti i trajtuar më poshtë vjen nga Franca dhe ka ndodhur në vitin 2013, ku Autoriteti i Konkurrencës (AK) i vendosi një gjobë prej EUR 4,000,000 Castel Frères-it, një prodhuesi vere të vendosur në Bordeaux, pasi kompania nuk e njoftoi AK-në për blerjen e gjashtë kompanive që ishin pjesë e grupit Patriarche. AK-ja e zbuloi këtë transaksion nëpërmjet shqyrtimit të informacionit për një transaksion të një pale të tretë që ishte depozituar pranë AK-së, specifikisht marrëveshjes ndërmjet Cofepp dhe Quartier Français Spiritueux. Në korrik të vitit 2014, kompania e gjobitur e apeloj vendimin e AK-së tek Këshilli Shtetëror Francez, por ky i fundit vendosi kundër kompanisë.

Avokatët e grupit Castel argumentonin që, ndërkohë që grupi Castel e tejkalonte pragun e xhiros të specifikuar nga rregullorja, xhiroja e arritur individualisht nga entitetet e përfshira

në blerje nuk e tejkalonte pragun e raportimit, dhe për pasojë transaksioni nuk kishte nevojë për raportim pranë Komisionit. Nga ana e tjetër, në argumentimin e tij, Autoriteti iu referua metodologjisë së përcaktuar nga Rregullorja e Bashkimit European për Shkrirjet, për të specifikuar se duhet të ishte marrë parasysh xhiroja e mbledhur e të gjitha kompanive të përfshira në blerje, të cilat e tejkalonin pragun e përcaktuar nga ligji. Në vendimin e tij, Komisioni përcaktoi se kishte tre arsye për te penalizuar kompaninë: (1) detyrimi për të njoftuar autoritetin shtetëror ishte i qartë, (2) arsyeja e vetme që kompania nuk e njoftoi blerjen ishte për të përshpejtuar blerjen dhe (3) që grupi Castel është një kompani e madhe që ishte plotësisht në dijeni të detyrimeve në lidhje me shkrirjet. Gjithashtu, AK-ja rrëzoi pretendimin e kompanisë se marrëveshja nuk kishte pse të raportohet për sa kohë kjo nuk sillte probleme në kuadrin e konkurrencës. Por, ashtu si në rastin e Hollandës, impakti që do të kishte transaksioni mbi konkurrencën nuk do të duhej të ndikonte në raportimin apo jo të tij përpara, për sa kohë kushtet për një gjë të tillë ishin plotësuar.

Një tjetër rast për shqyrtim është nga Gjykata Europiane e Drejtësisë për dëmin e shkaktuar nga Komisioni ndaj një kompanie që kërkonte të kryente një përqëndrim në nivel komunitar. Konkretisht është:

Çështja Schneider Electric SA kundër Komisionit të Komunitetit European.

Gjykata Europiane e Drejtësisë (GJED) ka anuluar pjesërisht vendimin që ka dhënë Gjykata e Shkallës së Parë (GJSHP) për Schneider Electric SA, duke i dhënë të drejtën e kompensimit të dëmit, si rezultat i ndalimit të paligjshëm të bashkimit të saj me Legrand nga Komisioni European. GJED vendosi se Komisioni duhej të paguante kompensim për Schneider, në mënyrë që të mbulonte kostot e shkaktuara pas anulimit të transaksionit për një operacion përqëndrimi. GJED-ja rikonfirmoi parimin që palët janë në gjendje të kërkojnë kompensim

si rezultat i dështimit të rëndë dhe të qartë nga ana e Komisionit në dhënien e një vendimi të rregullt. (Case T-310/01 ECJ)

Në janar të vitit 2001, Schneider njoftoi një ofertë blerje për Legrand. Të dyja kompanitë ishin grupe të mëdha industriale franceze në prodhimin e pajisjeve elektrike. Njoftimi ishte marrë nga Komisioni në Shkurt të vitit 2001. Oferta publike e Schneider rezultoi në blerjen e 98% të kapitalit aksionar të Legrand në Gusht të vitit 2001. Komisioni më pas ndaloi bashkimin dhe në Janar të vitit 2002 urdhëroi Schneider të tërhiqte investimin nga Legrand brenda nëntë muajsh, edhe pse ky afat u shty më pas deri në Shkurt 2003 pas apelit që Schneider bëri ndaj vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë. Ankesat u dëgjuan duke përdorur procedurë të përshpejtuar. Në pritje të vendimit Schneider kishte hyrë në një marrëveshje në Korrik të vitit 2002 me Wendel INVESTISSEMENT dhe Kohlberg Kravis Roberts & Co (Wendel / KKR) për të përfutur kontrollin mbi Legrand.

Më 22 tetor 2002, GJSHP-ja anulloi vendimin e ndalimit dhe vendimin e tërheqjes së investimit nga Legrand. GJSHP vlerësoi se analiza ekonomike e Komisionit në kuadër të efekteve konkurruese të bashkimit ishte me të meta dhe përmbante "disa gabime të dukshme dhe kontradikta". GJSHP-ja në veçanti, mbështeti pretendimin e Schneider se e drejta e tij e mbrojtjes ishte shkelur me arsyetimin e mbështetur në vendimin përfundimtar të Komisionit. Sipas Schneider, Komisioni i kishte mohuar mundësinë për t'u përgjigjur apo për të ofruar ndonjë zgjidhje të përshtatshme për të adresuar këtë kundërshtim. Kjo ishte një shkelje e rëndë procedurale duke anuluar automatikisht vendimin.

Pas vendimit të GJSHP-së, Komisioni filloi rishqyrtimin e bashkimit. Më 3 Dhjetor 2002, Schneider i konfirmoi Komisionit se kishte vendosur të shkonte përpara me shitjen e Legrand në Wendel / KKR. Komisioni më pas informoi Schneider se e kishte mbyllur çështjen.

Më 10 Tetor 2003, Schneider ngriti padi për dëmet që i kishte shkaktuar Komisioni, duke pretenduar si kompensim 1.66 miliardë euro si rezultat i bllokimit të bashkimit të saj me Legrand.

GJSHP në qëndrimin e mbajtur theksoi se Komisioni i kishte shkelur të drejtën për t'u mbrojtur ndërmarrjes, një e drejtë që përbën një shkelje të rëndë procedurale si pasojë e një dëmi jashtëkontraktor, dhe për rrjedhojë, krijonte detyrimin për të kompensuar pasojat e dëmshme që i kishin ardhur në këtë aspekt. Më tej, gjykata analizon se vetëm kjo sjellje ishte e paligjshme dhe mund të dëmshpërblehej, por përndryshe, shkeljet e Komisionit në arsyetim nuk i sillnin kosto të rënda financiare kompanisë ashtu siç pretendonte Schneider. E drejta për kompensim i vinte si pasojë e shpenzimeve që kompania kishte pasur në dy drejtime: 1) Shpenzimeve të bëra në lidhje me procedurën e kontrollit të bashkimit kur Komisioni rishqyrtoi bashkimin pas vendimit për anulim të GJSHP-së; 2) Uljes së çmimit si pasojë e zhvlerësimit të aseteve në shitjen që do të bënte tek shoqëria Wendel / KKR. Gjykata vendosi të kompensonte për 2/3 e humbjeve, duke argumentuar se Schneider kishte kontribuar vetë në humbjen financiare (duke supozuar rrezikun e vërtetë se bashkimi më pas do të shpallej i papajtueshëm dhe rishitja e aksioneve të Legrand do të ishte një pasojë e pashmangshme). Komisioni apeloj vendimin e GJSHP në GJED. (Marrë nga: <http://curia.europa.eu>)

Më 16 korrik 2009, GJED-ja konfirmoi faktin se vendimi i Komisionit nuk ishte i qartë për arsyet mbi të cilat nuk u autorizua blerja e Legrand, dhe për rrjedhojë përbënte një shkelje. Kjo shkelje ishte mjaft e rëndë në përgjegjësinë jashtëkontraktore sipas nenit 228 (2) të Traktatit të KE-së. Gjithashtu, GJED u pajtua me GJSHP-në duke theksuar lidhjen mjaft të ngushtë shkakësore midis sjelljes së paligjshme të Komisionit dhe shpenzimeve të lindura nga rishqyrtimi i bashkimit pas vendimit të GJSHP-së. Në bazë të këtij arsyeimi, Komisioni

u shpall përgjegjës për këto humbje. Por, GJED nuk u pajtua me konstatimin e GJSHP-së se ka pasur një lidhje shkakësore midis aktit të paligjshëm të Komisionit dhe humbjeve për kompensimin e blerësit Wendel / KKR, dhe për zhvlerësimin e aseteve të Legrand për shkak të vonesës nga rishqyrtimi që i bëri Komisioni. GJED konstatoi se ishte e qartë nga dëshmitë e dokumentuara se vendimi i Schneider për të shkuar përpara me shitjen e Legrand në Wendel / KKR në Dhjetor të vitit 2002 ishte bazuar kryesisht në frikën e tij se, në rifillimin e hetimit të Komisionit, ajo nuk do të merrte autorizimin.

GJED vlerësoi si pasojë normale ligjore vendimin negativ të Komisionit dhe vendimin për tërheqjen nga investimi, ku Schneider me rifillimin e hetimit duhet të priste deri në përfundimin e tij. Kjo do të kishte çuar në: 1) Një vendim që e konsideronte bashkimin të përputhshëm me ligjet e Rregullores 139/2004, ku nuk do të kishte qenë i nevojshëm transferimi i Legrand dhe për rrjedhojë nuk do të ishte subjekt i reduktimit të çmimeve të pretenduara; 2) Një vendim të papajtueshëm me Rregulloren, ku transferimi tek Wendel / KKR do të kishte qenë pasojë ligjore e papajtueshmërisë, pasi ky transferim kishte rrezikun që lidhet me përfundimin e një shkrirje para vendimit të Komisionit, me përjashtim të "ofertave publike", në nenin 7 (3) të Rregullores për Bashkimet e KE-së.

Pra, GJED-ja vendosi që të pranonte në mënyrë të pjesshme padinë e Komisionit duke ulur vlerën e dëmshpërblimit si pasojë e veprimeve të Schneider gjatë periudhës së rishqyrtimit nga Komisioni.

6.4 Praktika shqiptare në drejtim të kontrollit të përqëndrimeve

Praktika gjyqësore shqiptare në kuadër të kontrollit të përqëndrimeve ka qenë shumë më pak e zhvilluar se në aspektet e tjera në fushën e të drejtës së konkurrencës, dhe në raport me

sjelljet e tjera që e shtrembërojnë atë. Në këtë aspekt duhet theksuar se nuk ka patur as edhe një ankimim për refuzim të autorizimit për përqëndrim nga Autoriteti. *Shoqërive të cilave i është refuzuar autorizimi, nuk janë ankimuar në gjykatë për vendimin e Komisionit, duke rezultuar pa praktikë gjyqësorë në këtë drejtim.* Të vetmet ankime janë bërë në drejtim të gjobave që i janë vendosur kompanive nga Autoriteti.

Gjatë vitit 2007, në tregun financiar kanë ndodhur ndryshime strukturore, që lidhen me rritjen e konkurrencës në treg. (Marrë nga: <http://caa.gov.al>) Në këtë vit ka pasur një zhvillim dinamik të tregut bankar. Kjo dinamikë shfaqet në ndryshimet strukturore, hyrjen dhe zgjerimin e kapitalit të huaj në treg, ndryshimet në pronësinë e aktorëve të tregut, dhe është reflektuar në aplikimet për njoftim të përqëndrimeve të bëra pranë Autoritetit të Konkurrencës. Për të gjitha rastet e shqyrtuara, Autoriteti ka bashkëpunuar me Departamentin e Mbikqyrjes së Bankës së Shqipërisë, si Autoriteti Rregullator në tregun bankar dhe Autoritetin e Mbikqyrjes Financiare, si rregullatori në sektorin e sigurimeve. (Raporti vjetor i AK-së, 2007)

Gjatë vitit 2008, kontrolli i përqëndrimeve ka zënë një vend të rëndësishëm në fushën e zbatimit të kuadrit ligjor dhe rregullator të konkurrencës, duke synuar ndalimin e krijimit apo forcimit të pozitës dominuese në treg si pasojë e përqëndrimeve të aplikuar. Rritja e kulturës në zbatim të ligjit për mbrojtjen e konkurrencës reflektohet në numrin në rritje të rasteve të njoftuara dhe të autorizuara nga Komisioni i Konkurrencës, rreth 16, të cilat iu përkasin ndryshimeve strukturore në tregun financiar, të ndarë respektivisht në bankar dhe tregun e sigurimeve, por pa përjashtuar edhe tregjet e tjera si: tregun e ndërtimit, të telefonisë, të përpunimit dhe tregtimit të karburanteve, tregun e tregtimit me pakicë të produkteve ushqimore, tregun e tregtimit të makinave etj. (Marrë nga: <http://caa.gov.al>) Një

karakteristikë tjetër që është evidentuar gjatë procedurave të kontrollit të përqëndrimeve është forcimi dhe zgjerimi i kontakteve të para-njoftimit, rritja e transparencës në konsultimet e palëve me Autoritetin, në situatat që synojnë realizimin e një përqëndrimi. Në këtë drejtim Autoriteti i Konkurrencës ka punuar për amendimin e akteve nënligjore ekzistuese, duke përgatitur një paketë të plotë që përfshin rregullore, udhëzues, formularë etj. Duhet theksuar se procedura e kontrollit të përqëndrimeve bazohet në parimin e njoftimit të detyrueshëm të përqëndrimeve, para se ato të hyjnë në fuqi. Por kjo nuk e përjashton rastin e hapjes së procedurës së kontrollit të përqëndrimit me nismën e vetë Autoritetit të Konkurrencës. Në këtë kontekst, Autoriteti i Konkurrencës ka shqyrtuar 2 raste të nisura me nismën e tij për përqëndrime të realizuara në treg. (Raporti vjetor i AK-së, 2008) Gjatë vitit 2008 Autoriteti i Konkurrencës ka shqyrtuar 7 raste njoftimi përqëndrimesh të cilat nuk përmbushnin të gjitha kriteret e ligjit “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, kryesisht pragun e xhiros së realizuar nga palët pjesëmarrëse në një transaksion përqëndrimi, apo transaksioni i realizuar nuk sillte ndryshime të cilësisë së kontrollit në kuptim të ligjit.

Gjatë vitit 2009 Komisioni i Konkurrencës ka autorizuar 8 përqëndrime si dhe ka dhënë sqarime për lejimin e disa transaksioneve që nuk ndryshonin kontrollin e ndërmarrjeve objekt përqëndrimi apo që nuk plotësonin kushtet ligjore (minimumet e xhirove të parashikuara në ligj) që përqëndrimet të jenë objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës. (Raporti vjetor i AK-së, 2009)

Autoriteti i konkurrencës ka autorizuar në vitin 2010 gjashtë përqëndrime si dhe ka lejuar disa transaksione që nuk ndryshonin kontrollin e ndërmarrjeve objekt përqëndrimi ose nuk përmbushej kushti i xhiros minimale të parashikuar në ligj. (Raporti vjetor i AK-së, 2010) Përqëndrimet në fjalë janë realizuar kryesisht në tregun e shërbimeve dhe produkteve të

komunikimit dhe teknologjisë së informacionit, tregun e sigurimeve, në sektorin e energjisë, në tregun e lojërave të fatit, etj.

Gjatë vitit 2011 është vënë re rritja e numrit të përqëndrimeve të njoftuara pranë Autoritetit për marrjen e autorizimit nga ana e Komisionit të Konkurrencës. Ky ndryshim vjen si pasojë e uljes së pragut të xhiros së ndërmarrjeve objekt përqëndrimi që kanë detyrimin ligjor për marrjen e autorizimit të Komisionit të Konkurrencës. Ndërkohë në kuadër të mbikqyrjes së tregut, Autoriteti i Konkurrencës kryen administrimin e të gjithë database-t nga QKB-ja, dhe fillon me nismën e tij procedurat për njoftimin e të gjitha rasteve që përmbushin kriteret ligjore për t'u autorizuar nga Komisioni i Konkurrencës, por që nuk janë njoftuar nga palët. Në këtë periudhë janë autorizuar 10 praktika përqëndrimesh lidhur me përfitim të kontrollit, bashkimin e ndërmarrjeve apo krijimin e një ndërmarrje të re, krahasuar me 6 raste përqëndrimesh në 2010-en. Përqëndrimet e ndodhura janë shqyrtuar si për efektet pozitive të sjella në treg, parë kjo nga pikëpamja e konsumatorit dhe rritjes së efikasitetit në treg, ashtu edhe nga premiset e mundshme për të krijuar apo forcuar pozitën dominuese të ndërmarrjes së përqëndruar në treg. (Raporti vjetor i AK-së, 2011)

Për të rritur efikasitetin e zbatimit të ligjit, edhe gjatë vitit 2012 janë realizuar mbikqyrje të transaksioneve të realizuara dhe të pasqyruara në Qendrën Kombëtare të Biznesit. Bazuar në bashkepunimin e ngushtë me QKB-në, Autoriteti i Konkurrencës ka mundur evidentimin e transaksioneve të shit/blerjeve të aksioneve, të cilat nuk ishin njoftuar, pra ndërmarrjet e përfshira në këto transaksione nuk kishin realizuar detyrimin ligjor të njoftimit. Gjatë vitit të kaluar u realizuan 4 raste të ushtrimit të kontrollit të transaksioneve të shit/blerjes të aksioneve me inisiativën e Autoritetit të Konkurrencës, dhe këto 2 raste ishin përqëndrime me ndryshim kontrolli. Ndërmarrjet që kishin përfutur kontrollin dhe kishin shkelur ligjin duke

mos njoftuar brenda një muaji Autoritetin, janë penalizuar me gjoba të lehta (3 raste mosnjoftimi në kohë të transaksioneve). Nga përqëndrimet e autorizuara nga Komisioni i Konkurrencës, gjatë vitit 2012, asnjë rast nuk ka rezultuar të jetë bashkim apo shkrirje të dy ose më shumë ndërmarrjeve. (Raporti vjetor i Ak-së, 2012)

Autoriteti i Konkurrencës ka shënuar progres në zbatimin e ligjit për rivendosjen e konkurrencës në treg nëpërmjet veprimit dhe ndëshkimit me gjobë të ndërmarrjeve për shkelje të ligjit në rastet e karteleve, abuzimit me pozitën dominuese, pengimin e inspektimeve dhe mosnjoftimin në kohë të përqëndrimeve. Por, doktrina e së drejtës së konkurrencës ka vërtetuar se efienca e ndërhyrjes së institucionit të konkurrencës në treg kushtëzohet në mënyrë të ndjeshme nga zbatimi i vendimeve të tij. (Marrë nga: <http://caa.gol.al>) Vendimet përfundimtare të Komisionit të Konkurrencës si rregull i nënshtrohen rishikimit gjyqësor në të gjitha shkallët dhe për këtë arsye Autoriteti i Konkurrencës ka ndjekur me rigoroze proceset e ankimit dhe mbrojtjes gjyqësore si në Gjykatën e Shkallës së Parë, në Gjykatën e Apelit, ashtu edhe në Gjykatën e Lartë.

Nëse i referohemi statistikave, duke filluar nga viti 2005 që ka qënë vendimi i parë i Komisionit të Konkurrencës me penalitet, e deri në fund të vitit të kaluar janë ankimuar në Gjykatën e Shkallës së Parë 26 vendime të Komisionit të Konkurrencës. Nga shqyrtimi gjyqësor i tyre deri në fund të vitit të kaluar rezulton se janë fituar 15 raste, janë humbur 6 dhe janë në proces 5 raste. Ndërsa, në Gjykatën e Apelit janë apeluar 21 çështje, por vetëm 18 raste i janë nënshtuar shqyrtimit gjyqësor. Deri në fund të vitit të kaluar rezulton se nga çështjet që janë shqyrtuar në këtë gjykatë 11 raste janë fituar, 5 raste janë humbur dhe 2 raste janë në proces shqyrtimi. Në Gjykatën e Lartë janë bërë rekurs për 12 çështje nga të cilat janë fituar 2 çështje, është humbur 1 çështje dhe 9 çështje janë në proces. Pra, duke përmbledhur

statistikat e mësipërme, të cilat paraqiten në mënyrë të detajuar në shtojcën nr. 5 “Pasqyra e rishikimit gjyqësor të vendimeve të Komisionit të Konkurrencës nga 26 çështje të ankimuara kanë përfunduar vetëm 3 të tilla. Gjithashtu, nëse i referohemi 17 vendimeve të Komisionit të Konkurrencës, që janë për vendosje gjobe vetëm 8 vendime kanë marrë formë të prerë dhe janë kthyer tituj ekzekutiv, 1 vendim është humbur dhe 8 vendime janë në procesin e shqyrtimit në shkallë të ndryshme të gjyqësorit (3 vendime janë në shqyrtim në Gjykatë të Lartë). Këta janë treguesit e rrugës së gjatë të shqyrtimit gjyqësor të vendimeve të Komisionit të Konkurrencës, i cili ndërhyr duke synuar mirë-funksionimin e tregjeve. Ky fakt përbën një nga problemet që kufizojnë rritjen e efektit të ndërhyrjeve në treg nga institucioni i konkurrencës. (Marrë nga: <http://caa.gov.al>)

Gjatë vitit 2013, janë shqyrtuar dhe autorizuar 13 praktika përqëndrimesh lidhur me përfitim të kontrollit, bashkimin e ndërmarrjeve apo krijimin e një ndërmarrje të re. Përqëndrimet e aplikuara janë shqyrtuar si për efektet pozitive të sjella në treg, parë kjo nga pikëpamja e konsumatorit dhe rritjes së efikasitetit në treg, ashtu edhe nga premiset e mundshme për të krijuar apo forcuar pozitën dominuese të ndërmarrjes së përqëndruar. Nga përqëndrimet e autorizuar nga Komisioni i Konkurrencës asnjë rast nuk ka rezultuar të jetë bashkim apo shkrirje e dy apo më shumë ndërmarrjeve, ndërsa në kuadër të përfitimit të kontrollit ka pasur disa vendime. (Raporti vjetor i AK-së, 2013)

Gjatë vitit 2014, është vënë re rritja e numrit të rasteve të shqyrtuara (16 raste) si përqëndrime pranë Autoritetit të Konkurrencës. Ky ndryshim vjen si pasojë e uljes së pragut të xhiros së ndërmarrjeve objekt përqëndrimi që kanë detyrimin ligjor për marrjen e autorizimit të Komisionit të Konkurrencës si dhe nga bashkëpunimi me Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) e cila ka kontribuar për t’i bërë me dije palëve kur duhet të njoftojnë një përqëndrim.

Ndërkohë, në kuadër të mbikqyrjes së tregut, Autoriteti i Konkurrencës pasi administron të gjithë databazën nga QKB-ja, fillon me nismën e tij procedurat për njoftimin e të gjitha rasteve që përmbushin kriteret ligjore për t'u autorizuar nga Komisioni i Konkurrencës, por që nuk janë njoftuar nga palët. (Raporti vjetor i AK-së, 2014)

Gjatë kësaj periudhe janë shqyrtuar dhe autorizuar 8 praktika përqëndrimesh lidhur me përfitim të kontrollit, bashkimin e ndërmarrjeve apo krijimin e një ndërmarrje të re. Përqëndrimet e ndodhura janë shqyrtuar si për efektet pozitive të sjella në treg, parë kjo nga pikëpamja e konsumatorit dhe rritjes së efikasitetit në treg, ashtu edhe nga premiset e mundshme për të krijuar apo forcuar pozitën dominuese të ndërmarrjes së përqëndruar. (Marrë nga: <http://caa.gov.al>)

Gjatë vitit 2015 janë shqyrtuar dhe autorizuar 11 praktika përqëndrimesh lidhur me përfitim të kontrollit, bashkimin e ndërmarrjeve, ose krijimin e ndërmarrjeve të reja. Përqëndrimet e ndodhura janë shqyrtuar si për efektet pozitive të sjella në treg, parë kjo nga pikëpamja e konsumatorit dhe rritjes së efikasitetit në treg, ashtu edhe nga premiset e mundshme për të krijuar apo forcuar pozitën dominuese të ndërmarrjes së përqëndruar në treg, në përputhje të plotë me legjislacionin në fuqi dhe direktivat komunitare. (Raporti vjetor i AK-së, 2015)

Sikurse u përmend më sipër ka pasur raste të cilat janë bërë objekt i shqyrtimit gjyqësor. Në vendimin nr. 7938, datë 22.09.2008 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është shqyrtuar çështja, ku kërkohej shfuqizimi i vendimit nr. 63, datë 03.12.2007 “Për vendosje gjobë ndaj shqërisë ‘Pro Credit Holding AG’”, të Komisionit të Konkurrencës i ngarkuar me këtë kompetencë nga Autoriteti i Konkurrencës. (Marrë nga: <http://caa.gov.al>) Në kuadër të gjyqimit, paditësi ka realizuar një procedurë përqëndrimi për të cilin Autoriteti është njoftuar me vonesë. Për këtë arsye, pala e paditur ka marrë vendim për të gjobitur palën paditëse për

shkelje të nenit 12/2 të ligjit “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”. (GJSHPT, Vendimi 7938/2008)

Gjykata vlerësoi, në kundërshtim me pretendimin e paditësit se data e llogaritjes së afatit për njoftimin e Autoritetit të Konkurrencës, do të nisë nga data e nënshkrimit të marrëveshjes dhe jo nga momenti i zbatimit efektiv të saj. Po ashtu, gjykata u shpreh se nga shqyrtimi i gjithë informacionit dhe dokumentacionit të marrëveshjes, nuk ishte i saktë dhe i plotë, duke krijuar mospërputhje me kërkesën për njoftim të përqëndrimit të përcaktuar në nenin 12, pika 2 të ligjit 9121 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”. Gjykata u shpreh më tej se dhënia e informacionit jo të plotë dhe të saktë, konsiderohet shkelje e lehtë, e përcaktuar në nenin 73, pika 1 shkronja a) dhe b) e ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”.

6.5 Konkluzion

Sistemet e të drejtës të marra në shqyrtim gjatë punimit janë Civil Law dhe Common Law. Këto dy sisteme që janë të aplikuara në Europë dhe SHBA kanë bërë të mundur që të zhvillohen praktikat ligjore të ndjekura për zgjidhjen e problematikave që dalin në fushën e të drejtës së konkurrencës në përgjithësi, dhe atë të përqëndrimeve të ndërmarrjeve në veçanti. Në fillim u trajtuan në mënyrë të tërthorte diferencat midis sistemit kontinental dhe oqeanik të të drejtës me diferencat përkatëse. Në fokus u vendosen praktikat e ndjekura nga autoritetet përkatëse në të drejtën amerikane të konkurrencës, në të drejtën e konkurrencës së Bashkimit European, si edhe në atë shqiptare.

Praktikat e autoriteteve të konkurrencës në vendet e zhvilluara që janë trajtuar në punim kanë larmishmëri në dhënien e vendimeve të ndryshme në kuadër të operacioneve të përqëndrimeve. Në rastet e aplikuara në kuadër të ligjit antitrust si pjesë e sistemit Common

Law, është pasqyruar fakti se vendimet e Komisionit për autorizimin e përqëndrimeve kanë një procedurë të ndryshme nga praktikat e ndjekura në vendet që kanë adoptuar sistemin e të drejtës Civil Law. Kjo ka ardhur si pasojë e organizimit të Autoritetit të Konkurrencës në bazë të së drejtës së aplikuar, ku organe të ndryshme janë të ngarkuara me kompetenca të ndryshme, në shkallë hierarkike të ndryshme nga njëra - tjetra. Në sistemin Common Law shpesh organet që janë të ngarkuara për kontrollin e përqëndrimeve janë hasur me vështirësi në kuadër të praktikave abuzive nga ndërmarrjet që operojnë në ato tregje, nga vetë fakti se në mungesë të kodifikimit të së drejtës, praktikat ligjore janë të krijuara në bazë të precedentit dhe hapësirat për kundërshtimet e vendimeve të Autoritetit të Konkurrencës kanë më shumë lehtësi për t'u aplikuar.

Përsa i përket të drejtës së Bashkimit Europian për autorizimin e përqëndrimeve, Komisioni i Komunitetit Europian, si organi që ka kompetencë në aprovimin ose jo të kësaj të drejte, ka sjellë praktika të ndryshme duke kontribuar në pasurimin e të drejtës me raste, të cilat për shkak edhe të ndjeshmërisë që kanë këto operacione në tregun e madh komunitar, por edhe në tregjet e brendshme të vendeve anëtare, kanë ndikuar në konkurrueshmërinë e shoqërive tregtare që bëjnë pjesë në këtë organizim. Nuk janë të pakta rastet që kanë shkuar në Gjykatën Europiane të Drejtësisë si pasojë e mosdakortësisë që kanë pasur ndërmarrjet me vendimin e Komisionit. Në këtë kapitull, janë trajtuar disa raste të praktikës gjyqësore të Gjykatës Europiane të Drejtësisë në kuadër të operacioneve të përqëndrimeve që ishin në nivel komunitar. Vendimet e gjykatave kanë ndikuar pozitivisht në krijimin e praktikave të lejuara, duke theksuar në të shumtën e rasteve faktin se vendimet për mosdhënien e aprovimit nga ana e Komisionit kanë sjellë pasoja ekonomike për palët që kanë qenë pjesëmarrëse në përqëndrim. Gjithashtu, nga vendimet e gjykatës është vënë në dukje fakti se edhe kompanitë

nuk kanë një sensibilitet në operacionet që kryejnë, duke vënë theksin tek përfitimet individuale, duke mos marrë parasysh dëmet që mund të shkaktojnë në tregjet përkatëse.

Në rastin e e Autoritetit Shqiptar të Konkurrencës kemi vendime të Komisionit në lidhje me autorizimin, dhe theksohet se janë raste shumë të rralla në të cilat është refuzuar përqëndrimi.

E gjithë praktika gjyqësore e përqëndrimeve ka shumë pak raste në të cilat ndërmarrjet pjesëmarrëse kanë ankimuar vendimin e Komisionit. Ne bazë të raporteve vjetore të Autoritetit së Konkurrencës vihet re se janë autorizuar pothuajse të gjitha kërkesat që i janë dërguar për përqëndrim Komisionit, duke mos krijuar në këtë mënyrë një frymë “pengese” për përqëndrimet. Përqëndrimet e aplikuara kryesisht janë në kuadër të përfutimit të kontrollit, gjë që ka sjellë një praktikë shumë të pasur në këtë fushë të së drejtës së konkurrencës.

KAPITULLI VII: KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

1. Si fushë e të drejtës së konkurrencës, operacionet e përqëndrimeve janë një pjesë e rëndësishme e rregullimit të tregjeve rajonale. Pavarësisht se ka teori të ndryshme mbi kontrollin e këtyre veprimtarive nga organet përkatëse, në zhvillimet e viteve të fundit këto praktika janë shtuar në mënyrë proporcionale me rritjen e fuqisë ekonomike të këtyre aktorëve. Legjislacioni në fuqi me parashikimet ligjore përkatëse, pavarësisht se janë forcërisht të zbatueshme, nuk e zbehin pozitën dominuese të aksionerëve, meqënëse janë ortakët aksionarë që vendosin përbërjen e organeve vendim-marrëse. Për rrjedhojë, duke iu referuar legjislacioneve në fuqi, këto operacione ndahen në: 1) Bashkim/Shkrirje; 2) Përfitim Kontrolli. Në këtë mënyrë disa shoqëri tregtare që kërkojnë të marrin kontrollin nëpërmjet dy mënyrave duhet më parë të kalojnë përmes autorizimit të autoritetve përkatëse.

Rekomandim

E ardhmja e ekonomisë në arenën ndërkombëtare po shkon drejt globalizimit të tregjeve të brendshme. Ky globalizim i ekonomive ka avancuar në atë pikë sa kërkon një rregullim ligjor adekuat për përshtatjen me ritmet e shpejta që ecën tregu ndërkombëtar. Fillimisht është e dobishme për të formuluar një sërë parimesh të politikës së konkurrencës në një kod i cili përcakton standardet minimale të konkurrencës efektive. Duhet të ketë një sensitivitet në përzgjedhjen e fushave të politikës së konkurrencës në të cilën ka më shumë nevojë për ndërhyrje dhe duhet konsoliduar një marrëveshje e përgjithshme ose konsensus në lidhje me parimet që do të zbatohen. Ky rekomandim vlen për operacionet e përqëndrimeve të cilat

kanë mangësi për t'u dhënë zgjidhje disa problematikave aktuale, si edhe për të krijuar praktika thjeshtëzuese për ekonomizimin e procesit, efikasitetin e procedurës së shkrirjes dhe eficientësinë e zbatueshmërisë së këtij procesi duke konsideruar kohën dhe koston. Me anë të një korpusi ligjor të implementuar në një “Kod” do të krijonte benefite duke ndikuar në forcimin e konkurrueshmërisë së ndërmarrjeve në tregun rajonal dhe më gjërë.

2. Me anë të bashkimit/shkrirjes paraqiten dy mënyra përqëndrimi, ku në njërin rast bashkimi shfaqet me shkrirjen e ndërmarrjeve duke krijuar një ndërmarrje të re dhe në rastin tjetër realizohet me përthithje, ku njëra nga ndërmarrjet përthith ndërmarrjen tjetër duke kaluar të gjithë asetet në ndërmarrjen përthithëse. Në këtë prizëm janë analizuar operacionet e përqëndrimit të ndërmarrjeve nga një person ose grup personash, si edhe nga një ndërmarrje ose grup ndërmarrjesh. Duhet të theksohet fakti se qëllimi i përdorimit të operacioneve të përqëndrimit nuk ka të bëjë me shkakun abuziv në kuptim të krijimit të pozitës dominuese në një treg të caktuar. Në shumë raste këto operacione zhvillohen për të mos falimentuar, për të maksimizuar fitimet dhe për të ndarë kostot e shpenzimeve në kuadër të investimeve. Rastet të cilat mund të jenë abuzive kanë të bëjnë me shtrembërimin e konkurrencës efektive në nivel horizontal, vertikal ose konglomerat. Ndërhyrja e Autoritetit është e nevojshme për të marrë përsipër kontrollin e këtyre përqëndrimeve, ku në rastin e Shqipërisë nuk është shumë efikase, meqenëse në praktikën e Komisionit të Konkurrencës ekzistojnë shumë pak refuzimet e autorizimeve për ndërmarrjet pjesëmarrëse në proceset e përqëndrimeve.

Rekomandim

Pikërisht këtë çështje të zbërthimit sa më thellë të bashkëveprimit, bashkimit të ndërmarrjeve (joint venture) duke u nisur nga praktikat dhe rregullat e BE-së, po përpiqen ta definojnë të gjitha vendet e BE-së përmes organeve të tyre për mbrojtjen e konkurrencës. Me kriterin “full function” të joint venture, kuptojmë pavarësinë e subjektit të ri ekonomik me kontrollin e përbashkët të sipërmarrësve të cilët veprojnë në baza të përhershme. Sipas Komisionit Europian, konsiderohet se ka ndodhur një “përqëndrim” atëherë kur ndryshimi i aktivitetit ekonomik, apo bashkimi i ndërmarrjeve (joint venture) i plotëson këto kushte:

- i) Kur bashkimi i ndërmarrjeve, krijon përparësi dhe pasuri shtesë duke i marrë ato nga ndërmarrjet e më përparme që kanë hyrë në bashkim, pra ndërmarrjet e vjetra;
- ii) Kur ndërmarrjet e vjetra e bartin në bashkim pjesën më të madhe të mjeteve, kontratat, dijen apo të drejta të tjera dhe me këtë krijojnë mundësinë e zgjerimit të bashkimit të ndërmarrjeve në tregun tjetër prodhues apo gjeografik i cili nuk ka qenë objekt i (joint venture) bashkimit dhe atëherë kur bashkimi kryen aktivitetin ekonomik në bazat e (full function) funksionit të plotë.

Në këtë rast zgjerimi i aktivitetit i JV-ve paraqet bazën e plotë për paraqitjen e përqëndrimit për lejim, dhe se konsiderohet përqëndrim edhe në kuptimin ligjor;

- iii) Nëse përqëndrimi vazhdon aktivitetin edhe pas ndryshimeve të karakterit të bashkimit në joint ventures, përmes së cilave plotëson kriterin “full function”;

Një konstatim është vënë re nga punimi, ku përse i përket joint venture në të drejtën BE-së në kuadër të Rregullores 139/2004, në nenin 4 (3) parashikohet se joint ventures në rast se ushtrojnë veprimtari pas një periudhe të përcaktuar atëherë duhen marrë masa në rishqyrtimin e marrëdhënies ndërmjet shoqërive tregtare që janë pjesë e marrëveshjes.

Ligji i konkurrencës në nenin 10 të tij parashikon përqëndrimet e ndërmarrjeve, ku krijimi i një ndërmarrjeje të përbashkët nuk përbën një përqendrim, sipas këtij neni, në rast se ka për objekt apo pasojë bashkërendimin e veprimtarive konkurruese ndërmjet dy ose më shumë ndërmarrjesh të pavarura. Në këto raste krijimi i një ndërmarrjeje të përbashkët vlerësohet në bazë të nenit 4 të këtij ligji që trajton marrëveshjet e ndaluara.

Nëse Autoriteti i Konkurrencës pas vlerësimit profesional vjen në përfundimin se joint venture (bashkimi i ndërmarrjeve) ka plotësuar kriterin e funksionit të plotë (full function) të ndërmarrjeve, ai me këtë edhe konstaton se fjala është për “përqendrim”, për çka duhet apo nuk duhet dhënë lejimi i tij.

Në bazë të ligjit “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” në Republikën e Shqipërisë, bashkimet që paraqiten në formën e joint venture nuk konsiderohen si përqëndrime dhe si të tilla mund të ushtrojnë veprimtarinë e tyre pa përcaktuar kufinj kohor. Mendoj se, në kuadër të përafrimit të legjislacionit me atë të BE-së, e drejta shqiptare e konkurrencës duhet të implementojë këtë parashikim ligjor që është potencialisht shkak për veprime abuzive nga ndërmarrjet që operojnë në këtë fushë, sepse realiteti ekonomik shqiptar është në krizë permanente dhe duke qenë në kushtet e një ekonomie të ulët në krahasim me rajonin, specifikisht në lidhje me të ardhurat për frymë, atëherë mund të konkludoj se veprimet e dy apo më shumë shoqërive tregtare mund të kishin pasoja ekonomike në treg, edhe në kuadër të mbrojtjes së konsumatorëve.

3. Në rastet e përfutimit të kontrollit ndërmarrjet përqëndruese krijojnë mundësinë e ushtrimit të një ndikimi vendimtar në politikat e kompanive dhe veprimtarinë ekonomike të tyre. Përqëndrimet në këtë aspekt mund të bëhen nëpërmjet përfutimit të kontrollit duke blerë 100%

të aksioneve, duke vendosur kontroll mbi një pjesë të tyre, nëpërmjet marrjes së aseteve, nëpërmjet ekskluzivitetit, etj. Duke iu referuar vendimeve të Komisionit të Konkurrencës dilet në përfundimin se përqëndrimet e aplikuara në shumicën e rasteve kanë në bazë operacionet në drejtim të marrjes së kontrollit; operacione që janë trajtuar në punim në kuadër të vendimeve të Komisionit. Meqënëse tregu shqiptar është i vogël dhe nuk jemi në kushtet e eksportit për shkak se nuk kemi një ekonomi prodhuese, ekonomia është e bazuar në shërbime dhe për rrjedhojë në importin e mallrave, ku praktikat e përfutimit të kontrollit janë më të aplikueshme, sepse shpesh nga marrëveshjet e ekskluzivitetit me ndërmarrje të huaja për të sjellë mallrat në tregun vendas, kryesisht, këto kompani, duke qenë në statusin e distributorit kryesor, kanë ndikim të drejtpërdrejtë në konkurrueshmërinë e operatorëve në treg. Megjithatë, janë të pakta korporatat që ushtrojnë veprimtari në tregun e brendshëm, dhe për këtë arsye, veprimtaria e tyre nuk është e cënuar në rast se shkojnë drejt përfutimit të kontrollit në 100% të aksioneve ose në një pjesë më të vogël të ndërmarrjeve me fuqi të vogël ekonomike, pra, duke ruajtur identitetin ligjor të tyre. Këto persona juridikë që ushtrojnë veprimtari ekonomike, për rrjedhojë, kanë një rol dominues në treg, dhe nuk janë shumë sensitiv në sipërmarrjet e tyre, duke mos konsideruar dëmet që mund t'i shkaktohen konsumatorit. Prandaj, roli i AK-së është i domosdoshëm për të monitoruar veprimtarinë e këtyre ndërmarrjeve.

4. Proceduralisht, njoftimi është një kriter i rëndësishëm për të kërkuar autorizimin nga Komisioni. Pasi bëhet njoftimi, organi përgjegjës merr në shqyrtim kërkesën duke filluar me fazën e hetimit. Në praktikat e vendeve që janë marrë në shqyrtim në punim, vihen re se ka ndryshime në procedurat e ndjekura për miratimin e përqëndrimeve ose refuzimin e tyre.

Rastet e përqëndrimeve nga ana procedurale nga e drejta amerikane në kuadër të ligjit antitrust pasqyrohen me situata në të cilat, procedurat ndryshojnë në kuadër të xhiros së vitit para-ardhës së kompanive për efekt të hetimit.

Në të drejtën e BE-së, për të qenë në nivel komunitar një përqëndrim duhet të ketë së paku një xhiro vjetore që e dëmton tregun komunitar në rast të pozitës dominuese. Përqëndrimet me madhësi komunitare dhe ata të tregjeve të brendshme, në bazë të Rregullores 139/2004, ndryshojnë nga operacionet përsa i përket xhiros vjetore që kanë kompanitë.

Procedurat e ndjekura nga Autoriteti i Konkurrencës në Shqipëri janë të tilla që japin tre lloje vendimesh dhe konkretisht autorizimin, autorizimin me kushte si dhe refuzimin e autorizimit për përqëndrim. Çdo vendim i Autoritetit mund të ankimohet në gjykatë, por proceduralisht nuk mund të kërkohet masë për sigurimin e padisë meqënëse masa për sigurimin e padisë mund të jetë e përkohshme dhe mund të sjellë pasoja ekonomike në rast se lejohet një përqëndrim nga gjykata. Një masë e parakohshme mund të sjellë në treg një ndryshim të të drejtave ekonomike dhe pasoja shumë të dëmshme për operatorët e tregut, por edhe për konsumatorët. Prandaj ligji parashikon si të drejtë ekskluzive të Komisionit aprovimin ose jo të përqëndrimit.

Rekomandim

Xhiroja totale në kuptim të Rregullores përfshin shumat që rrjedhin nga ndërmarrjet në fjalë në vitin financiar paraprak nga shitja e produkteve dhe ofrimi i shërbimeve. Kështu pragjet janë: 1) xhiro totale e ndërmarrjeve pjesëmarrëse në përqëndrim që kapërcejnë shifrën prej 5.000 milion euro dhe 2) xhiro e realizuar nga së paku dy ndërmarrje (në mënyrë individuale

nga secila prej tyre) që kapërcjenë shifrën prej 250 milion euro dhe nuk realizohet për më shumë se 2/3 në të njëjtin shtet anëtar.

Përsa i përket xhiros totale vjetore në Shqipëri, në bazë të akteve nënligjore të nxjerra nga Autoriteti i Konkurrencës në zbatim të ligjit për mbrojtjen e konkurrencës pragu minimal për të marrë në shqyrtim Komisioni një përqëndrim është i madh në raport me ekonominë vendase. Autoriteti i Konkurrencës duhet të vendosë një dyshe me të ulët të xhiros totale vjetore, duke e ulur këtë kufi të vitit para-ardhës në mënyrë të tillë që të rrisë kontrollin e ristrukturimit të ndërmarrjeve të ndryshme. Tregu shqiptar, ku ushtrojnë veprimtari shoqëritë tregtare shqiptare por edhe të huaja, është shumë i vogël në nivel rajonal. Ndikimi i fuqisë së tregut në rajon përcakton në një farë mënyre edhe peshën specifike të çdo ndërmarrje. Momentalisht në Shqipëri me ndryshimet e fundit të vitit 2017 paga minimale është 24.000 Lekë. Kjo shifër është shumë e vogël si brenda ashtu edhe jashtë vendit. Që një përqëndrim të konsiderohet i tillë duhet që të ketë një xhiro vjetore në tregun e brendshëm mbi 200 Milion Lekë. Në kushtet e një ekonomie të dobët, gjykoj se shifra është shumë e madhe, dhe mund të sjellë pasoja si për tregun ashtu edhe për konsumatorët meqënëse një biznes që gjeneron një shumë të tillë mund të ketë ndikim në treg. Prandaj, rekomandoj që kufiri minimal i kontrollit nga Autoriteti i Konkurrencës të ulet me 25% duke krijuar fleksibilitet edhe për operatorët potencial që kërkojnë të hyjnë në treg, sepse do të kërkonte një kapital fillestar mjaftueshëm të lartë sa për të dekurajuar hyrjen në treg, në mënyrë që edhe kur rastet e përqëndrimeve nuk kanë efekt në konkurrueshmërinë e ndërmarrjeve, të ketë një parandalim abuzimi në kuadër të mbrojtjes së konsumatorit. Duke iu referuar ekspansionit të biznesit dhe maksimizimit të fitimit të këtyre formacioneve monetare, operacionet e përqëndrimeve mund

të kenë edhe pasoja në dëm të konsumatorit. Prandaj, unifikimi praktikave proceduriale është një sfidë në vetvete për vendet si Shqipëria që nuk kanë pikën më të fortë zbatimin e ligjit.

Rekomandim

Palët që janë pjesëmarrëse në përqëndrim, kërkohet që në njoftimin e tyre të ofrojnë detajet e kontaktit për klientët kryesorë, furnizuesit dhe konkurrentët. Komisioni i publikon këto për palët e treta, përmes kërkesave me shkrim për informacion për të kërkuar komentet e personave të interesuar në javët e para pas njoftimit. Përveç kësaj, një botim i shkurtër në Gazetën Zyrtare tek Komuniteti European do të ftojë të tretë dhe palët e interesuara të paraqesin vërejtje me shkrim brenda 10 ditëve nga publikimi. Hetimi i Komisionit bashkëngjijt të dhënat e marra nga palët e treta. Nuk ka procedurë formale të ankesave për palët e treta, kështu palët njoftuese kanë mundësi të mjaftueshme gjatë fazës së parë dhe fazes së dytë për të bërë të njohur pikëpamjet e tyre. Praktikën e fundit të Komisionit ofrojnë për të ashtuquajturin "trekëndësh", takime ndërmjet stafit të Komisionit, palëve njoftuese, dhe ankuesit, edhe pse takime të tilla janë në përgjithësi të rralla. Ankuesit mund të dedikojnë burimet e nevojshme duke luajtur një rol të rëndësishëm në procedurat e Bashkimit European. Palët e interesuara mund të kërkojnë të marrin pjesë në ndonjë seancë dëgjimore që mund të jetë e organizuar në fazën 2 të përqëndrimit. Ata, për këtë qëllim mund të kenë akses në një version të redaktuar të Deklaratës së Kundërshtimeve të Komisionit, gjithashtu mund t'u kërkohet të komentojnë për ndonjë nga mjetet juridike të propozuara nga palët njoftuese për përqëndrim. Ndryshe nga palët e njoftuara, palët e treta nuk kanë të drejtë për akses në dosjen e çështjes në shqyrtim nga Komisioni. Një përjashtim vlen për shitësin dhe kompaninë e

synuar për t'u përqëndruar (target company), të cilat mund të jenë të rëndësishme sidomos në rast të ofertave të pafavorshme (hostile bids).

Në rregulloren “Për Zbatimin e Procedurave të Përqëndrimit të Ndërmarrjeve” dhe konkretisht në nenin 13 që parashikon publikimin e procedurës paraprake, sekretariati publikon fillimin e procedurës së kontrollit të përqendrimit në faqen zyrtare të internetit të Autoritetit të Konkurrencës. Akti i publikimit përmban të dhënat për palët pjesëmarrëse, vendin e tyre të origjinës, formën e përqendrimit, sektorët e ekonomisë së përfshirë në të, ftesën e Autoritetit të Konkurrencës për shprehjen e komenteve nga palët e interesuara dhe afatin e fundit për shprehjen e këtyre komenteve. Përpara marrjes së një vendimi, në plotësimin e kushteve të neneve 56, pika 2 dhe 57 të Ligjit dhe në bazë të nenit 39 të Ligjit, Komisioni u krijon mundësi për t'u dëgjuar palëve njoftuese dhe palëve të treta që lidhen me përqëndrimin e njoftuar. Përveç palëve të përcaktuara në nenin 8 pika 2 të kësaj rregulloreje, kanë të drejtën për t'u dëgjuar: (a) palët e tjera të përfshira, përveç palëve njoftuese, të tilla si shitësi dhe ndërmarrja e cila është objekt i përqendrimit; (b) palët e treta të interesuara, që mund të jenë persona fizikë ose juridikë, përfshirë konsumatorët, furnitorët, konkurrentët dhe veçanërisht anëtarët e organeve të administratës ose menaxheriale të ndërmarrjeve në fjalë ose përfaqësuesit e sindikatave të këtyre ndërmarrjeve. Në ligj parashikohet seanca dëgjimore: 1. Komisioni u krijon mundësi palëve njoftuese dhe palëve të interesuara që të paraqesin verbalisht argumentet e tyre në një seancë dëgjimi, nëse e kanë kërkuar këtë gjë në komentet e tyre me shkrim dhe nëse ato janë të interesuara. Komisioni mund t'u japë palëve mundësinë që t'i shprehin pikëpamjet e tyre verbalisht, kur ai e sheh të nevojshme; 2. Komisioni fton me shkrim palët që do të dëgjohen që të jenë pjesëmarrëse në datat e vendosura për seancën e dëgjimit; 3. Palët e ftuara për të marrë pjesë duhet të paraqiten

personalisht ose të përfaqësohen nga përfaqësues të autorizuar. Ndërmarrjet dhe grupet e ndërmarrjeve mund të përfaqësohen edhe nga një person i përbashkët i autorizuar; 4. Seancat e dëgjimit, si rregull, janë të mbyllura për publikun dhe regjistrohen. Komisioni mund të vendosë për organizimin e seancave të hapura për publikun; 5. Çdo palë mund të dëgjohet veçmas ose në prezencën e palëve të tjera të ftuara për të marrë pjesë, duke mbajtur në konsideratë interesin legjitim të ndërmarrjeve për mbrojtjen e sekreteve të tyre të biznesit dhe informacione të tjera konfidenciale.

Ligji “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” bie ndesh me rregulloren përse i përkët botimit të njoftimit dhe konkretisht në nenin 64 parashikohet se:

a) Njoftimi i një përqëndrimi dhe vendimi për fillimin e një procedure të thelluar botohen në "Buletin zyrtar" të Autoritetit. *Mungesa e botimit nuk pengon fillimin e afateve dhe të procedurës së thelluar.*

b) Njoftimi përmban emërtimin, selinë, veprimtarinë ekonomike të ndërmarrjeve pjesëmarrëse, një përshkrim të shkurtër të përqëndrimit dhe afatin brenda të cilit palët e treta mund të shprehin mendimin e tyre. Mendimet e palëve të treta jepen me shkrim. 3. Vendimet e Komisionit botohen në "Buletin Zyrtar" të Autoritetit. Botimi përmban emërtimin, selinë, veprimtarinë ekonomike të ndërmarrjeve pjesëmarrëse, përmbajtjen kryesore të vendimit, si dhe gjobat e vëna.

Në kuadër të arsyetimit të bërë më sipër rekomandimi qëndron në faktin se legjislacioni jonë duhet të përafrohet me të drejtën komunitare në çdo aspekt dhe jo në mënyrë sipërfaqësore duke mos implementuar procedurat në tërësi me të gjithë komponentët e tyre. Grupet e interesit duhet që të jenë në linjë të parë kur zhvillohen procedura të tilla dhe jo të lejohen hapësira të tilla që mund të përbëjnë shkak abuziv. Procedurat e BE-së janë të tilla që nuk

krijonjë përplasje normash juridike ashtu si në rastin e ligjit të konkurrencës me rregulloren për zbatimin e procedurave të përqëndrimeve.

5. Ligji për mbrojtjen konsumatorit ka në fokus mbrojtjen e interesave të konsumatorëve në treg, duke përfshirë të gjitha llojet e marrëdhënieve ndërmjet tregtarëve dhe konsumatorëve. Konsumatorët kanë një sërë të drejtash që kanë të bëjnë me mbrojtjen e interesave ekonomike, të drejtën e informimit, të dëmshpërblimit, etj. Marrëdhënia që kanë konsumatorët me shoqëritë tregtare është bashkëvepruese, në kuptimin që ndërmarrjet janë të varura nga konsumatorët. Duke iu referuar ligjit për shoqëritë tregtare, parashikohen edhe ndalimet për praktikën e padrejta tregtare. Praktikën tregtare, që shtrembërojnë sjelljen ekonomike të një grupi konsumatorësh, qartësisht të identifikueshëm, të cilët janë të ndjeshëm ndaj praktikës, mallit ose shërbimit, si pasojë e dobësisë së tyre mendore apo fizike, moshës apo lehtë-besimit, në një mënyrë të arsyeshme, të parashikohet, dhe të vlerësohet nga këndvështrimi i konsumatorit, të nivelit mesatar të këtij grupi. Konsumatorët nuk dëmtohen vetëm nga rastet e përmendura më sipër por edhe nga marrëveshjet e ndërmarrjeve apo përqëndrimit të tyre.

Përqëndrimi nuk jepet vetëm në rast se ka aktorë të tjerë. Duhet shikuar rasti nëse konsumatorët mund të gjejnë mjete alternative të ngjashme me veprimtarinë e shoqërive që kërkojnë të kryejnë operacione përqëndrimi. (parimi i zëvendësimit – principle of substitution).

Përqëndrimet e ndërmarrjeve si praktika të zhvilluara në kontekstin shqiptar nuk kanë qëllim në vetvete të garantojnë interesin më të lartë të konsumatorit, sepse po t'i referohemi punimit do të shohim se praktikën e ndjekura nga ndërmarrjet janë ngushtësisht të lidhura me

maksimizimin e fitimit dhe pozitën avantazhuese, që në shumë raste shprehet si një dëshirë e kompanive për “empire building” (ndërtimi i një pushteti ekonomik dhe jo vetëm nga ambicia e personave që zotërojnë shoqëritë tregtare), pra, për të rritur pushtetin e influencës në tregjet ku marrin pjesë. Operacionet e përqëndrimeve janë të monitorueshme nga Komisioni i konkurrencës pikërisht për arsyen se mund të sjellin efekte negative në tregjet ku kryhen, por edhe për të mbrojtur të drejtat e konsumatorëve. Pak punë është bërë në këtë drejtim, pasi duke iu referuar vendimeve dhe raporteve vjetore të Autoritetit të Konkurrencës vihet re fakti se, kryesisht, problematikat të cilave i referohet organi në fjalë kanë të bëjnë në shumicën e rasteve me tregjet. Duhet konsideruar fakti se, përveç impaktit që ka në treg, Autoriteti duhet t’i kushtojë një rëndësi më specifike të drejtave të konsumatorëve, duke monitoruar ndërmarrjet që ushtrojnë veprimtari brenda juridiksionit të AK-së.

6. Praktikrat e ndjekura nga Autoritetet e Konkurrencës në vendet që janë marrë në shqyrtim gjatë punimit variojnë nga njëra – tjetra. Në të drejtën amerikane të konkurrencës vendimet e Komisionit janë më të ndërlikuara si pasojë e hyrjes së aktorëve të tjerë duke e bërë më të vështirë nxjerrjen e një vendimi. Në të drejtën e konkurrencës së BE-së vihet re se praktikrat e ndjekura nga Komisioni për autorizimin e përqëndrimeve kanë në fokus ruajtjen e konkurrueshmërisë së ndërmarrjeve në tregun e përbashkët por edhe në tregun e brendshëm, duke krijuar një pengesë për përqëndrimet abuzive. Në të gjitha rastet kur shoqëritë pjesëmarrëse nuk kanë qenë dakort me vendimin e Komisionit, i janë drejtuar gjykatës si instanca më e lartë për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve. Në rastet e trajtuara nga gjykata shpesh janë hasur edhe gabime në vendim-marrjen e Komisionit duke sjellë edhe dëme ekonomike për ndërmarrjet pjesëmarrëse në përqëndrim. Në vendimet e pasqyruara në disertacion jepen

raste në të cilat GJED-ja dhe GJP-ja kanë vendosur gjoba ndaj Komisionit të Komunitetit European në lidhje me mos autorizimin e përqëndrimit dhe dëmin e shkaktuar ndaj shoqërive tregtare.

Në të drejtën shqiptare të konkurrencës, Komisioni ka pranuar në masë të gjërë përqëndrimet duke krijuar një praktikë në shumicën e rasteve pranuese në këtë fushë. Në bazë të raporteve vjetore paraqitet qartë se ka vend për përmirësim në këtë aspekt duke shtrënguar praktikat e dyshimta në lidhje me bashkimin/shkrirjet dhe përfitimet e kontrollit të ndërmarrjeve që kërkojnë të jenë pjesë e këtyre operacioneve. Vendimet e ankimuara nga kompanitë, të cilave i është mohuar autorizimi për M&A, në praktikën gjyqësore janë zero. Gjatë hulumtimit në terren dhe në institucionin e Autoritetit të Konkurrencës, që nga krijimi i tij dhe deri më tani, nuk ka asnjë vendim të mos-autorizimit të ankimuar në gjykatën respektive, gjë që sjell në vëmendje faktin se kryesisht ky organ ka vepruar brenda kuadrit ligjor.

Ankimet e bëra në Gjykatën e Tiranës në kuadër të përqëndrimeve janë të gjitha me objekt anulimin e penaliteteve që ka vendosur AK-ja ndaj subjekteve që ushtrojnë veprimtari fitimprurëse në tregun shqiptar, treg i cili mbykqyret nga AK-ja për aq sa ia lejon kuadri ligjor në fuqi të shtrijë juridiksionin dhe kompetencat.

Rekomandim

Në rastin e trajtuar nga Komisioni European dhe Komisioni Shqiptar i Konkurrencës për dy ndërmarrjet e aviacionit civil del në pah fakti që në Shqipëri mungojnë qartësitë ligjore përsa i përket procedurave të parashikuara nga ligji në kuadër të autorizimit të përqëndrimeve të shoqërive të huaja që ushtrojnë aktivitet tregtar në territorin e RSH-së . Jo vetëm në këtë rast, por edhe në rastet e tjera të trajtuara në punim, theksohet fakti se ndërmarrjet e huaja që nuk

kanë një seli në RSH kërkojnë të përqëndrohen dhe merren në shqyrtim nga Komisioni. Në këto kushte sugjeroj se është e nevojshme që të rregullohet kuadri ligjor në fuqi me ndërhyrjet e nevojshme për të përcaktuar subjektet që shqyrtohen nga AK-ja. Subjektet që shqyrtohen nga AK-ja duhet të jenë të përcaktuara edhe në kuadër të juridiksionit sepse përqëndrimet e marra në shqyrtim në shumë raste ka ndodhur që të jenë kompani që kanë fituar koncesione dhe ka një sërë organesh shtetërore që janë të ngarkuara për procedurat dhe monitorimin e sjelljes së këtyre kompanive. Për koncesionet në Shqipëri ekziston një ligj më vete dhe nuk është nevoja që të rregullohet nga Autoriteti me ndërhyrjen kryesisht, përveç rasteve kur i kërkohet ndërhyrja nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, Agjencia e Prokurimit Publik, apo ndonjë institucion i ngjashëm me këto të fundit për nga juridiksioni dhe kompetencat.

BIBLIOGRAFIA

Burime parësore

Legjislacion ndërkombëtar

- 1) Akti i Komisionit Federal të Tregtisë (1914), 15 U.S.C, Seksioni 5, parag. 45
- 2) Code de Commerce, Livre II, Titre II, Art. L225-127
- 3) European Commission “EU Competition Law Rules Applicable to Merger Control”, Official Journal of the European Union, Brussels 2010
- 4) Directive 2001/23/KE
- 5) Komisioni Europian, Rregullorja nr. 802 datë 30.04.2004 në funksion të Rregullores 139/2004 të Komisionit “Për Kontrollin e Përqëndrimeve mes Ndërmarrjeve”
- 6) Guidelines on the assessment of horizontal mergers under the Council Regulation on the control of concentrations between undertakings (2004/C 31/03)
- 7) Commission Notice under Council Regulation (EC) 139/2004 on the Control of Concentrations between Undertakings [2008] OJ C95, paras. 54 and 56 (Consolidated Jurisdictional Notice)
- 8) Rregullorja e Këshillit Nr. 4064/89 “Mbi Kontrollin e Bashkimeve ndërmjet Ndërmarrjeve”, Fletore Zyrtare 1989 L395/1, 30.12.1989, ndryshuar me rregulloret 1310/97/KE, (1997), Fletore Zyrtare L180/1
- 9) Rregullorja e Këshillit Europian 17/62
- 10) United Nations Commission on International Trade Law (UNCITRAL) 16 July, 2014 UN Headquarters, 47th session

- 11) Urdhëresa nr. 139/2004 e Këshillit Europian e datës 20.1.2004 “Mbi Kontrollin e Fusionit të Shoqërive Tregtare”, 2004 ABL L 24
- 12) Udhëzimi mbi Kontrollin e Përqëndrimeve ndërmjet Ndërmarrjeve: 2012
- 13) Reg. i Antitrust-it dhe Tregtisë, Rep. (BNA) Nr. 1334, në 604 (4 Nëntor 1993)
- 14) The Panel of Takeover Code, “The Takeover Code”, F5/Rule 9, Donelley, RR. London, May 2013
- 15) Ministria e Integritetit Europian, “Traktati i Bashkimit Europian dhe Karta e të Drejtave Themelore e Bashkimit Europian”, Bruksel 2008
- 16) Traktati i Funksionimit i Bashkimit Europian

Legjislacion shqiptar (ligje/akte nënligjore)

- 1) Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr.7850, datë 29.7.1994; ndryshuar me ligjet nr.8536, datë 18.10.1999; nr.8781, datë 3.5.2001 dhe nr.17/2012, datë 16.2.2012; 121/2013, datë 18.4.2013
- 2) Neni 3 i Ligjit nr. 9121 datë. 28.7.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”
- 3) Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr.8116, datë 29.3.1996 dhe ndryshuar me ligjet nr.8431, datë 14.12.1998; nr.8491, datë 27.5.1999; nr.8535, datë 18.10.1999; nr.8812, datë 17.5.2001; nr.9953, datë 14.7.2008, nr.10 052, datë 29.12.2008, nr.49/2012; 122/2013; 160/2013
- 4) Ligji “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, miratuar me ligjin nr. 9121, datë 28.7.2003, ndryshuar me ligjin nr. 9499, datë 3.4.2006; nr. 9584, datë 17.7.2006; nr. 10317, datë 16.9.2010
- 5) Ligji Nr. 9135, datë 11.9.2003, “Për Mbrojtjen e Konsumatorit”

- 6) Autoriteti i Konkurrencës, “Aktet ligjore dhe nënligjore në fushën e konkurrencës, vol.2”, Express print, Tiranë 2014
- 7) Ligji “Për Tregtarët e Shoqëritë Tregtare”, miratuar me ligjin nr. 9901, datë 14.4.2008, ndryshuar me ligjin nr.10 475/2011; Ligjin nr.129/2014
- 8) Ligji “Për Mbrojtjen e Konsumatorëve”, miratuar me ligjin nr. 9902, datë 17.4.2008
- 9) Rregullorja “Për Zbatimin e Procedurave të Përqëndrimit të Ndërmarrjeve”, miratuar me Vendimin nr. 80, datë 05.06.2008; ndryshuar me Vendimin nr. 165, datë 14.12.2010 “Për disa ndryshime në rregulloren “Për zbatimin e procedurave të përqëndrimit të ndërmarrjeve”.
- 10) Ligji “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, miratuar me ligjin nr. 9723, datë 3.5.2007, ndryshuar me ligjin nr. 9916, datë 12.05.2008; ligjin nr. 92/2012; ligjin nr. 8/2015

Vendime të Gjykatave të huaja

- 1) Çështja United Brands vs Commission (1978), ECJ 27/76, E.C.R 207, parag. 65
- 2) Çështja IV/M57, Digital Equipment International & Mannesman Kienzle GmbH 1992/4 CMLR.
- 3) Case No. 1:11-cv-58 (WLS), FEDERAL TRADE COMMISSION and The State of Georgia, Plaintiffs vs PHOEBE PUTNEY HEALTH SYSTEM INC., Phoebe Putney Memorial Hospital, Inc., Phoebe North, Inc., Palmyra Park Hospital Inc., and Hospital Authority of Albany-Dougherty County, Defendants.
- 4) Case No. M.5830, Commission,– Olympic/Aegean Airlines, 26 January 2011

- 5) Case No. T-310/01 (ECJ), Schneider Electric SA vs Commission of the European Communities
- 6) General Court of the European Union PRESS RELEASE No 23/17 Luxembourg, 7 March 2017; Case T-194/13 United Parcel Service, Inc. v Commission
- 7) GJDKKE 16 Mars 2000, Compagne Maritime Belge de Transports, C-395, C-396/96, Re3c. I-1365; GJSHPKE 25 Mars 1999, Gencor Ltd c. Commission, T-102/96, Rec. II-753
- 8) GJSHPKE 26 Janar 2005, Piau, T-193/02, Rec. II-209
- 9) GJSHPKE 10 Mars 1992, Verre plat, T-68/89, Rec. II-1403.
- 10) Hoffman-La Roche & CO. AG vs Commission of the European Communities, 85/76, Rec. 461.
- 11) Vendimi nr. 00/74, Virgin, 14 Korrik 1999, FZKE L 30 e 14 Shkurt 2000
- 12) Vendimi COMP 38/233, 16 Korrik 2003, Wanadoo Interactive

Praktika gjyqësore shqiptare

- 1) Vendimi nr. 160, datë 23.11.2010 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë
- 2) Vendimi nr. 7938, datë 22.09.2008 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

Vendime të Autoritetit të Konkurrencës

- 1) Komisioni i Konkurrencës: Vendimi Nr. 236, datë 12.11.2012
- 2) Komisioni i Konkurrencës: Vendimi Nr. 328, datë 11.09.2014
- 3) Komisioni i Konkurrencës: Vendimi Nr. 331, datë 07.10.2014
- 4) Komisioni i Konkurrencës: Vendimi Nr. 427, datë 20.07.2016

- 5) Komisioni i Konkurrencës: Vendimi Nr. 426, datë 20.07.2016
- 6) Komisioni i Konkurrencës: Vendimi Nr. 309, datë 06.03.2014
- 7) Komisioni i Konkurrencës: Vendimi Nr. 364, datë 27.05.2015
- 8) Komisioni i Konkurrencës: Vendimi Nr. 340, datë 27.11.2014
- 9) Komisioni i Konkurrencës: Vendimi Nr. 206, datë 18.11.2011
- 10) Komisioni i Konkurrencës: Vendimi Nr. 341, datë 27.11.2014
- 11) Komisioni i Konkurrencës: Vendimi Nr.267, datë 05.02. 2013
- 12) Vendimi i Autoritetit të Konkurrencës nr. 150 i datës 20 Korrik 2010 “Për abuzimin me pozitën dominuese” të "ARMO" sha në tregun e naftës, Buletini Zyrtarë, nr. 6, 2010
- 13) Vendimi i Komisionit të Konkurrencës nr. 332, datë 09.10.20014 “Mbi vlerësimin e pozitës dominuese dhe abuzimit me pozitën dominuese

Raporte vjetore institucionale

- 1) Autoriteti i Konkurrencës, Raporti Vjetor 2007 dhe synimet kryesore për vitin 2008, Tiranë 2008
- 2) Autoritetit i Konkurrencës, Raporti Vjetor 2008 dhe synimet kryesore për vitin 2009, Tiranë 2009
- 3) Autoriteti i Konkurrencës, Raporti Vjetor 2009 dhe synimet kryesore për vitin 2010, Tiranë 2010
- 4) Autoriteti i Konkurrencës, Raporti Vjetor 2010 dhe synimet kryesore për vitin 2011, Tiranë 2011
- 5) Autoriteti i Konkurrencës, Raporti Vjetor 2011 dhe synimet kryesore për vitin 2012, Tiranë 2012

- 6) Autoriteti i Konkurrencës, Raporti Vjetor 2012 dhe synimet kryesore për vitin 2013, Tiranë 2013
- 7) Autoriteti i Konkurrencës, Raporti Vjetor 2013 dhe synimet kryesore për vitin 2014, Tiranë 2014
- 8) Autoriteti i Konkurrencës, Raporti Vjetor 2014 dhe synimet kryesore për vitin 2015, Tiranë 2015
- 9) Autoriteti i Konkurrencës, Raporti Vjetor 2015 dhe synimet kryesore për vitin 2016, Tiranë 2016

Burime Dytësore

Literaturë shqiptare dhe e huaj

- 1) Barry J. Rodger & Angus MacCulloch, “Competition Law and Policy in the EC and UK, New York, 2008
- 2) Benacchio G., Diritto Privato dell’Unione Europea, botim i 4-t, Padova, Cedam. 2010, fq. 485
- 3) Barry Rodger, Competition Law and Policy in the EC and UK, Routledge Cavendish 2009
- 4) Catricala, A. Troiano, P. “Codice commentato della concorrenza e del mercato”, Utet, Torino 2010
- 5) Cavani, G. Ghidini, G. Di Porto, F. “L’antitrust italiano. Le regole della concorrenza” Il Sole 24 Ore, Milano 2003
- 6) Cyril Nourissat, “E Drejta e Biznesit e Bashkimit Evropian”, Papirus, Tiranë, 2010
- 7) Çuçi, Zh. Semini, M. Malltezi, A. “E Drejtë Biznesi”, mediaprint, Tiranë 2010

- 8) David J. Geber “Law and Competition in Twentieth Century Europe: Protecting Prometheus” Geber, 2000
- 9) De Blasi, D. “Servizi pubblici: principio di concorrenza e modelli organizzativi, Corriere del Merito, 2008
- 10) De Lucia, L. Minervine, V. “Le decisioni con impegni nella normativa nazionale a tutela della concorrenza dei consumatori”, Giuffrè Editore, Milano 2011
- 11) Dine, J. Blecher, M. “Ligji për tregtarët dhe shoqëritë tregtare (Teksti me shpjegime)”, Gent Grafik, Tiranë 2016
- 12) Dine, J. “The Governance of Corporate Groups”, Cambridge University Press, 2006
- 13) Einar Hope and Per Maeleng, “Competition and Trade Policies”, London, 2005
- 14) Fattori, P. Todino, M. “La disciplina della concorrenza in Italia”, Il Mulino, Bologna 2010
- 15) Galgano, F. “E Drejta Tregtare”, “Luarasi”, Tiranë 2009
- 16) Gaughan, A. “Mergers, Acquisitions, and Corporate Restructuring”, John Wiley and Sons, Inc., New Jersey 2007
- 17) Ghidini, G. Marchetti, P. Clarich, M. Di Porto, F. “Concorrenza e Mercato”, Giuffrè Editore, Milano 2012
- 18) Giorgio Monti, "EC Competition Law", Cambridge, University Press 2007
- 19) Giuseppe Guizzi, “Il mercato concorrenziale: problemi e conflitti”, Giuffrè Editore, Milano 2010
- 20) Helbing, Lichtenhahn. “Current Developments in European and International Competition Law”, 2011
- 21) Jones, A. Sufrin, B. “EU Competition Law”, OUP Oxford, 2011

- 22) Maher, M. Dabbah, "EC and UK Competition Law, Commentary. Cases and Materials", Cambridge University, Press 2004
- 23) Malltezi, A. Rystemaj, J. Pelinku, L. "Aspekte të së drejtës së biznesit në Shqipëri", "mediaprint", Tiranë 2013
- 24) Malltezi, A. "E Drejta Shqiptare e Shoqërive Tregtare", mediaprint, Tiranë 2011
- 25) Malltezi, A. Rystemaj, J. Kromiçi, A. "Gjykatat Shqiptare mbi Shoqëritë dhe Veprimtarinë Tregtare", Mediaprint, Tiranë 2015
- 26) Mangini, V. Oliveiri, G. "Diritto Antitrust", Giappichelli, Torino 2009
- 27) Mankiw, G. Taylor, M., "Ekonomiksi", UET Press, Tiranë 2010
- 28) Nuni, A. Hasneziri, L. "E Drejta Civile II (Pronësia)", Mediaprint, Tiranë 2010.
- 29) Pace L. F., Diritto Europeo della concorrenza, Milano, Cedam, 2007
- 30) Pannuci, M. Matonti, A. "Le operazioni di concentrazione", 2011
- 31) Paolo Palmigiano, "Merger Control: Why is Competition Law Relevant to M&A?", International Financial Law Review, April 2013
- 32) Papajorgji, E. "E Drejta Ndërkombëtare dhe Shqiptare e Konkurrencës", "ILAR", Tiranë 2013
- 33) Raganelli, B. "Finanza di progetto, ricerca e sviluppo", Cedam, Padova 2006
- 34) Russell Miller, Competition and Consumer Law Annotated, 2012
- 35) Santoro, P. "La concorrenza e il mercato del partenariato", Maggioli Editore, Roma 2010
- 36) Scano, D. "Project financing. Societa e impresa", Giuffre Editore, Milano, 2006
- 37) Semini, M. "E Drejta e Detyrimeve (Pjesa e Përgjithshme)", Skanderbeg Books, Tiranë, 2006

- 38) Spaho, E. “Cikël Leksionesh në të Drejtën e Konkurrencës”, Universiteti European i Tiranës, Tiranë 2016.
- 39) Stephan Price, “Fixing in Crisis: Implications of an Economic Downturn for Cartels and Enforcement”, World Competition 2012
- 40) Thomas J. Schoenbaum, “The International Trade Laws & The New Protectionism: The Need for a Synthesis with Antitrust”, Washington, 1994
- 41) Tërpollari, Z. “Paditë për Mbrojtjen e të Drejtave Reale”, UET Press, Tiranë 2014
- 42) Went, D, “Recent Developments in UK Merger Control – Establishment of Solid Foundations for the New Regime”, London, 2007
- 43) Weber, Y. Tarba, S. Öberg, C. “A Comprehensive Guide to Mergers & Acquisitions”, FT Press, New Jersey 2014
- 44) Whish, R. Bailey, D. “Competition Law”, Oxford University Press, Oxford, 2012
- 45) Zajmi, I. “E Drejta Europiane e Konkurrencës”, Tiranë, 2012
- 46) Zweigert & Kotz, “Njohuri për të Drejtën e Krahastuar”, Skanderbeg Books, Tiranë 2008

Artikuj Shkencorë

- 1) Benoit Durand: "Intellectual property and merger control: Review of the recent experience under the european merger regulatuon", European Competition Law Annual, Hart Publishing 2007.
- 2) Ghezzi, F. Legami personali tra intermediary finanziari e diritto della concorrenza, sull' opportunità di introdurre uno specific divieto anti-interlocking nell' ordinamento italiano, in Riv. Soc. Torino, 2011.

- 3) Hamner, "The Globalisation of Law; International Merger Control and Competition Law in the US, the EU, Latin America and China, 2002, Journal of Transnational Law and Policy 385
- 4) J. W. Meehan Jr. and R. J. Lerner, "The Structural School, Its Critics and Its Progeny: An Assessment" in R. J. Lerner and J. W. Meehan Jr. (eds.) Economics and Antitrust Policy, New York, 1989
- 5) Voorhis, L. V. Brusser, V. "How Antitrust Agencies Analyze M&A", Practical Law Publishing Limited and Practical Law Company, Inc. New York 2010
- 6) Meijaard, Joris dhe Hans Schenk, Yvonne Prince. Dynamic efficiencies in mergers and acquisitions. Towards an Empirical Analysis. EIM, Zoetermeer, March 22, 2005
- 7) Moschel, The proper scope of Government viewed from an Ordoliberal Perspective: The Example of Competition Policy, Journal of Institutional and Theoretical Economics (2001)
- 8) Pranvera Kellezi, " Abuse below the threshold of dominance: Market power, market dominance, and abuse of economic dependence", Max Planck Institute for Intellectual Property, Competition and Tax Law, Volume 5, Springer 2, 2008.
- 9) Spaho, E. "Grupimi i shoqërive tregtare dhe sipërmarrjet e përbashkëta tregtare: Një mundësi më shumë në fuqizimin e tyre ekonomik", Konferenca ndërkombëtare "Ditët e Studimeve Shqiptare: Ligji midis efikasitetit dhe drejtësisë", Universiteti Europian i Tiranës", Tiranë 2016.

Burime interneti

- 1) Marrë nga: <http://economics.fundamentalfinance.com/sherman-act.php> (parë më 13.04.2014)
- 2) Marrë nga: <https://ftc.gov/tips-advice/competition-guidance/guide-antitrust-laws/price-discrimination-robinson-patman> (parë më 22.06.2014)
- 3) Marrë nga: <http://investopedia.com/terms/c/clayton-antitrust-act.asp> (parë më 07.03.2015)
- 4) Marrë nga: <http://caa.gov.al/> (parë më 12.05.2016)
- 5) Marrë nga: <http://sagem-ds.com> (parë më 26.07.2016)
- 6) Marrë nga: <http://ftc.gov> (parë më 26.07.2016)
- 7) Marrë nga: <http://lse.ac.uk/internationalRelations/centresandunits/ITPU/docs/> (parë më 22.07.2016)
- 8) Marrë nga: <http://ftc.gov/tips-advice/competition-guidance/guide-antitrust-laws/mergers/premerger-notification-and-merger> (parë më 14.09.2016)
- 9) Marrë nga: <https://cortlistener.com/opinion/2183410/ftc-v-phoebe-putney-health-system-inc/> (parë më 17.08.2016)
- 10) Marrë nga: <http://scotusblog.com/case-files/cases/ftc-v-phoebe-putney-health-system-inc/> (parë më 30.08.2016)
- 11) Marrë nga: https://supremecourt.gov/opinions/12pdf/11-1160_1824.pdf (parë më 26.09.2016)
- 12) Marrë nga: <http://curia.europa.eu/juris/liste.jsf?language=en&num=T-310/01> (parë më 11.01.2016)

- 13) Marrë nga: http://europa.eu/rapid/press-release_IP-13-927_en.htm (parë më 12.02.2016)
- 14) Marrë nga: <https://curia.europa.eu/jcms/upload/docs/application/pdf/2017-03/cp170023en.pdf> (parë më 10.04.2017)
- 15) Marrë nga: <https://.clearygottlieb.com/~media/cgsh/files/publication-pdfs/european-union-merger-control.p> (parë më 12.04.2017)
- 16) Marrë nga: <http://.caa.gov.al/publications/read/id/22> (parë më 30.10.2016)
- 17) Marrë nga: <http://.caa.gov.al/publications/read/id/35> (parë më 30.10.2016)
- 18) Marrë nga: www.law.nyu.edu.docx&usg=AFQjCNHSTQYIwCovgDAmtFjsKiajCIIZ8Q (parë më 12.03.2017)
- 19) Marrë nga: <https://www.justice.gov/atr/monopoly-power-and-market-power-antitrust-law> (parë më 13.03.2017)
- 20) Marrë nga: <http://www.atg.wa.gov/guide-antitrust-laws> (parë më 13.03.2017)